

RAPORTI MBI VLERËSIMIN E NEVOJAVE (RVN) PËR NGRITJEN E KAPACITETEVE KOMUNALE

RAPORTI MBI VLERËSIMIN E NEVOJAVE (RVN) PËR NGRITJEN E KAPACITETEVE KOMUNALE

Ky raport vlerëson performancën komunale për vitin 2018

Maj, 2020

Tabela e përmbajtjes

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	7
1. HYRJE	9
2. METODOLOGJIA	11
2.1. Analiza e të dhënave	11
2.2. Rishikimi i literaturës	12
2.3. Aktivitetet në terren	12
3. GJETJET KRYESORE	13
3.1. Kushtet minimale	14
3.2. Qeverisja demokratike lokale	20
3.3. Menaxhimi komunal	36
3.4. Ofrimi i shërbimeve	49
4. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	56
4.1. Kushtet minimale	56
4.2. Qeverisja demokratike lokale	57
4.3. Menaxhimi komunal	58
4.4. Ofrimi i shërbimeve	59
SHTOJCA 1:	61

Tabela e figurave

Figura 1. Mostra e sistemit të “semaforëve”	11
Figura 2. Nr. i komunave që janë, përkatësisht nuk janë kualifikuar për grant ...	14
Figura 3. Nr. i komunave dhe opinionet e auditorit	15
Figura 4. Përqindja e shpenzimit të buxhetit të investimeve kapitale nga 14 komuna.....	17
Figura 5. Nr. i komunave rreth shpenzimit të buxhetit për investime kapitale ...	18
Figura 6. Sistemi i” semaforit” në fushën e qeverisjes demokratike lokale.....	22
Figura 7. Nr. i komunave që (nuk) kanë diskutuar raportet tremujore buxhetore	23
Figura 8. Nr. i komunave që (nuk) e kanë diskutuar raportin e performancës në KK....	25
Figura 9. Nr. i komunave që (nuk) kanë diskutuar raportin e auditorit të jashtëm dhe të brendshëm në KK	26
Figura 10. Nr. i komunave me pjesëmarrje të kryetarit të komunës në mbledhje të KK	28
Figura 11. Nr. i komunave me pjesëmarrje të kryetarit të komunës në mbledhje të KK për vitet paraprake	28
Figura 12. Nr. i komunave dhe % e pjesëmarrjes së grave në takime publike.....	30
Figura 13. Nr. i komunave dhe % e pjesëmarrjes së grave në takime publike për vitet paraprake	31
Figura 14. Nr. i komunave që kanë (nuk) konsultuar publikun për aktet dhe politikat lokale	32

Figura 15. Nr. i komunave që kanë (nuk) konsultuar publikun për aktet dhe politikat lokale.....	32
Figura 16. Nr. i komunave që kanë (nuk) përditësuar uebfaqet sipas kërkesave ligjore	35
Figura 17. Nr. i komunave që kanë (nuk) diskutuar planin e integritetit në KK ...	35
Figura 18. Sistemi i “semaforit” për treguesit e menaxhimit komunal.....	37
Figura 19. Nr. i komunave që kanë (nuk) përditësuar regjistrin e tatimit të pronave...	38
Figura 20. Nr. i komunave që kanë (nuk) mbledhur tatimin në pronë pa borxhe, kamata dhe gjoba.....	39
Figura 21. Nr. i komunave që kanë (nuk) adresuar rekomandimet e ZKA-së	41
Figura 22. Nr. i komunave që kanë (nuk) zbatuar planin e prokurimit	44
Figura 23. Nr. i komunave që kanë (nuk) hapur vende të punës sipas SIMBNJ-së	47
Figura 24. Nr. i komunave që (nuk) kanë emëruar gra në pozita politike	48
Figura 25. Sistemit i “semaforit” për ofrimin e shërbimeve	50
Figura 26. Nr. i komunave që kanë (nuk) shqyrtuar kërkesat administrative brenda afateve ligjore.....	51
Figura 27. Nr. i komunave që kanë (nuk) përfshirë territorin komunal në planet rregullative.....	53
Figura 28. Nr. i komunave që kanë (nuk) mbuluar vendbanimet me transport publik lokal	54
Figura 29. Nr. i komunave që kanë (nuk) zbatuar planin lokal të veprimit për mjedisin	55

LISTA E SHKURTESAVE

AKK	Asociacioni i Komunave të Kosovës
AT	Asistenca teknike
BE	Bashkimi Evropian
BIRN	Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese
BNJ	Burime Njerëzore
D+	Demokraci Plus
D4D	Demokracia për Zhvillim
DASHC	Departamenti për Administrimin e Shërbimit Civil
DEMOS	Decentralizimi dhe përkrahja e komunave
GIZ	Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
GPK	Granti i Performancës Komunale
IKAP	Instituti i Kosovës për Administratë Publike
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
KE	Komisioni Evropian
KK	Kuvendi Komunal
KPF	Komiteti për politikë dhe financa
KRPP	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
MAP	Ministria e Administratës Publike
MPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MF	Ministria e Financave
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MTI	Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit
OECD	Organizata për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OSHP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
PT	Programi i Trajnimit
PVF	Pasqyrat Vjetore Financiare
QSHQ	Qendra për Shërbim me Qytetarët
RVN	Raporti për Vlerësimin e Nevojave të Performancës
SDC	Swiss Development Cooperation
SIMBNJ	Sistemi Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
SMPK	Sistemi për Menaxhimin e Performancës Komunale
TP	Treguesi i Performancës
UA	Udhëzim Administrativ
UNDP	Programi Zhvillimor i Kombeve të Bashkuara
USAID	Agjencia Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar ZKA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Projekti DEMOS mbështet komunat nëpërmjet grantit të performancës dhe sa më e mirë të jetë performanca, aq më e lartë është shuma e grantit. Performanca komunale vlerësohet duke përdorur tregues që si burim kanë të dhënat në Sistemin për Menaxhimin e Performancës Komunale (SMPK) të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit “Analizë – Tregues të performancës për nivelin lokal qeverisës, 2018”. Që të dyja këto raporte sigurojnë të dhëna për performancën e komunave për vitin 2018.

Qëllimi i Grantit të Performancës Komunale (GPK) është t’u ofrojë komunave grante që do t’i stimulojnë ato për të përmirësuar më tej performancën e tyre në tema specifike: qeverisja demokratike, menaxhimi i komunave, transparenca dhe integriteti. Granti i performancës komunale nxit komunat në dy mënyra: së pari, inkurajon komunat për të plotësuar kriteret minimale ligjore (kriteret bazë), dhe së dyti, nxit përmirësimin e performancës “reale” që shkon përtej pajtueshmërisë ligjore “të detyrueshme”.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MPL) ka punuar për më tepër se 10 vjet në zhvillimin dhe avancimin e Sistemit për Menaxhimin e Performancës Komunale (SMPK) dhe ka ndarë fond stimulues për të shpërblyer komunat me performancën më të mirë sipas treguesve të SMPK-së. Në anën tjetër, në vitin 2018 MPL dhe Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC)) përmes projektit DEMOS, kanë themeluar dhe bashkë financojnë GPK-në për komunat i cili administrohet nga MPL.

Për të mos krijuar konfuzion te komunat, MPL ka marrë vendim që Fondi stimulues dhe GPK-ja të bashkohen në një skemë pasi që të dy skemat e shfrytëzojnë SMPK-në si burim të të dhënave. Prandaj, gjatë vitit 2019, MPL dhe SDC, përmes projektit DEMOS, kanë rishikuar SMPK-në dhe kanë bashkuar skemat e granteve duke krijuar një grant të vetëm që synon përmirësimin e performancës së komunave në fusha të caktuara. Kështu, në fund të vitit 2019 është realizuar vlerësimi i performancës komunale për vitin 2018 për grantin e vitit 2020.

Në këtë raport bëhet analiza e vlerësimit të nevojave në bazë të matjes së performancës komunale për vitin 2018 me qëllim të identifikimit të nevojave për ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve komunalë dhe për të hartuar programin e trajnimeve. GPK-ja është pika kyçe e projektit DEMOS dhe qëllimi i grantit është stimulimi i komunave që të përmirësojnë më tej performancën e tyre në fushat si në vijim: (I) qeverisja demokratike lokale, (II) menaxhimi komunal dhe (III) ofrimi i shërbimeve. Për më shumë, granti do të duhej të stimulojë komunat në dy mënyra: së pari, duke e inkurajuar pajtueshmërinë komunale me standardet minimale ligjore (standardet themelore) dhe së dyti, do të duhej të stimulojë performancën ‘reale’ që shkon përtej pajtueshmërisë ligjore (‘të detyrueshme’).

Pas vlerësimit të performancës, projekti harton programin e trajnimit për të ngritur kapacitetet dhe kompetencat të lidhura me punën e zyrtarëve komunalë për fushat ku komunat kanë performuar më dobët dhe që konsiderohen të rëndësishme sipas grantit komunal çdo vit kalendarik. Trajnimet synojnë që të përmirësojnë kapacitetet dhe kompetencat që janë të lidhura me aftësitë, njohuritë dhe sjelljet që janë «kritike» për performancë të suksesshme në punën e punonjësve dhe/ose përfaqësuesve të komunave [p.sh. nëpunësit civilë të komunës, drejtorët komunalë dhe anëtarët e Kuvendit komunal]. Megjithatë, ky raport përfshin gjithashtu analizën e politikave, komunikimit dhe të ndërhyrjeve tjera të nevojshme për t’i ndihmuar komunat të fitojnë një avantazh konkurrues në grant dhe të arrijnë performancë më të mirë komunale.

Programi i trajnimit fillimisht është hartuar bazuar në një analizë të plotë të nevojave të performancës komunale të paraqitur në këtë raport, e cila identifikon nevojat prioritare që projekti do të adresojë përmes asistencës teknike dhe mjeteve të tjera të nevojshme, siç janë hulumtimi dhe mbështetja e politikave. Kjo qasje lidhet drejtpërdrejt me rezultatet kryesore të projektit DEMOS që janë: (i) përmirësimi i performancës komunale në fushën e qeverisjes dhe menaxhimit komunal, dhe (ii) reforma në kornizën e politikave duke e bërë atë më “të favorshme” për qeverisje lokale të decentralizuara. Në këtë mënyrë,

programi i trajnimeve përfshin në vetvete dy dimensione: dimensionin e parë është i lidhur me temat e treguesve të grantit të performancës dhe përqipet të shpjegojë se çfarë mund të përmirësohet përmes trajnimeve, kurse dimensionin e dytë shkon përtej nevojave të trajnimit duke identifikuar ndërhyrje të tjera të nevojshme për ndryshime organizative dhe të “sjelljes”.

Në kontekstin e programit të trajnimeve, ky raport ka identifikuar fushat kyçe/prioritare bazuar në një analizë të plotë për vitin 2018, duke marrë për bazë edhe analizimin e të dhënave sekondare dhe hulumtimet në terren. Për analizën e të dhënave, si burim primar i matjes është përdorur si numri i komunave ashtu edhe mesatarja e ponderuar e treguesve të performancës. Burimet dytësore dhe kërkimet në terren kanë ndihmuar në validimin dhe interpretimin e të dhënave primare për përcaktimin e prioritetëve. Në përputhje me këtë, trajnimi do të përqendrohet kryesisht në rritjen e kapaciteteve të zyrtarëve komunalë për çështje specifike që lidhen me tregues të ndryshëm të performancës.

Siç është theksuar në Dokumentin e Projektit, DEMOS nuk do të ofrojë trajnim në fushat dhe komunat ku institucionet dhe organizatat e tjera po japin mbështetje për ngritjen e kapaciteteve.¹ Kjo iu referohet Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MPL), Institutit të Kosovës për Administratë Publike (IKAP), Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA), Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK) dhe shumë organizatave ndërkombëtare, përfshirë USAID, BE, GIZ, OSBE dhe UNDP. Në këto raste kur ka përsëritje të trajnimit, DEMOS mund të përqendrohet në hulumtimin dhe mbështetjen e politikave, për shembull - ndryshimi i një politike ose ligji të caktuar mund të nënkuptojë aktivitete shtesë të trajnimit për komunat, në veçanti lidhur me procedurat për zbatimin e dispozitave ligjore, të ndryshuara.

Raporti i identifikimit të nevojave për ngritjen e kapaciteteve komunale ka për qëllim që, më tutje, projekti DEMOS të hartojë planin për trajnim për vitin 2020, si dhe i njëjti plan të diskutohet me palët e interesuara siç janë: MPL, AKK, IKAP etj. Për tregues të caktuar të performancës, ku mbështetja me trajnime dhe e politikave nuk përputhet me objektivin e përgjithshëm për përmirësimin e performancës komunale, do të përdoren mjete të tjera të nevojshme, siç janë mbështetja përmes formave të ndryshme të komunikimit. Për shembull, përfshirja e grave - si në takime publike ashtu edhe mbajtja e funksioneve politike - përbën një nga treguesit me performancën më të ulët! Ndihej për komunat që të sigurojnë përfshirje më të madhe të grave si në hartimin e politikave ashtu edhe në vendimmarrje jo domosdoshmërisht mund të arrihet vetëm nëpërmjet trajnimit apo madje edhe ndryshimit të politikave, pasi që pabarazia gjinore është produkt i normave historike, kulturore dhe shoqërore. Marrë parasysh që politikat dhe ligjet në Kosovë, në përgjithësi, janë me ndjeshmëri gjinore, DEMOS mund të përqendrojë përpjekjet në hartimin e një programi efektiv të komunikimit ose avokimit në promovimin e përfshirjes së grave.

Përgjatë gjithë përmbajtjes së dokumentit do të nxirren përfundime për tema dhe nën-tema përkatëse. Pjesa e fundit e këtij raporti përbëhet nga rekomandimet dhe ndërhyrjet e propozuara për të adresuar gjetjet kryesore. Rekomandimet janë të dizajnuara për të adresuar çështjet e gjetura. Megjithatë, në zbatimin e planit të trajnimeve do të ndikojë situata e zhvilluar rreth COVID-19.

¹ Dokumenti i projektit. Decentralizim dhe Mbështetje Komunave – Faza II. Janar 2018, fq. 21-22.

1. HYRJE

Ky raport jep një pasqyrë të nevojave të performancës komunale si pjesë e Programit të Trajnimit (PT) bazuar në (i) analizën e treguesve të bazuar në performancë, (ii) rishikimin e literaturës dhe (iii) hulumtimin në terren si dhe (iv) rekomandimet apo kërkesat nga punëtoritë e organizuara nga projekti për vlerësimin e nevojave të komunave dhe nga (v) raportet e ekspertëve nga trajnimet e mbajtura gjatë vitit 2019.

Burimet kryesore të informacionit për hartimin e këtij Raporti për Vlerësimin e Nevojave të Performancës (RVN) komunale përfshijnë të dhënat e GPK-së. Një rishikim i plotë i literaturës ishte veçanërisht i dobishëm në interpretimin e të dhënave të GPK-së dhe përcaktimin e prioritetëve për hartimin e PT-së. Si pjesë e rishikimit të literaturës, janë konsultuar burime të ndryshme, duke filluar me Dokumentin e Projektit “Decentralizimi dhe Mbështetja Komunave - Faza II”, dhe të dhënat dhe informacionet të publikuara nga Qeveria dhe nga organizatat ndërkombëtare e vendore në Kosovë.

Duke përdorur këtë raport, projekti synon të identifikojë nevojat e përgjithshme të komunave dhe të vlerësojë potencialin për ndryshim, nën supozimin se ekziston një dilemë themelore në lidhje me atë nëse kanë apo jo komunat nevojë për ndihmë teknike të vazhdueshme. Nga perspektiva e projektit ose “teoria e ndryshimit”, komunat duhet të përmirësojnë kapacitetet e tyre të qeverisjes dhe menaxhimit me qëllim që të përmirësojnë cilësinë e shërbimeve në mënyrë që qytetarët të jenë të kënaqur me shërbimet komunale. Asistenca teknike (AT) për ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve komunalë përcaktohet në bazë të një numri kriteresh si në vijim: (i) nëse problemet e identifikuar për tregues janë teknike, e jo politike, (ii) nëse një mjet tjetër ose ndryshim sistematik do të ishte më efektiv, (iii) nëse trajnimet mbahen nga projekte tjera, (iv) pësia e treguesve të performancës, dhe në fund (v) performanca komunale bazuar në numrin e komunave (d.m.th. performuesit më të mirë kundrejt atyre më të dobët).

Ky raport gjithashtu supozon se “secila komunë” e sheh trajnimin më gjerësisht si një mënyrë për të krijuar kapital intelektual, fituar një shpërblim modest financiar dhe për të dalë më mirë se konkurrentët. Në kontekstin e GPK-së, ekzistojnë tre kushte minimale si parakushte që i bëjnë komunat të përshtatshme që të marrin pjesë në garë dhe performojnë me 27 tregues të shpërndarë në tre tema: (I) qeverisja demokratike, (II) menaxhimi komunal, dhe (III) ofrimi i shërbimeve. Përveç nënshkrimit të një marrëveshjeje për pjesëmarrje në GPK, kushtet minimale kërkojnë që komuna të ketë së paku opinionin e pastër ose të pa modifikuar të auditorit me theksim të çështjes dhe që komuna të ketë shpenzuar së paku 75% të buxhetit të saj komunal për investime kapitale.

Analiza e të dhënave të paraqitura në këtë raport përbëhet nga një analizë sasiore e detajuar, e cila ka përshkruar ecurinë e komunave sipas temës dhe treguesit, bazuar në “mesataren e ponderuar të treguesve të performancës” dhe “numrin e komunave të cilat kanë treguar performancë të dobët, mjaftueshme/mesatare ose të mirë.” Më e rëndësishmja, analiza e të dhënave të GPK-së ka ndihmuar të kuptohet shkalla e mbetjes prapa të komunave në aspektin e performancës komunale dhe që ato janë në përmirësim e sipër. Treguesit e mirë vetëm e kanë ndihmuar projektin të rishikojë qasjen e tij duke zhvendosur prioritetet në fushat ku mbështetja është më e nevojshme.

Në bazë të analizës së performancës komunale për 2018, mund të thuhet që komunat si tërësi kanë nevojë për ngritje të kapaciteteve. Kur analizojmë performancën e komunave në fushën e demokracisë lokale mund të themi që trajnimet janë të domosdoshme sidomos në dy nën-fushat të cilat kanë të bëjnë me raportin e komunës me qytetarët ngase në të flitet për transparencë, gjithëpërfshirje, konsultime, pjesëmarrje të publikut, qasje në informata, etj.

Sa i përket performancës së komunave individualisht në të gjithë fushën e qeverisjes demokratike, mesatarja më e lartë është 97% (Juniku).

Sa i përket fushës së menaxhimit komunal komunat kanë shumë nevojë për trajnime. Edhe në këtë fushë disa nga treguesit kanë performancën më të ulët në përgjithësi krahasuar me të gjithë treguesit sidomos treguesit: emërimi i grave në pozita udhëheqëse, regjistri i tatimit në pronë si dhe adresimi i rekomandimeve të auditorit.

Në fushën e ofrimit të shërbimeve, shumica e komunave kanë treguar performancë të dobët në treguesin 24 ose 'shtrirja e territorit komunal të përfshirë në planet rregullative' për shkak se 28 komuna kanë më pak se 30% të territorit komunal të përfshirë në planet rregullative për vitin 2018. Treguesit tjerë lidhur me ofrimin e shërbimeve tregojnë performancë më të mirë.

2.2. Rishikimi i literaturës

Si pjesë e procesit të identifikimit të nevojave komunale për trajnim është edhe rishikimi i literaturës. Ky proces është bërë para hulumtimit në terren. Duke pasur sa më shumë burime të literaturës, ka mundësi për të vlerësuar dhe kontrolluar gjetjet e burimeve të institucioneve publike kundrejt atyre të organizatave vendore dhe ndërkombëtare. Më e rëndësishmja është se ato kanë ndihmuar të kuptohen dhe interpretohen treguesit e performancës të cilët janë raportuar në terma numerikë/përqindje. Së fundi, ato kanë ndihmuar të kuptohen lidhjet midis numrave dhe të identifikohen boshllëqet dhe nevojat ku ndërhyrjet për ngritjen e kapaciteteve janë më të nevojshme.

Prandaj, për të kuptuar performancën komunale më në detaje, është bërë një hap shtesë duke shkuar përtej “të dhënave të papërpunuara” dhe duke gjurmuar burime dytësore nga raportet vendore dhe ndërkombëtare. Burimet e tilla jo vetëm që kanë ndihmuar në validimin dhe interpretimin e të dhënave primare të grantit të performancës, por edhe në konceptualizimin e tyre për hartimin e programit të trajnimit. Burimet kryesore dytësore, përveç raporteve të auditorit të përgjithshëm që janë konsultuar, përfshijnë: Raportin e Vlerësimit të Kapaciteteve Komunale (MPL/UNDP, 2018), Raportin mbi Funksionimin e Komunave të Republikës së Kosovës (MPL, 2018), Analizën e Investimeve Kapitale (MPL, 2018), Reformën e Administratës Publike (SIGMA), Raportin e Progresit (KE), Raportin e Llogaridhënies Menaxheriale në Ballkanin Perëndimor nga SIGMA/OECD dhe studimet e kryera nga organizatat lokale si GAP, Ec Ma Ndryshe, etj.

2.3. Aktivitetet në terren

Përveç programit të trajnimit, projekti mban takime të rregullta dhe të veçanta me komunat për të informuar nga afër komunat për performancën e tyre, për të identifikuar problemet dhe nevojat e komunave për të përmirësuar performancën. Këto informata po ashtu përdoren për analizën e nevojave të komunave.

Pasi që të finalizohet raporti për ngritje të kapaciteteve hartohet plani për trajnim. Pastaj mbahen takimet me grupet e targetuara për të specifikuar më saktë se cilat do të ishin temat më konkrete për trajnim. Për shkak të pandemisë së shpallur dhe vendimeve të Qeverisë lidhur me kufizimet në lëvizje, mbajtja e këtyre takimeve nuk do të jetë e mundur.

3. GJETJET KRYESORE

Analiza për hartimin e programit të trajnimit bëhet edhe për kushtet minimale edhe për treguesit e performancës. Përveç kësaj, është për t'u theksuar se për temat për të cilat nuk është e mundur të bëhet trajnim formal, atëherë kjo bëhet përmes formave të tjera të komunikimit, e që janë pjesë e strategjisë së DEMOS për komunikim. Që një komunë të kualifikohet për grant, së pari duhet të përmbushë kushtet minimale. Për t'u kualifikuar për grantin e performancës komunale për vitin 2020, komunat duhet t'i kenë plotësuar të tre kushtet minimale.

“Numri i komunave që nuk raportojnë “të dhëna” ka rënë përgjatë viteve. Në vitin 2018 36 nga 38 komunat kanë raportuar të dhënat në SMPK, mirëpo ka komuna që nuk kanë raportuar në të gjithë treguesit ”

Gjatë analizës dhe vlerësimit të performancës për vitin 2018, njëzet e tre (23) komuna janë kualifikuar kurse 15 të tjera nuk janë kualifikuar për këtë grant. Nëse shikojmë më në detaje lidhur me plotësimin e tre kushteve minimale, 36 komuna kanë përmbushur kriterin e opinionit të auditorit kurse 24 komuna kanë përmbushur kriterin që ka të bëjë me shpenzimin e buxhetit në investime kapitale mbi 75%, kurse kriterin e tretë, pra nënshkrimin e marrëveshjes për grant e kanë bërë që të 38 komunat.

Performanca mesatare e 38 komunave sipas pikëve të marra në 18 treguesit² e performancës është 45% (26 pikë nga gjithsej 58 pikë të mundshme), ndërsa performanca mesatare e komunave që janë kualifikuar për grantin e performancës komunale është 48% (25 pikë nga gjithsej 58 pikë të mundshme). Po ashtu, 8 nga 38 komuna kanë arritur një performancë të përgjithshme ndërmjet 24 dhe 29 pikëve (40-50%). 18 komuna kanë arritur performancë mbi 50%. Komuna e Leposaviqit ka rezultatin më të ulët mesatar në 18 treguesit e performancës. Rezultati i përgjithshëm i performancës së Komunës së Leposaviqit është 2 pikë nga 58 pikë të mundshme (3%). Ky rezultat mund të jetë i ulët për shkak të mosraportimit të të dhënave në SMPK nga Komuna e Leposaviqit sikurse edhe komuna e Zubin Potokut që ka rezultatin e performancës së përgjithshme 3 pikë nga 58 pikë të mundshme (5%).

Performanca mesatare e 38 komunave sipas rezultatit në burim në 18 treguesit e performancës është 39 %. Nëse shohim 18 treguesit individualisht sipas performancës së komunave në bazë të rezultatit sikurse në burim, ata mund t'i ndajmë në tri grupe: treguesit me performancë më të lartë, mesatare dhe të ulët.

Treguesit me performancë më të lartë janë: treguesi 22 “rastet e kërkesave administrative të shqyrtuara brenda afateve ligjore” me 87%, treguesi 17 “zbatimi i planit të prokurimit” me 84% dhe treguesi 10 “përditësimi i rregullt i ueb-faqes komunale sipas kërkesave (specifike) ligjore me 81%.

Treguesit me performancë mesatare rreth 30-40% janë treguesi 16 “niveli i adresimit të rekomandimeve të ZKA-së” me 30%. Treguesi me numër 6 “pjesëmarrja e qytetarëve në konsultimet publike të ndara sipas gjinisë” me 35% si dhe treguesi 4 : diskutimi i raportit të auditorit të jashtëm dhe planit të veprimit për adresimin e rekomandimeve në Kuvendin Komunal (KK) dhe diskutimi i raportit të punës së auditorit të brendshëm në KK”, me rezultat 36%.

Treguesit me performancën më të dobët prej 20-30% janë: treguesi 24 “shtrirja e territorit komunal të përfshirë në planet (e hollësishme) rregullative” me rezultat 20%. Treguesi me numër 21 “gratë e emëruara në pozita politike në komunë” me rezultat 20%, dhe treguesi me numër 14 “regjistri i tatimit në pronë i përditësuar çdo vit, sipas kërkesave ligjore” me rezultat 26%.

Vlen të thuhet se performanca e komunave në këta tregues ka qenë më e dobët edhe gjatë viteve 2016 dhe 2017.

² Nga gjithsej 30 tregues, sepse 12 janë të ngrirë.

3.1. Kushtet minimale

Granti i Performancës Komunale (GPK) ka pesë kushte minimale që duhet të plotësohen nga komunat për të qenë përfituese të këtij granti. Nga këto pesë kushte, vlerësimi këtë vit bëhet vetëm në tre prej tyre përderisa dy kushte tjera me ngjyrë trëndafili apo kushti minimal 1 dhe 2 mbesin të ngrira:

“Performanca komunale për “kushtet minimale” ka shënuar rënie në vitin 2018 krahasuar me 2017 dhe 2016 tre kushte minimale.”

1. Komunat duhet të kenë raportuar në të gjithë treguesit e SMPK-së;
2. Komunat duhet të kenë rishqyrtuar aktet ligjore të vlerësuara si të kundërligjshme nga organet mbikëqyrëse;
3. Opinioni i auditimit për vitin 2018 duhet të jetë të paktën i pamodifikuar me theksim të çështjes;
4. Komunat duhet të kenë shpenzuar 75% ose më tepër të buxhetit të vitit 2018 për investime kapitale; dhe
5. Komunat duhet të kenë nënshkruar marrëveshjen tripalëshe të pjesëmarrjes (komuna, MPL-ja dhe HELVETAS Swiss Intercooperation).

Sa i përket kushtit të tretë (3), kërkohet që komuna të ketë marrë të paktën opinion të pamodifikuar me theksim të çështjes në mënyrë që të kualifikohet për grant. Sa i përket kushtit të katërt (4), kërkohet që komuna të ketë shpenzuar së paku 75% të buxhetit nga kategoria e investimeve kapitale për t'u kualifikuar për grant si dhe kushti i pestë (5) i cili është një kusht administrativ që kërkon nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit për pjesëmarrje në grant të performancës komunale.

Për performancën e vitit 2018, 36 nga 38 komuna kanë marrë opinione pozitive (opinion të pamodifikuar me theksim të çështjes) nga ZKA-ja, kurse 24 nga 38 komuna kanë shpenzuar më shumë se 75% të buxhetit të investimeve kapitale dhe 38 komuna kanë nënshkruar marrëveshjet për pjesëmarrje në GPK. Nëse llogarisim komunat që kanë plotësuar të gjitha kushtet në mënyrë kumulative, del që 23 janë kualifikuar dhe 15 të tjera nuk janë kualifikuar për GPK-në.




Figura 2. Nr. i komunave që janë, përkatësisht nuk janë kualifikuar për grant

Nëse krahasojmë përmbushjen e kushteve minimale nga komunat për performancën e viteve 2016, 2017 dhe 2018, vërejmë se për performancën e vitit 2016 ishin kualifikuar 25 komuna, për performancën e vitit 2017 ishin kualifikuar 19 komuna kurse për performancën e vitit 2018 janë kualifikuar gjithsej 23 komuna. Në vitin 2018 është rritur numri i komunave që kanë përmbushur kushtet minimale

krahasuar me 2017, katër komuna më shumë, por në krahasim me vitin 2016, kemi dy komuna më pak të kualifikuara për grant. Pra, viti 2016 ka qenë më i mirë sa i përket numrit të komunave që kanë plotësuar kushtet minimale për t'u kualifikuar për grant krahasuar me vitet 2017 dhe 2018.

Tabela 1. Numri i komunave të kualifikuara dhe të diskualifikuara për grant në periudhën 2016-2018

Viti	Të kualifikuara	Të diskualifikuara	Total
2016	25	13	38
2017	19	19	38
2018	23	15	38

3.1.1. Opinioni i Auditorit

Komunat që kanë marrë opinion të kualifikuar me theksim të çështjes për vitin 2018 janë komuna e Ferizajt dhe ajo e Novobërdës. Komunat e tjera që kanë marrë opinion të auditorit së paku të pamodifikuar me theksim të çështjes janë 33 komuna, kurse 3 komuna kanë marrë opinion të pamodifikuar. Kjo bën që komunat e vlerësuara pozitivisht të jenë 36, pra ato me opinion të pamodifikuar dhe opinion të pamodifikuar por me theksim të çështjes. Nëse krahasojmë të dhënat për këtë kusht minimal me vitin 2017, vërehet progres. Në vitin 2017 këtë kusht e kanë përmbushur 29 komuna që në raport me vitin 2018 ka ngritje të performancës për shtatë komuna më shumë. Gjithash tu, kur krahasojmë numrin e komunave që kanë marrë opinion të kualifikuar me theksim të çështjes vërehet që ka përmirësim. Nga nëntë komuna të cilat kanë marrë opinion të kualifikuar me theksim të çështjes në vitin 2017 (Kllokoti, Suhareka, Rahoveci, Mamusha, Malisheva, Leposaviqi, Klina, Ferizaj dhe Dragashi) në vitin 2018 ka rënë numri në dy komuna.




Figura 3. Nr. i komunave dhe opinionet e auditorit

Problemet kryesore për shkak të të cilave të dy komunat nuk e kanë kaluar këtë kusht minimal për performancën e vitit 2018 janë të ndryshme. Sipas raportit të auditimit të ZKA-së për vitin 2018 për komunën e Novobërdës, të gjeturat kanë të bëjnë me përgatitje dhe shpalosje të dobët të Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF). Në këtë kuadër, disa nga mangësitë e theksuara në raport kanë të bëjnë me:

1. Mbivlerësim të buxhetit në aspekt të të hyrave;
2. Prezantimi gabimisht i buxhetit final të granteve të përcaktuara të donatorëve;
3. Gjendja e pasurive, llogarive të arkëtueshme dhe detyrimeve nuk janë prezantuar drejt në PVF;
4. Shpenzime në paga pa evidencë për vijueshmëri në punë në sektorin e arsimit;
5. Klasifikim i shpenzimeve në kategori jo adekuate;
6. Vonesa në pagesë të faturave;
7. Dobësi në menaxhimin e pasurisë;
8. Mungesë dokumentimi dhe mosrespektimi të procedurave me rastin e ndarjes së subvencioneve, etj.

Sipas raportit në fjalë, auditori ka konstatuar mungesën e kompetencës profesionale të zyrtarëve të angazhuar me këto përgjegjësi.

Sa i përket komunës së Ferizajt, po ashtu kemi të bëjmë me mangësi/probleme sa u përket përgatitjes dhe shpalosjes së PVF-ve dhe disa nga mangësitë e evidentuara në raport janë:

1. Mos planifikim i duhur i buxhetit;
2. Keq klasifikim i shpenzimeve;
3. Mos dokumentim i pagesave nga kategoria e investimeve kapitale dhe mallrave e shërbimeve;
4. Regjistrim i të hyrave në kode jo adekuate;
5. Parregullsi në kalkulimin e të hyrave nga tatimi në pronë, etj.

Sipas raportit në fjalë, auditori ka konstatuar mungesën e kompetencës profesionale të zyrtarëve të angazhuar me këto përgjegjësi.

Në anën tjetër, në vitin 2018³ janë tri komuna të cilat kanë marrë opinion të pastër të auditimit apo “të pamodifikuar”. Megjithatë, nëse e krahasojmë me vitin 2017, vërejmë që numri i komunave me këtë opinion është për një më i vogël (katër komuna në vitin 2017 kurse tre komuna në 2018).

Tridhjetë e tre (33) komunat tjera kanë marrë “opinion të pamodifikuar me theksim të çështjes”. Çështjet që janë theksuar nga auditori për shumicën absolute të komunave përfshijnë si në vijim: Keq klasifikim i shpenzimeve, mos-dokumentim i pagesave, llogaritë e arkëtueshme të nënvlerësuara, pasuritë kapitale të nënvlerësuara, mos-regjistrim i pasurive kapitale në SIMFK, pronat e paregjistruara; shpalosjet jo të sakta, pasuritë kapitale të mbivlerësuara etj. Sipas hulumtimeve, nevojiten të ndërmerren veprime specifike për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për t'i eliminuar të gjeturat e auditorit p.sh. gabimet në klasifikimin e shpenzimeve; vlerësimi i saktë i obligimeve të papaguara dhe pasurive kapitale, shpalosjet e duhura sipas rregullores së Thesarit, etj.

“Tri komuna kanë marrë opinion të pamodifikuar nga ZKA në vitin 2018”

³ Shtime, Viti dhe Ranillug.

3.1.2. Shpenzimet buxhetore

Siç tregojnë gjetjet e analizës së të dhënave për vitin 2018, 24 komuna kanë shpenzuar së paku 75% të buxhetit të tyre në investime kapitale, kurse 14 të tjera kanë shpenzuar më pak se 75% të buxhetit për investime kapitale. Kjo do të thotë se 14 komuna nuk e kanë plotësuar kushtin minimal që ka të bëjë me shpenzimin e më shumë se 75 % të buxhetit të investimeve kapitale. Numri i komunave që kanë arritur këtë kusht ka rënë në vitin 2018 në krahasim me vitet 2016 dhe 2017, përkatësisht këtë kusht e kanë plotësuar 25 komuna në vitin 2017 (një më shumë se në 2018) kurse në vitin 2016 e kanë plotësuar 27 komuna (apo tri më shumë se në vitin 2018). Në anën tjetër, në kuptim të mesatares së përgjithshme të shpenzimit të buxhetit për investime kapitale, ka një rritje të lehtë në 2018 krahasuar me vitet paraprake. Në këtë mënyrë, mesatarja në vitin 2016 ka qenë 75 %, në vitin 2017 ka qenë 78 % derisa në vitin 2018 mesatarja e përgjithshme e shpenzimit të buxhetit për investime kapitale ishte 79.24%.

Për të parë nivelin të shprehur në përqindje (%) të shpenzimit të buxhetit të shpenzimeve kapitale për secilën nga 14 komunat që nuk e kanë plotësuar këtë kusht, shih figurën në vazhdim.




Figura 4. Përqindja e shpenzimit të buxhetit të investimeve kapitale nga 14 komuna⁴

Në anën tjetër, për të parë krahasimin në mes të viteve të numrit të komunave që kanë kaluar, përkatësisht nuk kanë kaluar kushtin e shpenzimit të buxhetit të investimeve kapitale më shumë se 75%, shih figurën në vazhdim.

⁴ Sipas raportit të performancës komunale, MPL 2018




Figura 5. Nr. i komunave rreth shpenzimit të buxhetit për investime kapitale

Ndër shkaqet kryesore se pse komunat kanë dështuar të shpenzojnë 75% ose më shumë nga buxheti i tyre i investimeve kapitale ka të bëjë me një numër sish, si: mangësi në procesin e prokurimit publik, menaxhim të kontratave, dobësi në planifikimin e investimeve kapitale, mungesën e planifikimit adekuat të buxhetit dhe të tjera, prokurimi i centralizuar, mungesa e rishikimit buxhetor, etj.⁵ Në performancën e dobët të komunave ka ndikuar gjithashtu edhe mos shfrytëzimi i të hyrave vetanake i cili ishte vetëm 54% në nivel të të gjitha komunave⁶. Raporti Vjetor i Auditimit 2018 gjithashtu konstaton se për shkak të procedurave të tej-zgjatura të prokurimit, ankesave të operatorëve në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), çështjeve të pazgjadhura pronësore, shkalla e ekzekutimit të buxhetit në këtë kategori vazhdon të mbetet më e ulëta për vite me radhë. Nëse analizojmë një nga një çështjet tek investimet kapitale që ka ngritur ZKA-ja si mangësi në raporte në këto 14 komuna, atëherë del se Deçani, Kamenica, Podujeva dhe Zveçani kanë pasur nga një çështje. Për Deçanin⁷ është theksuar “mangësia në procesin e prokurimit publik”, për komunën e Kamenicës⁸ është theksuar “mbivlerësim i investimeve kapitale dhe pagesa si avans para përfundimit të projektit”, për komunën e Podujevës⁹ është theksuar “vonesa në kryerjen e projekteve”. Në anën tjetër, komunat që kanë pasur më së shumti të gjetura në pjesën e investimeve kapitale në raportin e auditimit të ZKA-së janë komuna e Zubin Potokut, ajo e Mitrovicës së Veriut, Parteshit dhe Istogut të cilat kanë pasur në mes katër dhe gjashtë çështje. Investime kapitale në komunën e Zubin Potokut¹⁰ në vitin 2018 janë karakterizuar me: 1) dobësi sistematike në menaxhimin e pagesave dhe pranimin e punëve për investime kapitale, 2) inicim i procedurave të prokurimit pa fonde të mjaftueshme, 3) zotim i mjeteve pas pranimit të faturave, 4) mungesë e projektit ekzekutues, 5) mungesë e dëshmimeve gjatë vlerësimit të kriterëve për dhënien e shtëpive për familjet skamnore dhe 6) vonesa në ekzekutimin e kontratave.

Investimet kapitale në vitin 2018 në komunën e Mitrovicës së Veriut¹¹ janë karakterizuar me: 1) planifikim i dobët i sasive në kontratë, 2) dobësi në menaxhimin e kontratave, 3) vonesa në realizimin e projekteve, 4) kryerje të punëve pa kontratë dhe 5) mangësi në procesin e vlerësimit të tenderëve. Investimet kapitale në vitin 2018 në komunën e Parteshit¹² janë karakterizuar me: 1) dobësi në procedura të prokurimit, 2) mangësi në procedura për punë shtesë, 3) mos aplikim i librit ndërtimor, 4) vonesa në realizimin e projekteve dhe 5) ndarja e tenderëve dhe përdorimi i procedurave minimale. Në komunën e Istogut¹³, investimet kapitale për vitin 2018, sipas raportit të auditimit të ZKA-së për këtë komunë, janë karakter-

5 Fokus Grup/Punëtori me temën: Financat Publike, mbajtur në Prishtinë, 16 maj 2018.

6 Raporti Vjetor i Auditimit 2018, ZKA, f. 30

7 Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA), Raporti i auditimit për Komunën e Deçanit, 2018.

8 Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA), Raporti i auditimit për Komunën e Kamenicës, 2018

9 Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA), Raporti i auditimit për Komunën e Podujevës, 2018

10 Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA), Raporti i auditimit për Komunën e Zubin Potokut, 2018

11 Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA), Raporti i auditimit për Komunën e Mitrovicës së Veriut, 2018

12 Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA), Raporti i auditimit për Komunën e Parteshit, 2018

13 Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA), Raporti i auditimit për Komunën e Istogut, 2018

izuar me: 1) mungesa të projektit ekzekutues në 15 kontrata pune të nënshkuara, 2) tejkalim i punëve shtesë (aneks kontrata me vlerë me të madhe se 10% e vlerës totale të kontratës), 3) mosrespektim i kriterëve të përcaktuara në dosje të tenderit dhe 4) pagesa në mungesë të dëshmive të mjaftueshme. Në mesin e tetë komunave me numrin më të vogël dhe më të madh të çështjeve të identifikuara në raporte individuale të auditimit të ZKA-së, janë edhe gjashtë komunat tjera të cilat kanë në mes dy dhe 4 çështje e të cilat bëjnë pjesë në grupin e çështjeve të cekura për tetë komunat tjera.

Burimet sekondare dhe hulumtimet në terren kryesisht konfirmojnë gjetjet e analizës së të dhënave lidhur me nivelin e shpenzimit të buxhetit për investime kapitale. Në raportin “Vlerësimi i Kapaciteteve të Komunës (2018)” MPL ka treguar se shqetësimi kryesor për komunat janë planifikimi dhe alokimi i buxhetit. Prandaj, buxhetet komunale nuk janë gjithmonë në përputhje me nevojat e tyre.¹⁴ Si pasojë, ka shumë mospërputhje mes prioriteteve të qeverisë qendrore dhe lokale, duke filluar me dokumentet strategjike dhe buxhetore (p.sh. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve - KASh). Raporti nga ZKA-ja¹⁵ konstaton se KASh-i nuk trajtohet mjaftueshëm për të siguruar planifikime buxhetore në përputhje me prioritetet strategjike.

Po ashtu, tavanet e buxhetit “të vendosura në qarkoret e buxhetit përbëjnë pengesë për të arritur objektivat komunale”¹⁶, ndërkohë që, komunat në Kosovë varen nga mbështetja e qeverisë në investimet kapitale. Kjo në veçanti bëhet problem më i madh në rastin e financimit diskrecional ose financimit që komunat marrin nga ministritë e linjës për sektorë të veçantë (kjo përjashton grantet operationale), të cilat jepen pa kriterë të qarta dhe kryesisht në baza politike. Sipas analizës së të dhënave të SDC/DEMOS¹⁷, vlera e përgjithshme e investimeve nga ministritë e linjës ishte mesatarisht 311 mil. euro ose 44.47 mil. euro në vit. Investitori më i madh ishte Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit (MIT) me 148 mil. euro ose 47% të vlerës totale të investuar, ndjekur nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) me 70 mil. euro ose 22% dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) me 28 mil. euro ose 9% të totalit.

Përfituesi më i madh komunal i investimeve të bëra nga ministritë e linjës ishte komuna e Skenderajt, e cila mori 43 mil. euro ose 13.9% të vlerës totale të investuar në kompetenca komunale. Komuna e dytë është ajo e Prishtinës me 21.7 mil. euro ose 6.9% dhe komuna e Pejës në vendin e tretë me 20.8 mil. euro ose 6.7% të totalit. Sa u përket investimeve për kokë banori, përfituesi më i madh ishte komuna e Skenderajt me 822 euro për kokë banori, ndjekur nga komuna e Shtimes me 385.5 euro dhe komuna e Hanit të Elezit me 363.3 euro për kokë banori.

Sipas Ligjit të Buxhetit për vitin 2018¹⁸, investimet e përgjithshme kapitale të planifikuara nga komunat arrinin shumën prej 146,115,081 Euro. Nga kjo shumë, 60.2% ishin planifikuar të financohen nga granti qeveritar dhe 39% nga të hyrat vetanake. Të hyrat nga tatimi në pronë përbëjnë të hyrat më të mëdha vetanake ose 30% të të gjitha të hyrave dhe janë pjesë e rëndësishme e kësaj kategorie. Tatimi në pronë i inkasuar për faturimin e vitit 2018 përbën 16% të të gjitha të hyrave vetanake. Mos vjelja e tatimit në pronë mund të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në shkallën e realizimit të shpenzimeve kapitale. Sipas Ligjit për Buxhetin për vitin 2017, investimet e përgjithshme kapitale të planifikuara nga komunat arrinin shumën prej 130,838,116 Euro. Nga kjo shumë, 54% ishin planifikuar të financohen nga granti qeveritar dhe 46% nga të hyrat vetanake.

Vlerësim të saktë nuk kemi nga raportet sekondare, por në bazë të ligjit të ri në tatim është përfshirë edhe tatimi në toka (parcela) ku konsiderohet që për vitin 2019 ka ndikuar në rritjen e tatimit në një mase deri 10% e të hyrave (p.sh. në një komunë të madhësisë mesatare si p.sh. komuna e Lipjanit). Me këtë konsiderohet që të ketë pasur rritje graduale nëpër komuna. Meqenëse, mungon referenca është

14 MPL, Vlerësimi i Kapaciteteve të Komunës, 2018, f. 21-22.

15 Raporti i Auditimit të Performancës “Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2018 – 2020 në sektorin e arsimit dhe të infrastrukturës”, Dhjetor 2019

16 MPL, Vlerësimi i Kapaciteteve të Komunës, 2018, f. 4.

17 SDC/Helvetas Demos, Investimet Kapitale nga Ministritë e linjës në kompetenca komunale për periudhën 2011-2017, Shkurt 2019.

18 Ligji nr. 06/L-020 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015.

vështirë të bëhet ndonjë vlerësim për të gjitha komunat, prandaj s'kemi ndonjë vlerësim në lidhje me këtë!

Disa probleme të identifikuar nga ZKA-ja që mund të ndërlihen me performancën e dobët të komunave në planifikimin dhe shpenzimin në investime kapitale mund të kërkojnë ndryshime sistematike, jo domosdo vetëm ngritje të kapaciteteve. Si ndryshim sistematik mund të përmendim, planifikimin më të detajuar të projekteve nga ana e komunave, monitorimi i vazhdueshëm i projekteve, vendosja e stafit kompetent (profesional) në monitorim, si dhe aplikim i penaltive në rast të mos kryerjes së punëve sipas afatit të parapërcaktuar. Gjithashtu, mund të përmendet edhe ligji i prokurimit publik si ndryshim sistematik por që nuk kemi analizë që na dëshmon se me ndryshimin e këtij ligji do të përmirësohen planifikimi dhe shpenzimi i buxhetit të investimeve kapitale.

Gjithashtu, duhet të merret parasysh që gjatë vitit 2019 ka pasur ndryshim legjislativ që mund të ndikojë në problemet e gjetura gjatë hulumtimit duke llogaritur se këto analiza kanë të bëjnë me performancën e vitit 2018. Ministria e Financave (MF) ka përgatitur Udhëzimin Administrativ (UA) për kriteret përzgjedhëse dhe prioritizimin e projekteve kapitale që fillon të zbatohet në Janar 2020 dhe UA për definimin dhe klasifikimin e shpenzimeve të projektit kapital. Këto udhëzime paraqesin kërkesa të reja në përgatitjen e projekteve kapitale. Gjithashtu, duhet të merret parasysh fakti që projekte të tjera janë të angazhuara në trajnimin e zyrtarëve komunalë (p.sh. programi i USAID/TEAM për ngritjen e kapaciteteve në fushën e prokurimit publik, planifikim të buxhetit) dhe duhet pasur kujdes për të evituar mbivendosjen e mundshme.

3.2. Qeverisja demokratike lokale

Qeverisja demokratike në nivel lokal paraqet fushën e parë të vlerësimit të performancës së komunave. Vlerësimi bëhet për 38 komunat dhe fusha përkatëse ndahet në tri nën-fusha që në total ka 13 tregues sipas tabelës në vijim.

Nën-fusha e parë ka pesë tregues, nën-fusha e dytë ka tre tregues dhe nën-fusha e tretë ka pesë tregues. Megjithatë, secila prej tre nën-fushave ka tregues të ngrirë, nga 13 tregues në total për tërë fushën, pesë prej tyre janë të ngrirë kurse analiza dhe vlerësimi bëhen për vetëm tetë tregues. Treguesit e ngrirë paraqiten me ngjyrë tërëdhënëse në tabelën në vazhdim për të bërë të qartë se cilët janë dhe nuk janë pjesë e analizës dhe vlerësimit të komunave për këtë fushë

Tabela 2. Fusha e qeverisjes demokratike, nën-fushat dhe treguesit

Fusha: Qeverisja demokratike lokale	
Nën-fusha 1: Roli i Kuvendit Komunal si organ mbikëqyrës	
1.	Dorëzimi me kohë dhe miratimi i buxhetit komunal në Kuvendin Komunal
2.	Diskutimi i raporteve buxhetore tre-mujore nga Kuvendi Komunal
3.	Diskutimi i raportit të performancës komunale nga Kuvendi Komunal
4.	Diskutim i raportit të auditorit të jashtëm dhe planit të veprimit për adresimin e rekomandimeve si dhe diskutimi i gjetjeve dhe rekomandimeve nga auditimi i brendshëm në Kuvendin Komunal
5.	Raportimi i Kryetarit të Komunës para Kuvendit Komunal
Nën-fusha 2: Pjesëmarrja, konsultimi dhe gjithëpërfshirja e qytetarëve	
6.	Pjesëmarrja e qytetarëve në konsultimet publike të ndara sipas gjinisë
7.	Aktet komunale dhe dokumentet e politikave lokale të konsultuara me publikun

8.	Seancat dëgjimore publike për KAB-në dhe buxhetin komunal (proporcionalisht ndaj numrit të banorëve)
Nën-fusha 3: Transparenca, qasja në informata dhe integriteti	
9.	Takimet e Kuvendit Komunal të bëra publike dhe të transmetuara drejtpërdrejt
10.	Përditësimi i rregullt i ueb-faqes komunale sipas kërkesave (specifike) ligjore
11.	Publikimi i dokumenteve dhe kontratave të prokurimit publik
12.	Publikimi i procesverbaleve për proceset e konsultimeve publike
13.	Raportimi i planit vjetor të planit të integritetit të paraqitur para Kuvendit Komunal

Treguesit e kësaj fushe janë kryesisht të lidhur me detyrime ligjore, me përjashtim të treguesit tre (3) “diskutim i raportit të performancës komunale nga Kuvendi Komunal (KK)” dhe treguesit 13 “raportimi i planit vjetor të planit të integritetit të paraqitur para Kuvendit Komunal” të cilët paraqesin praktikë të mirë sa i përket qeverisjes lokale. Në anën tjetër, treguesit e tjerë janë pjesë apo kërkesë e disa ligjeve që kanë të bëjnë me: vetëqeverisjen lokale¹⁹, menaxhimin e financave publike²⁰, auditorin e përgjithshëm²¹ dhe akteve nënligjore për transparencë në komuna dhe standardet minimale të konsultimit publik në komuna.²²

Para se të analizohet performanca e komunave sipas nën-fushave dhe treguesve përkatës, në vazhdim paraqitet një pasqyrë e përgjithshme e performancës së komunave në fushën e qeverisjes demokratike.

Mesatarja e të gjitha komunave në të gjithë treguesit e matshëm në këtë fushë është mbi 59% derisa në tri nën-fushat, ato kanë arritur këtë mesatare:

- në nën-fushën e rolit të kuvendit si organ mbikëqyrës komunat kanë arritur mbi 58%,
- në nën-fushën e pjesëmarrjes, konsultimit dhe përfshirjes së qytetarëve mbi 49% dhe
- në nën-fushën e transparencës, qasjes në informata dhe integritetit mbi 65%.

Në bazë të kësaj, mund të thuhet që komunat si tërësi kanë nevojë për ngritje të kapaciteteve sidomos në dy nën-fushat të cilat kanë të bëjnë me raportin e komunës me qytetarët ngase në të flitet për transparencë, gjithëpërfshirje, konsultime, pjesëmarrje të publikut, qasje në informata, etj.

Sa i përket performancës së komunave individualisht në të gjithë fushën e qeverisjes demokratike, mesatarja më e lartë është 94% (Juniku).

Me qëllim të të kuptuarit më nga afër të performancës komunale në fushën e “qeverisjes demokratike”, është krijuar një “sistem i semaforit”. Sistemi përdoret për të identifikuar nevojat prioritare thelbësore për të ndihmuar komunat të përmirësojnë performancën e tyre. Tabela me ngjyra e paraqitur në figurën në vijim shpjegon se në cilët tregues komunat kanë treguar performancë të dobët, mesatare apo të mirë në shkallë nga 0 deri 100 për qind. Ngjyra “e kuqe” paraqet performancën e dobët, ngjyra “e verdhë” paraqet performancën mesatare, ndërsa “e gjelbra” paraqet performancën e mirë. Treguesit me ngjyrë të kuqe janë të rëndësishëm më të madhe sa u përket dizajnit dhe ofrimit të trajnimeve. Rëndësia sipas ngjyrës përcaktohet duke u bazuar në numrin e komunave të cilat kanë treguar performancë të dobët, mesatare apo të mirë.

19 Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale sa u përket treguesve 2, 4, 5, 6, 7 dhe 10.

20 Ligji nr. 04/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë sa u përket treguesve 2 dhe 4.

21 Ligji nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit sa i përket treguesit 4.

22 UA (MPL) nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna sa i përket treguesit 6 dhe UA (MPL) nr. 04/2018 për Transparencë në Komuna sa u përket treguesve 7 dhe 10.




Figura 6. Sistemi i "semaforit" në fushën e qeverisjes demokratike lokale

3.2.1. Roli i Kuvendit Komunal si organ mbikëqyrës

Sipas tabelës më lartë, roli i Kuvendit Komunal është nën-fusha e parë e cila trajtohet në vijim. Kjo nën-fushë ka pesë tregues nga të cilat katër janë të matshëm²³ dhe pikët maksimale që komuna i merr në këta tregues është 13. Performanca e secilës komunë në këtë tregues do të analizohet/vlerësohet në vijim. Sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale, KK është organi më i lartë në komunë, zgjidhet drejtpërdrejt nga qytetarët dhe përfaqëson organin legjislativ në komunë.²⁴ KK ka një numër të funksioneve të përcaktuara me ligjin përkatës të cilat lidhen me hartimin dhe miratimin e statutit të komunës, rregulloreve komunale, miratimin e buxhetit, planit dhe raportit vjetor të punës, mban llogaridhënës kryetarin e komunës përmes raportimeve periodike në Kuvendin Komunal, themelimin e komisioneve të kuvendit dhe të tjera të cilat në kuadër të ligjit janë të përcaktuara me statutin e komunës. Kuvendi i Komunës, përmes anëtarëve të tij, e mban përgjegjës ekzekutivin përmes kërkesave për informacione lidhur me çështje komunale, miratimit të buxhetit komunal dhe diskutimeve të raporteve tre-mujore buxhetore, raportimit të kryetarit në Kuvendin komunal për situatën e përgjithshme ekonomike dhe financiare në komunë, bashkërendimit të agjendës në mes të kryetarit të komunës dhe kryesuesit të Kuvendit Komunal, etj.

3.2.1.1. Diskutimi i raporteve buxhetore tremujore nga Kuvendi Komunal (KK)

Diskutimi i raporteve buxhetore nga KK kërkohet katër herë në vit, pra raportet duhet të dërgohen nga ekzekutivi në Kuvendin Komunal për diskutim në baza tremujore. Në bazë të kësaj kërkesë, komunat janë renditur varësisht se sa herë kuvendet e tyre komunale kanë diskutuar raportet buxhetore në baza tremujore. Komunat grupohen në bazë të kësaj formule: komunat që kanë diskutuar katër herë raportin në fjalë në kuvendet komunale marrin vlerën 100%, komunat që kanë diskutuar tri raporte marrin 75%, komunat që kanë diskutuar dy ose më pak raporte tremujore marrin 50% dhe komunat të cilat nuk kanë diskutuar asnjëherë raportin marrin 0%. Në bazë të të dhënave të grumbulluara në Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale (SMPK), 24 komuna e kanë arritur plotësisht këtë tregues duke diskutuar katër herë në vit raportet komunale, shtatë komuna tjera kanë diskutuar tre herë raportet brenda vitit duke e arritur 75%, pesë komuna tjera e kanë diskutuar raportin tremujor buxhetor prej një

²³ Treguesit 2, 3, 4, dhe 5 janë të matshëm dhe analizohen në tekst derisa treguesi 1 është i ngrirë.

²⁴ Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Neni 40.

deri në dy herë brenda vitit dhe kanë marrë 50% dhe dy komuna nuk kanë dërguar të dhëna nëse kanë diskutuar raportet përkatëse ndonjëherë gjatë vitit (komuna e Zveçanit dhe ajo e Leposaviqit).

Sa i përket krahasimit në mes të 2018-tës dhe viteve paraprake (2016 dhe 2017), numri i komunave që kanë plotësuar kushtin në masën 100% është i njëjtë me vitin 2016 (24) kurse më i lartë krahasuar me vitin 2017, (20 komuna). Numri i komunave që e kanë plotësuar kushtin në masën 75% është më i lartë në 2018 (shtatë komuna) se sa në 2016 dhe 2017 kur numri ka qenë katër komuna. Numri i komunave që kanë diskutuar dy ose më pak raporte (deri në masën 50%) në 2018 është i njëjtë me 2016 (pesë komuna) mirëpo ky numër ka qenë më i lartë në vitin 2017 (pra 12 komuna kanë diskutuar raportet tremujore deri në 50%). Në grupin e fundit janë komunat që nuk kanë raportuar të dhëna dhe numri i tyre në 2018 është i njëjtë me 2017 (dy komuna) derisa numri i tyre kishte qenë edhe më i lartë në vitin 2016 (pesë komuna). Pra, po shohim që numri i komunave që nuk raportojnë të dhëna ka pësuar rënje e që është sinjal i mirë.

Grupimi i komunave sipas këtij kriteri dhe krahasimi në mes viteve është dhënë në figurën në vijim.




Figura 7. Nr. i komunave që (nuk) kanë diskutuar raportet tremujore buxhetore

Mesatarja e 38 komunave në këtë tregues ka vlerën e 79%. Përveç dy komunave që nuk kanë raportuar të dhëna (Zveçani dhe Leposaviqi), pesë komuna tjera që kanë plotësuar kërkesën deri 50% janë Fushtë-Kosova, Kamenica, Mamusha, Shtërpca dhe Zubin Potoku, kurse shtatë komunat që kanë plotësuar treguesin në masën 75% janë: Ferizaji, Kllokoti, Obiliqi, Parteshi, Podujeva, Prizreni dhe Ranillugu. Jashtë këtyre tre grupeve janë 24 komunat tjera të cilat kanë plotësuar treguesin në 100%. Megjithatë, edhe pse të dhënat paraqesin performancë të mirë për këtë tregues, raportet tremujore të buxhetit nuk diskutohen thellësisht në Kuvend Komunal.²⁵ Në shumicën e rasteve raportet diskutohen vetëm sa për të plotësuar kërkesën ligjore derisa mungon debati substancial mbi raportin në fjalë. Për shembull, raportet e buxhetit rrallë kontestohen nga anëtarët e kuvendeve komunale dhe kryetarët e komunave rrallë mbahen përgjegjës për atë se çka raportojnë në Kuvend Komunal. Në anën tjetër, legjislati në fuqi mbi transparencën në komuna obligon komunat që raporte të ndryshme përfshirë raportet buxhetore të diskutohen edhe me qytetarë përmes takimeve konsultative që organizon komuna me qytetarë.²⁶ Edhe pse këto takime mbahen në fundvit, diskutimi është sipërfaqësor ngase tabelat e shpenzimeve buxhetore janë të paqarta për qytetarë por edhe për vetë anëtarët e Kuvendit Komunal.²⁷

Shkak tjetër që lidhet me mos diskutimin substancial të raporteve buxhetore në Kuvend Komunal është edhe përgatitja e anëtarëve të kuvendeve komunale të cilët në shumë raste janë të rinj në detyrë dhe të

25 Fokus grup/Punëtori. Tema: Mbikëqyrja dhe Pjesëmarrja. Prishtinë, Kosovë. 17 maj 2018.

26 UA nr. 04/2018 për Transparencë në Komuna, Neni 11, takime tjera konsultative.

27 Bazuar në trajnimet e mbajtura nga DEMOS gjatë vitit 2019.

painformuar sa u përket shpenzimeve buxhetore. Meqenëse nuk kanë përvojën dhe njohuritë e duhura në leximin e tabelave të shpenzimeve buxhetore (përveç që ato janë të paqarta), kjo e pamundëson ushtrimin e përgjegjësisë që anëtarët e kuvendit kanë në trajtimin e raporteve financiare që është në kuadër të mbikëqyrjes së ekzekutivit nga legjislativi.²⁸ Një shkak i tretë që është vërejtur nga monitorimi i seancave të kuvendeve komunale është edhe aspekti teknik në gjenerimin dhe hartimin e raporteve financiare që shkakton vonesa në dërgimin e raporteve në Kuvend Komunal nga softueri (Free Balan ²⁹

Ngritja e kapaciteteve të anëtarëve të kuvendeve komunale, sa u përket rolit dhe përgjegjësisë si autoriteti më i lartë i procesit të vendimmarrjes, mbetet thelbësor në trajtimin si dhe leximin e duhur dhe të saktë të raporteve financiare të gjeneruara nga ekzekutivi komunal. Trajnimi për leximin e drejtë të buxhetit nga të gjithë anëtarët e kuvendeve komunale është gjithashtu edhe kërkesë nga anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF). Trajnimi në këtë fushë për anëtarë të KPF-së është mbajtur në vitin 2019 me të gjitha komunat.³⁰

Në anën tjetër, ajo që mund të bëhet në këtë drejtim për të rritur pro aktivitetin dhe efektivitetin e kuvendeve komunale është ngritja e vazhdueshme përmes trajnimeve të vetëdijes së anëtarëve të Kuvendit Komunal mbi rolin që kanë dhe veprimet që mund të marrë një anëtar në funksion të të qenit aktiv dhe kërkues ndaj ekzekutivit komunal. Janë një numër veprimesh që mund të ndërmarrin anëtarët e Kuvendit Komunal siç janë: iniciimi i rregulloreve të reja dhe plotësimi i atyre ekzistuese, propozimi i pikave për diskutim në rend të ditës, iniciimi i Komiteteve komunale jo të përhershme dhe konsultative, plotësimi dhe ndryshimi i buxhetit, etj.³¹

3.2.1.2. Diskutimi i raportit të performancës komunale në Kuvendin Komunal

Diskutimi i raportit të performancës komunale (për vitin paraprak në Kuvendin Komunal) nuk është kërkesë ligjore, mirëpo diskutimi i tij është praktikë e mirë në aspektin e qeverisjes komunale dhe praktikë e mirë e punës së Kuvendit Komunal. Ajo që ky tregues vlerëson është nëse komunat, përkatësisht kuvendet komunale kanë diskutuar raportin në fjalë. Për të matur këtë tregues, kërkohet dëshmi se raporti i SMPK-së është përfshirë si pikë në agjendën e Kuvendit Komunal.

Diskutimi i gjetjeve të raportit të SMPK-së nga kuvendet komunale, tregon se anëtarët e Kuvendit Komunal interesohen për performancën e ekzekutivit dhe kërkojnë llogari në pjesët ku nuk ka pasur performancë të mirë. Nëse ky raport diskutohet në Kuvend Komunal, komuna merr maksimumin e pikëve, ndërsa nëse nuk diskutohet komuna merr 0 pikë. Numri i komunave që kanë diskutuar raportin në fjalë është 16, i atyre që nuk e kanë diskutuar raportin është 20 derisa për dy komuna (Leposaviq dhe Zubin Potok) nuk ka pasur të dhëna. Mesatarja e 38 komunave në këtë tregues është e ulët (edhe në krahasim me mesataren e treguesit paraprak) dhe është 42%.

Edhe pse numri i komunave që e kanë diskutuar raportin është më i vogël se sa numri i komunave që nuk e kanë diskutuar këtë raport, nëse shohim trendin nga viti 2016, mund të thuhet se ka progres në këtë tregues. Numri i komunave që kanë diskutuar në kuvendet komunale raportin e SMPK-së është më i lartë në vitin 2018 se sa në vitet 2016 dhe 2017 (nga 10 komuna) dhe natyrisht numër më i vogël i komunave që nuk e kanë diskutuar këtë raport (20 në 2018) kurse 21 në vitin 2016 dhe 25 në vitin 2017. Po ashtu, numri i komunave që nuk kanë raportuar të dhëna mbi këtë tregues është më i vogël në 2018 (dy komuna) në krahasim me 2016 (shtatë komuna) dhe 2017 (tre komuna). Për të parë krahasimin në mes viteve për këtë tregues, shih figurën në vazhdim.

28 Vëzhgime nga monitorimi i seancave të KK-së.

29 Vëzhgime nga takimet me kryetarë të komunave, gjatë vitit 2018

30 Raportet e vlerësimit nga trajnimi dhe raportet e identifikimit të nevojave, 2019.

31 Demokraci Plus (D+), Doracak praktik për anëtarë të kuvendeve komunale për përfaqësues pro-aktiv dhe efektiv.




Figura 8. Nr. i komunave që (nuk) e kanë diskutuar raportin e performancës në KK

Meqenëse numri i komunave që nuk e kanë diskutuar raportin në KK është mjaft i lartë, kjo për shkak se raporti i performancës është publikuar vonë në maj 2019 dhe komunat nuk kanë pasur afat ta vendosin në mbledhjen e Qershorit. Mirëpo, për hir të komunave që kanë raportuar në këtë tregues, të dhënat janë publikuar por nuk janë llogaritur sipas përqindjes mesatare+ të performancës në nivel të treguesve. Duhet të konsiderohet organizimi i trajnimeve mbi sistemin e menaxhimit të performancës komunale, metodologjia e vlerësimit të performancës dhe nxitja e KK që të diskutojë këtë raport pas publikimit të tij nga MPL-ja. Kjo bëhet e domosdoshme edhe nga fakti që MPL-ja, në vitin 2020, ka paraparë hartimin e një rregulloreje të re³² për menaxhimin e performancës në komuna dhe faktit që sistemi do të pësojë ndryshime për shkak se do të përfshijë edhe më shumë fusha dhe tregues sipas fushave. Sipas vendimit të MPL-së për themelimin e grupit punues mbi hartimin e kësaj rregulloreje, afati për përfundimin e rregullores është 30 qershor 2020 duke përfshirë edhe kohën e konsultimeve paraprake dhe konsultimeve publike.³³ Pra, meqenëse kjo rregullore do të mund të hyjë në fuqi gjatë muajve korrik apo gusht 2020, organizimi i trajnimeve në komuna pas hyrjes në fuqi të rregullores duke filluar nga përmbajtja e rregullores së re, ndryshimet që kanë pësuar në sistem, fushat që janë shtuar, vlerësohet i domosdoshëm. Kjo mund të vlerësohet se mund të ndikojë edhe në rritjen e numrit të komunave që në të ardhmen do të diskutojnë raportin e performancës për komunën e tyre sapo raporti në fjalë të publikohet nga MPL-ja. Po ashtu, përveç organizimit të trajnimeve për anëtarët e Kuvendit Komunal (sidomos për komunat ku në kuvendet komunale nuk diskutohet ky raport) që të rritet vetëdijesimi mbi raportin dhe rëndësinë e tij edhe në aspekt të mbikëqyrjes së ekzekutivit, trajnime specifike do të duhej të organizoheshin edhe për zyrtarët komunalë për performancë dhe koordinatorët përkatës të cilët janë të angazhuar në grumbullimin dhe raportimin e të dhënave.

Përveç përmbushjes së kriterit si numër, komunat do të duhej të fokusoheshin në leximin kritik të raportit përkatës dhe varësisht nga të gjeturat e raportit, komunat do të duhej të nxirrnin plane konkrete veprimi për përmirësime në atë fushë dhe KK do të duhej vazhdimisht të kërkonte llogari nga ekzekutivi mbi zbatimin e aktiviteteve që dalin nga plani përkatës. Përveç trajnimit ky tregues do të adresohet edhe përmes komunikimit.

32 Rregullorja nr. 02/2017 për sistemin e menaxhimit të performancës komunale është shfuqizuar nga Ministri i MPL-së në dhjetor 2019.

33 Takimi njoftues i grupit punues është mbajtur në MPL me 27 shkurt 2020.

3.2.1.3. Diskutimi i raportit të auditorit të jashtëm dhe planit të veprimit për adresimin e rekomandimeve në Kuvend Komunal dhe diskutimi i raportit të punës së auditorit të brendshëm në Kuvend Komunal

Në bazë të kërkesave ligjore të përcaktuara me legjislacionin relevant për financat publike,³⁴ kërkohet që KK të diskutojë raportin vjetor të auditimit të ZKA-së dhe raportin vjetor të auditimit të bërë nga njësi e auditimit të brendshëm në komunë. Përveç kësaj, ekzekutivi kërkohet që të paraqesë dy plane: njërin për adresimin e rekomandimeve nga raporti i ZKA-së dhe planin tjetër për adresimin e gjetjeve nga raporti i auditimit të brendshëm. Pra, këto katër elemente janë pjesë e një treguesi në këtë raport. Formula është e tillë që komuna vlerësohet nëse ka diskutuar raportin e ZKA-së dhe ka paraqitur planin për zbatimin e rekomandimeve dhe nëse ka diskutuar ndarazi edhe raportin bashkë me planin që lidhet me auditimin e brendshëm të komunës të kryer nga njësi e brendshme e auditimit. Në bazë të pikëve që marrin komunat në dy treguesit, mesatarja e dy treguesve është ajo që merret për bazë në renditjen e komunave sipas përqindjes apo pikëve që kanë marrë në këtë tregues. Pikët që jepen për komuna janë sipas kësaj (0 pikë nëse mesatarja e dy treguesve është më e vogël se 50 %, 2 pikë nëse mesatarja e treguesit është në mes 50% dhe nën 99% dhe 4 pikë nëse mesatarja e dy treguesve është 100%).

Është e rëndësishme të ceket se në vitin 2018 ky tregues është matur pjesërisht, kjo për shkak se ZKA-ja nuk ka mbledhur të dhëna për raportimin e raportit të auditimit të brendshëm dhe planin e veprimit në kuvend. Sipas rezultateve të pranuar nga ZKA-ja, asnjë komunë nuk ka marrë 4 pikë apo 100% të rezulttit për shkak se në vitin 2018 ky tregues është matur pjesërisht, kjo për shkak se ZKA-ja nuk ka mbledhur të dhëna për raportimin e raportit të auditimit të brendshëm dhe planin e veprimit në kuvend. 24 komuna kanë marrë nga 2 pikë apo 50% dhe 14 komuna tjera kanë marrë zero (0) pikë ngase mesatarja e dy treguesve ka qenë më e vogël se 50%. Në anën tjetër, mesatarja në këtë tregues, e të gjitha komunave, është 36% apo dukshëm më e vogël në krahasim me mesataret e komunave në treguesit paraprakë në këtë nën-fushë. Sa i përket krahasimit të këtyre të dhënave me një vit më herët (2017), vërehet se ka pak dallime. Në vitin 2017 numri i komunave me nga dy pikë (50 – 99%) ishte 25 kurse i komunave me zero (0) pikë ishte 13, kurse po ashtu në vitin 2018, asnjë komunë nuk kishte arritur maksimumin e pikëve (4 pikë) apo 100%. Ndarja e komunave sipas këtij rezultati por edhe krahasimi me vitin 2017 është dhënë në figurën më poshtë.




Figura 9. Nr. i komunave që (nuk) kanë diskutuar raportin e auditorit të jashtëm dhe të brendshëm në KK

Ky tregues është shumë i rëndësishëm sa i përket rolit të anëtarëve të kuvendit për të rritur transparencën, besimin dhe për të forcuar demokracinë lokale. Për këtë arsye, projekti DEMOS ka organizuar

³⁴ Ligji nr. 03/L-221 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Nenet 46.1 dhe 46.2.

trajnim në këtë fushë gjatë vitit 2019 për anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa për të gjitha komunat, dhe si rekomandim i tyre ka qenë që një trajnim i tillë të mbahet me të gjithë anëtarët e kuvendeve komunale. Duke u bazuar në format e vlerësimeve dhe kërkesat e pjesëmarrësve gjatë trajnimeve, ky trajnim është përsëritur me të gjithë anëtarët e kuvendeve komunale nga të gjitha komunat (përpos komunave të veriut në fillim të vitit 2020 (janar, shkurt, mars).

Në anën tjetër, pavarësisht se kuvendet komunale në planet e tyre të punës përfshijnë rishikimin dhe diskutimin e raporteve të auditorit të jashtëm dhe të brendshëm (edhe pse kjo e fundit nuk është kërkesë ligjore), megjithatë jo të gjitha komunat i diskutojnë këto raporte në takimet e kuvendit. Njëra ndër shkaqet është mos kërkesa nga anëtarët e kuvendit për të diskutuar këto raporte dhe plane. Kuvendet komunale hartojnë planet vjetore të tyre mirëpo këto plane kryesisht përmbajnë obligimet e tyre ligjore brenda vitit. Ngritja e kapaciteteve të anëtarëve, veçanërisht të atyre të opozitës, lidhur me monitorimin dhe zbatimin e praktikave të miratuara nga kuvendet komunale mund të ndikojë që ekzekutivi të menaxhojë në mënyrë më efikase financat dhe proceset tjera që ndikojnë në ofrimin e shërbimeve komunale. Meqenëse numri i komunave që kanë marrë zero (0) pikë është i lartë, angazhimi i kuvendeve komunale në rishikimin e planeve të zbatimit mbetet njëra ndër çështjet kryesore për t'u trajtuar në të ardhmen.

Hapësirë e mirë për ngritje të kapaciteteve përmes trajnimeve me kuvendet komunale është që anëtarëve të Kuvendit Komunal t'u tregohen të drejtat dhe detyrat e tyre të parapara në ligj, kërkesat që dalin për ekzekutivin nga ligje tjera sektoriale dhe jo vetëm nga ligji për vetëqeverisje lokale, e drejta e anëtarëve të Kuvendit Komunal për të propozuar rregullore në Kuvend Komunal me të cilat mund të mbikëqyret më mirë puna e ekzekutivit, në këtë aspekt lidhur me raportin e ZKA-së dhe raportin e njësisë së auditimit të brendshëm. Anëtarët e kuvendeve komunale duhet të jenë më aktiv, më kërkues dhe këmbëngulës në marrjen e përgjigjeve nga ekzekutivi rreth elementeve të ndryshme të qeverisjes komunale e në këtë aspekt, rreth raporteve të auditimit. Trajnimi për këtë tregues rekomandohet të mbahet për të gjitha komunat (38) sepse ato kanë ngecje në arritjen e performancë së mirë në këtë tregues.

3.2.1.4. Raportimi i kryetarit të komunës para Kuvendit Komunal

Ligji për vetëqeverisjen lokale, si ligj bazë në këtë fushë, ka përcaktuar një rregull sa i përket raportimit të kryetarit të komunës në Kuvendin Komunal, por edhe të drejtën e këtij të fundit për të thirrur kryetarin për raportim në Kuvend Komunal. Ligji në fjalë përcakton që kryetari i komunës raporton në Kuvend Komunal mbi situatën ekonomike-financiare, duke përfshirë edhe planet investuese, të paktën dy herë në vit, apo të paktën një herë në gjashtë muaj.³⁵ Në anën tjetër, me të njëjtin ligj është përcaktuar që kuvendet komunale mbajnë të paktën 10 seanca në vit, pesë prej të cilave mbahen në gjashtëmuorin e parë të vitit.³⁶ Duke pasur këtë parasysh dhe të drejtën (por edhe obligimin e kryetarit) që anëtarët e kuvendit të thërrasin për raportim në seancë kryetarin e komunës, ky tregues bazohet në numrin 10 sa u përket prezencës dhe raportimit të kryetarit të komunës në Kuvendin Komunal. Pikët që jepen në këtë tregues janë zero (0) pikë, një (1) dhe dy (2) pikë. Zero pikë jepen nëse rezultati në SMPK është më i vogël se 50%, një (1) pikë nëse rezultati në SMPK është nga 50% deri 90% dhe dy (2) pikë nëse rezultati është i barabartë apo më i madh se 90%. Në bazë të kësaj dhe pikëve që kanë marrë komunat në SMPK sa i përket performancës në këtë tregues, del që 23 komuna kanë marrë nga dy (2) pikë apo në mes të 90% dhe 100%, shtatë (7) komuna tjera kanë marrë nga një (1) pikë apo në mes të 50% dhe 90%, gjashtë komuna kanë marrë zero (0) pikë ngase rezultati i tyre është më i vogël se 50% derisa të dhëna nuk ka për dy komuna (Leposaviq dhe Zubin Potok).

Shtatë komunat që kanë marrë nga një (1) pikë për shkak se rezultati në SMPK për vitin 2018 ka qenë në mes të 50% dhe 90% kanë qenë: Gjilani, Kamenica dhe Vitia me nga 80%, Novobërda, Prishtina dhe Ranillugu me nga 60% dhe komuna e Shtimes me 50%. Gjashtë komunat tjera që kanë marrë zero (0) pikë ngase rezultati i tyre në SMPK ka qenë më i vogël se 50% kanë qenë: Ferizaji me 40%, Prizreni

35 Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Neni 58, pika J.

36 Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Neni 43, pika 2.

me 30%, Podujeva, Mamusha dhe Graçanica me nga 20% dhe Fushë-Kosova e fundit me 10%. Duke pasur parasysh këto rezultate, mesatarja e të gjitha komunave në këtë tregues për vitin 2018 ka qenë 75% që si numër është më i lartë se dy treguesit paraprakë, por më i ulët në krahasim me treguesin e parë të kësaj nën-fushe. Për të parë më qartë ndarjen e komunave sipas rezultateve që kanë marrë në SMPK, shih figurën në vazhdim.




Figura 10. Nr. i komunave me pjesëmarrje të kryetarit të komunës në mbledhje të KK

Raportimi i kryetarëve të komunave në Kuvend Komunal është një proces i rëndësishëm pasi që i mundëson kuvendit të monitorojë në mënyrë sistematike aktivitetet e ekzekutivit përmes prezencës së kryetarit. Gjithashtu, kjo e nxitë bashkëpunimin ndërmjet kryetarit të komunës dhe Kuvendit Komunal, prandaj konsiderohet jashtëzakonisht e rëndësishme prania e kryetarit të komunës në takimet e Kuvendit Komunal. Me fjalë të tjera, pjesëmarrja e kryetarit të komunës në takimet e kuvendit pasqyron përgjegjësinë e tij personale dhe të stafit të tij ndaj anëtarëve të kuvendit si dhe ndjeshmërinë ndaj përgjegjësisë në raport me përfaqësuesit e zgjedhur të qytetarëve. Të dhënat e vitit 2018 nuk mund të krahasohen me 2016 dhe 2017 për shkak se ky tregues është matur ndryshe në vitet përkatëse krahasuar me 2018.




Figura 11. Nr. i komunave me pjesëmarrje të kryetarit të komunës në mbledhje të KK për vitet paraprake

Megjithatë, ky tregues fokusohet vetëm në prezencën fizike të kryetarit, d.m.th nëse kryetari ka qenë prezent në seancë, dhe nuk ka të bëjë me cilësinë e debatit dhe sa është mbajtur llogaridhënës kryetari nga KK. Siç tregohet në pjesët e mëparshme, performanca komunale vuan nga një sistem i "llogaridhënies së dobët" ndërmjet ekzekutivit dhe degës legjislative të qeverisë lokale. Për këtë arsye kon-

siderohet i domosdoshëm fuqizimi i anëtarëve të Kuvendit Komunal për mënyrën e mbajtjes përgjegjës të ekzekutivit. Sipas studimit mbi funksionimin e qeverisjes lokale (pjesa e parë) kryer nga MPL-ja, ishte evidentuar mungesa e llogaridhënies së kryetarit në Kuvend Komunal, e trajtuar në kuadër të kontrolleve dhe balancave në mes të dy organeve komunale. Sipas këtij studimi “raportimi i kryetarit në Kuvend Komunal është shndërruar më shumë në informim nga kryetari mbi situatën ekonomike dhe financiare të komunës sesa në raportim në kuptimin e saktë të fjalës dhe zbatimin e pasojave në rast të mos performancës së mirë të shprehur përmes raportit. Llogaridhënia e kryetarit para Kuvendit Komunal vlerësohet të jetë edhe më e zbehtë në rastet kur kryetari e ka shumicën e anëtarëve nga partia që vjen në Kuvendin e Komunës, dhe kështu ky i fundit shndërrohet më shumë në një aprovues të propozimeve të kryetarit se sa në një kontrollues të ekzekutivit, në këtë rast kryetarit të komunës”.³⁷ Meqenëse ky tregues është mjaft teknik, vlerësohet se nuk ka nevojë për trajnim e as për adresim përmes ndonjë forme të komunikimit, përveç kësaj, performanca e komunave në këtë tregues është e kënaqshme.

3.2.2. Pjesëmarrja, konsultimi dhe gjithëpërfshirja e qytetarëve

Nga totali i 13 treguesve që ka fusha e qeverisjes demokratike, ashtu siç është paraqitur në fillim të kësaj pjese, nën-fusha e pjesëmarrjes, konsultimit dhe gjithëpërfshirjes së qytetarëve ka tre tregues dhe treguesi i tretë me ngjyrë trëndafili është i ngrirë. Në këtë aspekt, analiza dhe vlerësimi i performancës së komunave në këtë nën-fushë bëhen vetëm për dy tregues siç janë paraqitur më poshtë.

Tabela 3. Nën-fusha dy: pjesëmarrja, konsultimi dhe gjithëpërfshirja e qytetarëve

Nën-fusha 2: Pjesëmarrja, konsultimi dhe gjithëpërfshirja e qytetarëve	
6.	Pjesëmarrja e qytetarëve në konsultimet publike të ndara sipas gjinisë
7.	Aktet komunale dhe dokumentet e politikave lokale të konsultuara me publikun
8.	Seancat dëgjimore publike për KAB-në dhe buxhetin komunal (proporcionalisht ndaj numrit të banorëve)

Ligji për vetëqeverisje lokale është baza kryesore që krijon obligime për komunat edhe në fushën e pjesëmarrjes së qytetarëve, konsultimit dhe përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje në nivel lokal, e trajtuar në kuadër të demokracisë së drejtpërdrejtë dhe mekanizmave të pjesëmarrjes së qytetarëve.³⁸ Ligji përkatës specifikon obligimin e komunës që të mbajë takime publike së paku dy herë në vit në të cilat mund të marrë pjesë secili qytetar i interesuar dhe të shtrojnë pyetje për anëtarët e Kuvendit Komunal lidhur me çdo aktivitet të komunës. Përveç kësaj, komunat janë të obliguara t’i informojnë qytetarët edhe për çfarëdo plani dhe programi me interes publik të cilat po ashtu janë rregulluar edhe me statute të komunave dhe akte tjera nënligjore. Në kuadër të rritjes së pjesëmarrjes së qytetarëve dhe sigurimit të një procesi gjithëpërfshirës, MPL-ja ka hartuar dy udhëzime administrative, për transparencë në komuna³⁹ dhe për standardet minimale të konsultimit publik në komuna.⁴⁰

Edhe pse ky aspekt është i mbuluar mirë me legjislacion, është tjetër gjë nëse konsultimi dhe gjithëpërfshirja e qytetarëve është efektive në praktikë. Në bazë të studimit për funksionimin e qeverisjes lokale në Kosovë të kryer nga MPL-ja në vitin 2019, është vlerësuar se komunat duhet të bëjnë më shumë përpjekje për të përmirësuar pjesëmarrjen e qytetarëve në takime publike. Sipas të njëjtit raport, janë evidentuar disa mangësi në këtë proces, për shembull: komunat kanë kapacitete të pamjaftueshme në organizimin e takimeve publike, nuk përdorin mjete të ndryshme dhe efektive për të arritur një audiencë më të gjerë dhe po ashtu ka një interesim të ulët të qytetarëve për të marrë pjesë në këto takime

37 MPL, Studim mbi funksionimin e vetëqeverisjes lokale në Kosovë, f. 23.

38 Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen lokale, Kreu IX.

39 UA (MPL) nr. 04/2018 për Transparencë në komuna.

40 UA (MPL) nr. 06/2018 për Standardet minimale të konsultimit publik në komuna.

publike.⁴¹ Sipas raportit të MPL-së për funksionimin e komunave për vitin 2018, janë mbajtur 67 takime publike me qytetarë në 33 komuna. Kushti me më së paku dy takime gjithëpërfshirëse me qytetarë nuk është përmbushur në katër komuna si: Fushë-Kosovë (me vetëm një takim), si dhe Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë Veriore të cilat nuk kanë mbajtur asnjë takim.⁴² Në bazë të kërkesës ligjore, vetëm nga dy takime publike për komunë, del që 38 komunat do të duhej të kishin mbajtur 76 takime në total. Kjo tregon se disa komuna nuk kanë përmbushur as kërkesën ligjore për të mbajtur së paku dy takime publike në vit.

3.2.2.1. Pjesëmarrja e qytetarëve në konsultimet publike të ndara sipas gjinisë

Ky tregues paraqitet si një tregues në këtë raport mirëpo në SMPK është i ndarë në dy: niveli i pjesëmarrjes së qytetarëve në konsultime publike dhe niveli i pjesëmarrjes së grave në konsultime publike. Të dhënat për nivelin e pjesëmarrjes së qytetarëve në konsultime publike për vitin 2018, janë siguruar nga Formulari për pranimin e të dhënave për SMPK-në, të dhëna këto që dërgohen në MPL, por nuk janë të publikuara në raport. Kjo pasi që ky tregues është shtuar në SMPK gjatë rishikimit të vitit 2019. Ky tregues përveç që ndihmon në përmirësimin e demokracisë lokale përmes pjesëmarrjes së qytetarëve, kontribuon edhe në rritjen dhe përfshirjen e grave në takime/debate publike. Përfshirja e grave përmes takimeve publike është shumë e rëndësishme dhe jep sinjal se nevojat e të gjitha grupeve të interesit merren parasysh nga komuna përkatëse. Përfshirja e grave në këtë moment do të thotë mos përfshirja e interesave të grave në proceset vendimmarrëse në komunë.

Sipas rezultateve të GPK-së, mesatarja e të gjithë komunave në këtë tregues është 35% dhe komunat kanë nivele të ndryshme të performancës dhe renditjes. Sa u përket komunave individualisht, komuna e Junikut ka performancën më të mirë në këtë tregues, realisht me katër pikë (100%) në pjesën e parë dhe dy pikë (80%) në pjesën e dytë, që në mesatare i bie 90%. Kategoria e dytë nga 70% deri në 90% (me 2 pikë të vlerësuara) është vetëm një komunë, e që është komuna e Novobërdës me 71%. Në grupin e tretë me nga një pikë apo me përqindjen prej 40% deri 70% janë gjashtëmbëdhjetë (16) komuna. Në grupin e komunave të fundit me zero pikë (më pak se 40%) hyjnë 20 komuna. Sipas kësaj, kemi të bëjmë me një komunë me mesatare 90%, po ashtu një komunë me mbi 70%, 16 komuna me mbi 40% dhe 20 komuna me mesatare nën 40%. Rezultati apo grupimet e komunave sipas performancës së tyre në këtë tregues janë paraqitur në figurën në vazhdim.




Figura 12. Nr. i komunave dhe % e pjesëmarrjes së grave në takime publike

41 MPL, Studim mbi funksionimin e vetëqeverisjes lokale në Kosovë, f. 36.

42 MPL, Raporti për funksionimin e komunave për vitin 2018, f. 5.

Sa i përket pjesëmarrjes vetëm të grave në konsultime publike, mesatarja e komunave në këtë tregues është 30% derisa mesatarja e komunave në pjesëmarrjen në përgjithësi, pa e ndarë në gjini, është 41%. Vlen të përmendet se në takime publike ku më pak se 30% e pjesëmarrësve kanë qenë gra në vitin 2016 kanë qenë 12 komuna kurse në vitin 2017 kanë qenë 20 komuna. Gjithashtu, duhet të përmendet se krahasimi i vitit 2018 me vitet 2016 dhe 2017 nuk është i mundshëm për shkak se mënyra e matjes ka ndryshuar.




Figura 13. Nr. i komunave dhe % e pjesëmarrjes së grave në takime publike për vitet paraprake

Shkaqet e pjesëmarrjes së ulët të qytetarëve (sidomos grave) janë të shumta: mosbesimi i qytetarëve ndaj pushtetit lokal, mosinteresimi i qytetarëve për çështje publike, mosinformimi i drejtë dhe i saktë i komunës për takime publike dhe shkaqe të tjera.⁴³

Duke u bazuar në situatën aktuale COVID-19 rekomandohet që ky tregues të adresohet vetëm përmes kanaleve të komunikimit. Përveç kësaj, projekti ka mbajtur mjaft trajnime me zyrtarë komunalë për këtë tregues gjatë vitit të kaluar.

3.2.2.2. Aktet komunale dhe dokumentet e politikave lokale të konsultuara me publikun

Ky tregues synon të matë nivelin e përmbushjes së obligimit të Kuvendit Komunal për konsultim të publikut para miratimit të akteve që janë me interes për qytetarët. Mbi këtë fushë, MPL-ja ka nxjerrë, në vitin 2018, një udhëzues të ri sa i përket transparencës në komuna dhe neni 13 i kësaj rregulloreje përcakton obligimin e komunës në konsultim të publikut për aktet me interes për qytetarët⁴⁴ dhe po ashtu përcakton që mënyra e organizimit dhe e mbajtjes së këtyre konsultimeve bëhet sipas rregullores për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve komunale⁴⁵ dhe udhëzimit për standardet minimale për konsultime publike në nivel lokal.⁴⁶ Për të vlerësuar nivelin e përmbushjes së këtij obligimi nga komunat, treguesi kërkon numrin e akteve të përgjithshme për të cilat publiku është konsultuar gjatë vitit të vlerësuar. Të gjitha takimet e mbajtura me qytetarët në lidhje me aktet komunale konsiderohen si konsultime.

Sipas të dhënave nga SMPK-ja, mesatarja e këtij treguesi për të gjitha komunat është 62%. Megjithatë, komunat ndahen në katër grupe varësisht prej pikëve dhe rezultatit që kanë marrë në këtë tregues. Komunat marrin zero pikë nëse rezultati i tyre në SMPK është më i vogël se 40%, komunat marrin një pikë nëse rezultati i tyre është nga 40% deri 70%, komunat marrin dy pikë nëse rezultati i tyre është nga 70% deri 90% dhe komunat marrin katër pikë nëse rezultati i tyre në SMPK është i barabartë apo më i lartë se 90%. Sipas kësaj dhe të dhënave nga SMPK-ja për vitin 2018, 21 komuna kanë marrë katër

43 Sipas pjesëmarrësve nga trajnimet e mbajtura nga DEMOS gjatë vitit 2019 për pjesëmarrje të qytetarëve në debate publike.

44 UA (MPL) nr. 04/2018 për Transparencë në komuna, Neni 13.

45 Rregullore (MPL) nr. 01/2017 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës.

46 UA (MPL) nr. 06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në nivel lokal.

pikë apo 90% ose më shumë akte janë konsultuar me publikun, një komunë është në grupin me dy pikë apo 70-90%, një komunë me një pikë apo në grupin me rezultatin 40-70% dhe 13 komuna janë me pikë zero apo nën 40% dhe për dy komuna nuk ka të dhëna (Zubin Potok dhe Leposaviq). Këto të dhëna janë paraqitur në figurën në vijim.




Figura 14. Nr. i komunave që kanë (nuk) konsultuar publikun për aktet dhe politikat lokale

Sipas kësaj figure, 38 komunat ndahen pak a shumë në dy anë, ato që kanë marrë nga katër pikë (21 komuna) dhe ato që kanë marrë zero pikë (13 komuna). Në këtë mes, komuna që ka marrë dy pikë (70–90%) është Kamenica (80%) kurse komuna që ka marrë një pikë (40-70%) është Lipjani (46%). Komunat që kanë marrë zero pikë (nën 40%) janë Ferizaj, Graçanica, Klllokoti, Malisheva, Mamusha, Novobërda, Parteshi, Podujeva, Ranillugu, Shtërpca, Suhareka, Vitia dhe Zveçani. Trajnimi të mbahet edhe për komunat Leposaviç dhe Zubin Potok që nuk kanë raportuar të dhëna.

Sa i përket situatës së konsultimit të publikut me aktet dhe dokumentet e politikave lokale para se ato të miratohen për vitet 2016 dhe 2017, vlen të përmendet që pyetja e këtij treguesi është shtruar ndryshe në krahasim me 2018 dhe të dhënat që janë nxjerrë atëherë nuk shërbejnë për krahasim me të dhënat e trajtuara për 2018. Megjithatë, në vitet 2016 dhe 2017 kemi pasur afërsisht numër të njëjtën të komunave ku publiku është konsultuar për më shumë se 90% të akteve komunale (12 komuna në 2016 dhe 11 komuna në 2017), kemi pasur dy komuna në 2016 dhe tri komuna në 2017 ku publiku është konsultuar për 50% dhe 90% të akteve komunale dhe numri më i madh i komunave ka qenë ku publiku është konsultuar për më pak se 50% të akteve komunale, përkatësisht 20 komuna. Numri i komunave që nuk kanë dërguar të dhëna për këtë tregues në vitet 2016 dhe 2017 ka qenë i njëjtë, përkatësisht katër komuna në të dy vjetët. Figura në vazhdim paraqet ndarjen e komunave sipas përqindjes së akteve që janë konsultuar me publikun.




Figura 15. Nr. i komunave që kanë (nuk) konsultuar publikun për aktet dhe politikat lokale

Ndërkohë, MPL-ja ka theksuar problemet kryesore në mbajtjen e takimeve publike, si vijon:⁴⁷

1. mungesa e interesit publik për të marrë pjesë në takime publike (p.sh. jo shumë persona, përfshirë grupet e marginalizuara, kanë vullnetin që të marrin pjesë në takimet publike pasi që ata nuk mendojnë se mendimet, idetë e tyre merren seriozisht dhe konsiderohen si të rëndësishme), dhe
2. nuk ka informata kthyesë nga komunat për të informuar qytetarët lidhur me rezultatin përfundimtar (dhe lidhur me atë se në çfarë mase janë marrë parasysh pikëpamjet dhe komentet e tyre në procesin e vendimmarrjes).

Këto janë të gjitha gjetjet e diskutuara dhe të validuara gjatë hulumtimit në terren. Gjithashtu, këto paraqesin sfidë serioze, duke konsideruar faktin se komunat miratojnë me qindra akte komunale dhe nëse publiku do të ishte konsultuar në masë më të madhe për këto akte, atëherë do të rritej legjitimiteti në procesin e vendimmarrjes.

Në këtë fushë ka pasur trajnime të shumta nga donatorë të ndryshëm mirëpo situata nuk po ndryshon prandaj si përfundim rekomandohet që treguesi të adresohet vetëm përmes kanaleve të komunikimit.

3.2.3. Transparenca, qasja në informata dhe integriteti

Nga totali i 13 treguesve që ka fusha e qeverisjes demokratike, ashtu siç është paraqitur në fillim të kësaj pjese, nën-fusha e transparencës, qasjes në informata dhe integriteti ka pesë tregues të performancës (TP), derisa treguesi i parë i kësaj nën-fushe, treguesi i tretë dhe katërt me ngjyrë trëndafili janë të ngjirë. Në këtë aspekt, analiza dhe vlerësimi i performancës së komunave në këtë nën-fushë bëhen vetëm për dy tregues siç janë paraqitur më poshtë.

Tabela 4. Nën-fusha: transparenca, qasja në informata dhe integriteti

Nën-fusha 3: Transparenca, qasja në informata dhe integriteti	
9.	Takimet e Kuvendit Komunal të bëra publike dhe të transmetuara drejtpërdrejt
10.	Përditësimi i rregullt i ueb-faqes komunale sipas kërkesave (specifike) ligjore
11.	Publikimi i dokumenteve dhe kontratave të prokurimit publik
12.	Publikimi i procesverbaleve për proceset e konsultimeve publike
13.	Raportimi i planit vjetor të planit të integritetit të paraqitur para Kuvendit Komunal

Ashtu siç është thënë edhe në pjesët më lartë, legjislacioni sekondar sa i përket transparencës në komuna ka ndryshuar në fund të dhjetorit 2018 dhe mund të thuhet se që nga janari i vitit 2019 komunat kanë një bazë më të mirë ligjore për transparencë në komuna. Sipas këtij Udhëzimi Administrativ (UA), kërkohet që komunat brenda gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të tij, të plotësojnë dhe ndryshojnë rregulloret e tyre për transparencë në komuna. Udhëzimi përkatës obligon Kuvendin Komunal dhe kryetarin e komunës për zbatimin e këtij udhëzimi derisa MPL-ja është përgjegjëse të monitorojë zbatimin e tij. Përveç obligimit për komuna sa i përket ndryshimit të rregulloreve për transparencë në komuna, UA përkatës obligon komunat të hartojnë edhe plane katërvjeçare të veprimit për transparencë dhe pas miratimit nga KK këto plane të bëhen publike në ueb-faqet e komunave. Po ashtu, ueb-faqet e komunave duhet të zhvillohen dhe mirëmbahen sipas legjislacionit përkatës për ueb-faqet e institucioneve publike⁴⁸ dhe me rëndësi për këtë nën-fushë, trajtohet qasja e drejtpërdrejtë në informata dhe dokumente publike duke treguar së pari se cilat janë informatat/dokumentet për të cilat komuna duhet të ofrojë qasje përmes ueb-faqes zyrtare dhe pastaj shpjegon veçmas procedurën e kërkesës për qasje në dokumente publike.

⁴⁷ MPL. Raport për Funkcionimin e Komunave (2016). Mars 2017, fq.14.

⁴⁸ UA nr. 01/2015 për ueb-faqet e institucioneve publike.

Po ashtu, MPL-ja, përmes raportit të performancës për vitin 2018, vlerëson që ka një rritje të mesatares në fushën e transparencës në vitin 2018 krahasuar me 2017. Në vitin 2018 mesatarja e fushës së transparencës komunale ka qenë 76% kurse në vitin 2017 ka qenë 61%.⁴⁹ Megjithatë, sipas raportit të MPL-së mbi funksionimin e komunave për vitin 2018, zhvillimi dhe promovimi i transparencës mbeten një nga çështjet kyçe të qeverisjes demokratike.⁵⁰ Sa i përket qasjes në informata përmes kërkesave për qasje në dokumente publike, sipas të njëjtit raport, komunat kanë treguar trend pozitiv në mundësimin e qasjes në dokumente publike sipas kërkesave të parashtruara nga subjektet juridike, si dhe Ex Officio kur ligji këtë e kërkon. Numri i kërkesave të parashtruara është 964, prej tyre me qasje të lejuar janë 909 kërkesa (apo 94%), 37 janë të refuzuara (3%), 18 të lejuara pjesërisht (1%). Pesë komuna nuk kanë pasur asnjë kërkesë të parashtruar (Mamushë, Zveçan, Killokot, Zubin Potok dhe Mitrovica Veriore).⁵¹

Megjithatë, fushat ku do të mund të intervenohej me trajnime është rreth kërkesave të reja që dalin nga udhëzimi i vitit 2018 mbi transparencën në komuna, plotësimin e rregulloreve komunale për transparencë dhe hartimin e planeve katërvjeçare të transparencës të cilat kërkojnë me këtë udhëzim dhe hartimi i raporteve (meqenëse kryetari dhe KK janë zbatues të këtij udhëzimi) mbi zbatimin e kërkesave që dalin nga udhëzimi përkatës.

3.2.3.1. Përditësimi i rregullt i ueb-faqes komunale sipas kërkesave (specifike) ligjore

Ky tregues synon të matë nivelin e performancës së komunave sa i përket respektimit të obligimeve ligjore të komunës për formën dhe përmbajtjen e faqes zyrtare elektronike, duke përfshirë popullimin me informatat e nevojshme të përcaktuara me legjislacionin përkatës mbi ueb-faqet e institucioneve publike dhe transparencës në komuna. Sa i përket përditësimit me të dhëna të ueb-faqes komunale, mesatarja e të gjitha komunave është mjaft e lartë sipas SMPK-së, pra arrin në 81%. Megjithatë, kur analizojmë performancën e komunave një nga një, shohim se disa komuna kanë pasur performancë më të dobët në këtë tregues dhe kanë ndikuar që mesatarja mos të jetë edhe më e lartë.

Kalkulimi i rezultatit në këtë tregues bëhet në atë mënyrë që komuna merr zero pikë nëse rezultati i saj në SMPK mbi këtë tregues është nën 40%, komuna merr një pikë nëse rezultati është në mes të 40 dhe 60%, komuna merr dy pikë nëse rezultati në SMPK është në mes të 60 dhe 90% dhe komuna merr katër pikë (maksimumi) nëse rezultati i saj në SMPK për këtë tregues është i barabartë apo më i lartë se 90%. Në bazë të kësaj, 26 komuna kanë marrë nga katër pikë, mirëpo në këtë numër vlen të ceket që shumica e komunave janë me 100% dhe një numër i vogël janë me 90 ose 95%. Shtatë komuna tjera kanë marrë nga dy pikë, asnjë komunë nuk është në kategorinë e 40 deri 60%, derisa tri komuna (Mamusha, Ranillugu dhe Zveçani) kanë marrë nga zero pikë. Nga 38 komuna, të dhëna në këtë tregues nuk ka për komunën e Zubin Potokut dhe Leposaviqit. Të dhënat përkatëse dhe ndarja e komunave sipas tyre është paraqitur në figurën në vazhdim.

Disa nga shkaqet se pse komunat nuk përditësojnë rregullisht ueb-faqet komunale janë: mungesa e funksionimit të rregullt të rrjetit të internetit në komunë; mos dërgimi i dokumenteve te personat përgjegjës nga personat e autorizuar; mungesa e pajisjeve të teknologjisë informative nga zyrtarët komunalë; moskoordinimi i mirë në mes të ministrive dhe komunave etj.⁵²

49 MPL, Raporti i performancës së komunave për vitin 2018, f. 13.

50 MPL, Raporti i performancës së komunave për vitin 2018, f. 13

51 MPL, Raporti për funksionimin e komunave për vitin 2018, 14.

52 Nga takimet e rregullta dhe bisedat joformale të zyrtarëve të projektit DEMOS me zyrtarë komunalë




Figura 16. Nr. i komunave që kanë (nuk) përditësuar uebfaqet sipas kërkesave ligjore

Nëse krahasojmë këtë tregues me treguesit e tjerë si të kësaj nën-fushe ashtu edhe të nën-fushave tjera të fushës së qeverisjes demokratike lokale, ky tregues ka arritjen më të lartë. Në këtë mënyrë, mund të përfundohet se ky është një nga tre treguesit më të mirë në skemën e grantit të performancës apo treguesi i tretë më i mirë nga të gjithë treguesit e fushave të SMPK-së. Pasi që ky tregues nuk është matur dhe vlerësuar për vitet paraprake, rezultatet e tij në 2018 nuk mund të krahasohen me vitet paraprake.

3.2.3.2. Raportimi i planit vjetor të planit të integritetit të paraqitur para Kuvendit Komunal

Komunat duhet të hartojnë plane të integritetit dhe zbatimin e tyre vlerësohet i rëndësishëm në parandalimin e praktikave korruptive në komunë dhe është tregues i qeverisjes së mirë dhe demokracisë në nivel lokal. Ky tregues synon të matë nëse komunat deri në fund të vitit paraqesin në Kuvend Komunal për diskutim raportin vjetor mbi zbatimin e planit të integritetit në komunë si një prej instrumenteve parandaluese të korrupsionit në kuadër të komunës. Në bazë të të dhënave nga SMPK-ja, mesatarja e komunave në këtë tregues është 50%. Kalkulimi i rezultatit të këtij treguesi bëhet në atë mënyrë që komunat marrin zero pikë nëse rezultati i tyre në SMPK është më i vogël se 100% dhe marrin dy pikë nëse rezultati i tyre është 100%. Në bazë të kësaj, plani i integritetit dhe zbatimin e tij është diskutuar në Kuvend Komunal në 18 komuna, NUK është diskutuar në 16 komuna derisa nuk ka të dhëna për katër komuna (Leposaviq, Zubin Potok, Viti dhe Lipjan). Numri i komunave që kanë diskutuar zbatimin e planit të integritetit është dukshëm më i lartë në 2018 se sa në 2016 dhe 2017 dhe si rrjedhojë numër më i vogël i komunave që nuk kanë diskutuar mbi zbatimin e planit të integritetit në komunë. Të dhënat për vitin 2018 dhe krahasimi në mes 2016 dhe 2017 është paraqitur në figurën në vazhdim.




Figura 17. Nr. i komunave që kanë (nuk) diskutuar planin e integritetit në KK

Në pjesët në vijim, analiza e të dhënave të GPK-së shqyrtohet nga perspektiva e burimeve sekondare dhe hulumtimeve në terren. Në bazë të sistemit të kriterëve, të dizajnuar për përcaktimin e prioriteteve për trajnim, disa nga problemet mund të trajtohen nëpërmjet trajnimit, ndërsa disa probleme ndërliken me mbështetjen politike dhe intervenimeve në politika. Për problemet me komunat që nuk raportojnë mbi zbatimin e planeve të integritetit mund të nevojiten ndryshime në legjislacion duke e bërë atë si kërkesë ligjore.

Siç raportohet nga burimet sekondare, planet e integritetit për komuna janë hartuar me mbështetjen e projektit të UNDP/SAEK, si dhe nga projekti TEAM (USAID) për pesë komunat partnere të projektit e që janë: Vushtrri, Pejë, Prishtinë, Gjakovë dhe Gjilan. Megjithatë, problem mbetet kuptimi nga përfaqësuesit komunalë se çka është përmbajtja e këtyre planeve. MPL-ja është duke punuar në hartimin e një modeli të planit të integritetit, me qëllim që komunat në procesin e hartimit të këtyre planeve t'i përmbahen atij modeli dhe të unifikohet përmbajtja e tyre. Planifikimi i integritetit është një risi dhe do të duhet kohë që të gjitha komunat të miratojnë dhe raportojnë për një sistem të tillë. Edhe pse disa trajnime janë mbajtur në vitin 2019, meqenëse kjo është një fushë e re dhe jo të gjitha komunat e kanë kuptuar njëjtë rëndësinë e zbatimit të planit të integritetit, rekomandohet që projekti të vazhdojë të përkrahë komunat përmes kanaleve të komunikimit në këtë fushë. Për të mos dyfishuar përpjekjet për përmirësime të performancës së komunave në këtë fushë, duhet koordinuar me donatorët potencialë në këtë aspekt dhe të ndahen temat.

3.3. Menaxhimi komunal

Granti i Performancës Komunale (GPK) përcakton menaxhimin komunal si fusha e dytë e performancës komunale pas qeverisjes demokratike lokale trajtuar më parë. Kjo fushë ka tri nën-fusha të cilat në total kanë tetë (8) tregues me 21 pikë maksimale. Nën-fusha e parë ka tre tregues, nën-fusha e dytë ka dy dhe nën-fusha e tretë ka tre tregues. Megjithatë, nën-fusha e dytë dhe e tretë kanë nga një tregues të ngrirë dhe analiza e vlerësimit bëhen për gjashtë tregues. Treguesit e ngrirë paraqiten me ngjyrë trëndafil në tabelën në vazhdim për të bërë të qartë se cilët janë dhe nuk janë pjesë e analizës dhe vlerësimit të komunave për këtë fushë.

Tabela 5. Fusha e menaxhimit komunal, nën-fushat dhe treguesit

Fusha: Menaxhimi komunal	
Nën-fusha 1: Menaxhimi financiar	
14.	Regjistri i tatimit në pronë i përditësuar çdo vit sipas kërkesave ligjore
15.	Niveli i mbledhjes së tatimit në pronë (pa borxhe, kamata, gjoba)
16.	Adresimi i rekomandimeve të auditimit (ZKA)
Nën-fusha 2: Menaxhimi i kontratës	
17.	Zbatimi i planit të prokurimit
18.	Hartimi dhe publikimi i listës së pronave komunale që planifikohen të jepen në shfrytëzim dhe të shkëmbehen
Nën-fusha 3: Menaxhimi i burimeve njerëzore	
19.	Vende të hapura pune të proceduara përmes SIMBNj-së
20.	Gratë në pozita udhëheqëse në institucionet e arsimit, shëndetësisë, kulturës
21.	Gratë e emëruara në pozita politike në komunë

Fusha e menaxhimit komunal në bazë të vlerësimit të performancës së gjashtë nga tetë treguesit e tri nën-fushave ka arritur një mesatare prej 53%.

Sa u përket treguesve në nën-fushën e menaxhimit financiar, përditësimi i regjistrit të tatimit në pronë ka treguar mesataren prej 26% që nuk mund të thuhet e mirë, por në krahasim me 2017 (ku ka qenë

12%), mund të thuhet se ka progres. Sa i përket nivelit të mbledhjes së tatimit në pronë, mesatarja në vitin 2018 është 40% që prapë nuk mund të thuhet se ka mesatare të mirë por krahasuar me 2016-2017 (ku ka qenë rreth 35%), prapë mund të thuhet se ka progres edhe në këtë tregues. Sa i përket treguesit të tretë të kësaj nën-fushe apo adresimi i rekomandimeve të ZKA-së, mesatarja në vitin 2018 është 30% që nuk është mesatare e mirë, pavarësisht se shënohet një rritje në krahasim me vitet 2016-2017 (ku ka qenë 24%). Pra, sa i përket performancës së komunave në këtë nën-fushë sipas tre treguesve krahasuar me 2016-2017 ka progres (të elaboruara në vazhdim sipas treguesve), por gjykuar vetëm si mesatare prej 32% për vitin 2018 nuk mund të thuhet që ka performancë të mirë të komunave.

Sa i përket nën-fushës-menaxhimi i kontratave, vetëm një nga dy treguesit është vlerësuar për vitin 2018, andaj mesatarja në këtë tregues në vitin 2018 ka qenë 84% dhe mund të thuhet se është më e mirë se sa mesatarja në vitin 2017 e cila ka qenë 74%.

Në nën-fushën-menaxhimi i burimeve njerëzore me tre tregues, mesatarja për vitin 2018 ka qenë 42%. Sa i përket treguesit mbi vendet e hapura përmes Sistemit informativ për menaxhimin e burimeve njerëzore (SIMBNJ) ka arritur mesataren prej 64% që krahasuar me 2016 dhe 2017 ka progres sepse në vitin 2016 performanca kishte qenë 62%, kurse në vitin 2017 kishte qenë 61%. Progresi në këtë tregues për vitin 2018, sipas raportit mbi gjendjen për shërbimin civil për këtë vit, shpjegohet me faktin që Ministria e Administratës Publike (MAP), përkatësisht Departamenti për Administrimin e Shërbimit Civil (DASHC) ka ofruar ndihmë ndaj institucioneve të ndryshme në realizimin e procedurave përmes SIMBNJ-së dhe kjo ndihmë është ofruar përmes takimeve dhe sqarimeve dhënë përmes postës elektronike. Po ashtu, sipas të njëjtit burim, në vitin 2018 është arritur që numri i nëpunësve civilë me qasje në SIMBNJ të rritet për 840 derisa ka pasur përmirësime në 740 qasje të tjera. Treguesi 21 apo gratë e emëruara në pozita politike në komunë ka arritur mesataren prej 20%, që nuk është performancë e mirë.

Në seksionet vijuese, analiza e të dhënave të GPK-së shqyrtohet në mënyrë më të hollësishme nga perspektiva e burimeve dytësore, trajnimeve të projektit DEMOS, si dhe hulumtimeve të tjera në terren. Disa nga problemet mund të trajtohen nëpërmjet trajnimeve, ndërsa disa probleme varen nga mbështetja politike dhe ndryshimet e politikave. Edhe pse kemi rritje sistematike të performancës, ende ka probleme me mos adresimin e rekomandimeve të auditimit nga ana e komunave, gjë që kërkojnë ngritje të kapaciteteve. Megjithatë, duke marrë parasysh kompleksitetin e çështjeve, kjo mund të kërkojë edhe ndërgjegjësim politik. Duke pasur parasysh se regjistrimi i tatimit në pronë është përmirësuar dukshëm, në mënyrë që ky tregues të vazhdojë me performancë më të mirë edhe në vitet vijuese, është e nevojshme që stafi komunal të fitojë aftësitë adekuate.

Me qëllim që të kuptohet më për së afërmi performanca komunale në fushën e “menaxhimit komunal”, është përdorur sistemi i semaforëve për të identifikuar nevojat prioritare ku ndërhyrjet janë thelbësore dhe për të ndihmuar komunat në ndërtimin e kapaciteteve. Rëndësia tregohet përmes ngjyrës në bazë të numrit të komunave të cilat kanë treguar performancë të dobët, mesatare apo të mirë.




Figura 18. Sistemi i “semaforit” për treguesit e menaxhimit komunal

3.3.1. Menaxhimi financiar

Nën-fusha e menaxhimit financiar paraqet të dhënat e mbledhura dhe analizat lidhur me menaxhimin e financave komunale e të përkthyer në tre tregues specifikë: *i) regjistri i tatimit në pronë i përditësuar çdo vit, sipas kërkesave ligjore (treguesi 14); ii) niveli i mbledhjes së tatimit në pronë (pa borxhe, kamata, gjoba) (treguesi 15); dhe iii) niveli i adresimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit (treguesi 16).*

3.3.1.1. Regjistri i tatimit në pronë i përditësuar çdo vit sipas kërkesave ligjore

Duke iu referuar analizës së të dhënave, për treguesin “Regjistri i tatimit në pronë i përditësuar çdo vit, sipas kërkesave ligjore”, shumica e komunave kanë zbatuar kërkesën ligjore. Kalkulimi i këtij treguesi bëhet në mënyrën që komunat të cilat kanë rivlerësuar regjistrimin e tatimit në pronë marrin zero pikë nëse rezultati i tyre në SMPK është jo më i madh se 10%, komunat marrin dy pikë nëse rezultati i tyre në SMPK është në mes të 10 dhe 30% dhe komunat marrin tre pikë nëse rezultati i tyre në SMPK është i barabartë apo më i lartë se 30%. Në këtë mënyrë, në vitin 2018, dhjetë komuna kanë rivlerësuar deri në 10% të pronave, gjashtë komuna ndërmjet 10-20% dhe 22 komuna kanë ri-vlerësuar mbi 20%. Mesatarja e të gjitha komunave për vitin 2018 është 26%, ndërsa për vitin 2017 është 12%. Ky tregues dëshmon se ka rritje në krahasim me vitin e kaluar, por mesatarja është shumë e ulët. Ky tregues ka qenë i ngjirë në vitin 2016 prandaj nuk është vlerësuar dhe nuk mund të krahasohet me vitet 2017 dhe 2018. Megjithatë, edhe pse në mungesë të kapaciteteve, shprehur në mungesë të burimeve njerëzore, përditësimi i regjistrimit të tatimit në pronë është përmirësuar dhe krahasimi në fjalë është paraqitur në figurën më poshtë.




Figura 19. Nr. i komunave që kanë (nuk) përditësuar regjistrin e tatimit të pronave

Mungesa e kapaciteteve njerëzore si në aspektin e numrit të stafit ashtu edhe në aspektin e shkathhtësive të kërkuara për vlerësim mund të jetë një nga arsytet se pse komunat dështojnë në përpjekjet e tyre për mbledhjen e tatimit në pronë me qëllim të investimit në investime kapitale. Sipas analizës së ZKA-së mbi treguesit e performancës për nivelin lokal qeverisës për vitin 2018, rekomandohet që komunat, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, të shqyrtojnë mundësitë për ri-sistemim të burimeve njerëzore të departamentet komunale të tatimit në pronë në mënyrë që të arrihen efektet maksimale nga kjo e hyrë. Megjithatë, ligji i ri ka ulur kërkesën për të inspektuar objektet çdo vit nga 33% në 20%. Përderisa kjo përqindje është vetëm një kërkesë minimale e caktuar për komunat, të dhënat e GPK-së tregojnë se disa komuna kanë tejkaluar përqindjen minimale siç janë Komuna e Hanit të Elezit dhe ajo e Kaçanikut në vitin 2018 dhe kanë inspektuar 100% të objekteve. Sa u përket komunave që kanë performancën

më të ulët (0%) janë Deçani, Parteshi, Mitrovica e Veriut, Vitia, Zveçani dhe Zubin Potoku. Tatimi në pronë llogaritet si përqindje e vlerës së vlerësuar të pronës. Kur vlera e pronës është e lartë, tatimi në pronë është më i lartë dhe anasjelltas. Përditësimi i regjistrimit të tatimit në pronë nëpërmjet ri vlerësimit vjetor shpie në informata më të mira mbi vlerat aktuale të pronave, duke çuar kështu në përmirësimin e mbledhjes së tatimit në pronë.

Përveç mungesës së stafit nga komunat në përditësimin vjetor të regjistrimit të tatimit në pronë, sipas raportit përfundimtar të trajnimit të mbajtur nga projekti DEMOS në 2019 në lidhje me regjistrin e pronave komunale dhe mbledhjen e tatimit në pronë, në mënyrë që performanca të jetë më e kënaqshme, konsiderohet që stafi teknik në komunë të ketë mbështetje të vazhdueshme nga stafi politik (drejtorët përkatës dhe kryetari). Sa i përket nevojës për trajnime në këtë fushë, në vitin 2019 janë mbajtur mjaft trajnime, prandaj duhet konsideruar adresimin e kësaj teme përmes kanaleve të komunikimit.

3.3.1.2. Niveli i mbledhjes së tatimit në pronë (pa borxhe, kamata, gjoba)

Ky tregues ka për qëllim të matë performancën e komunave në mbledhjen e tatimit në pronë krahasuar me tatimin e faturuar për vitin përkatës, pa llogaritur të hyrat nga gjocat, borxhet dhe kamatat në këtë aspekt. Pra, nuk është me rëndësi shuma totale e mbledhur, por sa nga tatimi i faturuar është mbledhur në vitin përkatës. Performanca e komunave në këtë tregues llogaritet sipas katër niveleve - komunat marrin zero pikë nëse kanë mbledhur deri në 40% të tatimit të faturuar, marrin një pikë nëse mbledhin në mes të 40 dhe 60% të tatimit të faturuar, marrin tre pikë nëse komunat kanë mbledhur në mes të 60 dhe 84% të tatimit të faturuar dhe marrin pesë pikë nëse kanë mbledhur 85% apo më shumë të tatimit të faturuar për vitin 2018. Në bazë të përqindjeve që kanë arritur komunat në këtë tregues, mesatarja e të gjitha komunave është 40% e cila ka shënuar progres në krahasim me mesataren për vitin 2017 e cila ka qenë 35%, por ende është shumë e ulët.

Sipas analizës së të dhënave për vitin 2018, asnjë komunë nuk ka mbledhur 85% apo më shumë të tatimit në krahasim me tatimin e faturuar, një komunë (Obiliqi) ka mbledhur 70% dhe 24 komuna kanë mbledhur në mes të 40 – 59% të tatimit të faturuar. Nëntë komuna kanë mbledhur më pak se 40% të tatimit në pronë, kurse katër komuna nuk kanë raportuar të dhëna për këtë tregues. Mirëpo, nëse merren për bazë vetëm 34 komunat që mbledhin tatimin në pronë (duke përjashtuar katër komunat veriore) del se mesatarja e vlerësuar është 45%. Ky tregues ka qenë i ngrirë në vitin 2016 dhe nuk është bërë vlerësimi për të, prandaj nuk mund të bëhet ndonjë krahasim. Ndarja e komunave sipas rezultateve në mbledhjen e tatimit në pronë krahasuar me atë të faturuar dhe krahasimi me vitin 2017 është paraqitur në figurën në vazhdim.




Figura 20. Nr. i komunave që kanë (nuk) mbledhur tatimin në pronë pa borxhe, kamata dhe gjoba

Fatura e tatimit në pronë nga 2019 e tutje përfshin edhe tatimin në parcela (prona pyjore, rezidenciale, komerciale dhe industriale). Mirëpo, përfshirja e tatimit në tokë për parcelat bujqësore është shtyrë **për shkak të pritjes në përfundimin e procesit të identifikimit të parcelave të kultivuara të cilat do të lirohen nga tatimi**. Në mënyrë që të evitohen rritje të larta të tatimit, tatimi në tokë do të fillojë të zbatohet **gradualisht**, i cili bëhet përmes zbritjes së përgjithshme **gjatë përcaktimit të vlerës së tatueshme**. **Sipas analizës së të dhënave të** GPK-së, ekziston një lidhje direkte pozitive ndërmjet shkallës së mbledhjes së tatimit në pronë (treguesi 15) dhe realizimit të buxhetit për shpenzime kapitale.

Gjatë diskutimeve/trajnimeve me stafin komunal, dhe sipas raportit përmbledhës/final të trajnimit të projektit DEMOS, i mbajtur në vitin 2019, janë shpalosur disa shkaqe se pse komunat nuk arrijnë ta mbledhin tatimin në pronë në një shkallë më të lartë. Në mesin e shumë shkaqeve është planifikimi, ngase komunat nuk arrijnë t'i planifikojnë në mënyrë të duhur të hyrat e tyre vetanake, në veçanti të hyrat nga tatimi në pronë. Praktikrat aktuale na tregojnë që komunat kanë qasje shumë konservative në planifikimin e të hyrave të tyre vetanake. Gjithashtu, si shkak shtesë për mos ngritjen e shkallës së tatimit në pronë është mungesa e shtytjes apo nxitjes nga ana e stafit menaxherial në komuna të zyrtarët përgjegjës komunalë.

Vlerësohet e domosdoshme nisja e procesit të komunikimit me publikun për të shtuar gatishmërinë e qytetarëve për të paguar tatimin në pronë.

Sipas raportit/përmbledhjes së taksës së pronës dhe financat lokale në Kosovë, si prioritet është që komunat duhet të ndërmarrin hapat si në vijim: a) përmirësimi i hartave kadastrale me anë të të cilave do të ishte më e lehtë të identifikohen rrugët dhe pronat, b) përmirësimi i softuerit për taksën e pasurive dhe vënja në bazën e të dhënave të pronave me karakter specifik, sepse vlerësimi i tyre është shumë i ndërlikuar, c) të përcaktohet qartë llogaritja e amortizimit të pasurisë, cilësia dhe jetëgjatësia e objekteve, e) të rritet ndërgjegjësimi i qytetarëve për pagimin e taksave përmes trajnimit të vazhdueshëm të zyrtarëve komunalë për funksionimin e tatimit në pronë, veçanërisht në çështjet që lidhen me pronën dhe aksimin e tyre, si dhe f) sigurimin e asistencës teknike për zyrtarët e tatimit në pronë në të gjitha komunat". Në janar të vitit 2018, Kuvendi i Kosovës miratoi ligjin e ri mbi tatimin në pronë e paluajtshme i cili, ndryshe nga ligji i mëparshëm, toka do të tatóhet. Meqenëse zbatimi i ligjit të ri ka filluar nga viti 2019 e tutje, kurse vlerësimi i komunave në këtë raport është për vitin 2018, vlerësimi i këtij treguesi është i bazuar në ligjin e vjetër për tatimin në pronë e paluajtshme. Në të ardhmen, përbushja e kërkesave të ligjit të ri për tatimin e tokës mund të kërkojë që komunat të rrisin kapacitetet e tyre njerëzore në këtë drejtim, si dhe mbledhja e tatimit në pronë të rritet. Duke vepruar kështu, stafi komunal në njësitë e tatimit në pronë duhet të pajiset me aftësitë adekuate për të përbushur sfidat ekzistuese dhe të ardhshme që dalin nga tatimi i vendosur mbi tokën. Gjithashtu, sipas ligjit të ri, tatimi bazohet në vlerën e vlerësuar të parcelave. Vlera e vlerësuar e parcelave reflekton vlerën e tregut ku përcaktohet përmes vlerësimit zyrtar gjithë shtetëror. Normat tatimore përcaktohen nga KK. Si përfundim, rekomandohet që kjo temë të adresohet përmes komunikimit sidomos në fushën e inkasimit, mirëpo duhet paraprakisht të shihet se çka kanë bërë organizatat tjera që të mos dyfishohen aktivitetet.

3.3.1.3. Adresimi i rekomandimeve të auditimit (sipas ZKA-së)

Ky tregues mat nivelin e adresimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA) nga komunat. Ky tregues u referohet rekomandimeve të nivelit të lartë dhe të mesëm që rrjedhin nga raportet e auditimit të ZKA-së. Sipas ligjit, ZKA-ja është përgjegjëse për dhënien e rekomandimeve për t'i ndihmuar institucionet publike, siç janë komunat, në zbatimin e menaxhimit të mirë financiar, përveç promovimit të standardeve për qeverisje të mirë (transparencë, llogaridhënie, menaxhim dhe performancë).⁵³ Sipas analizës së të dhënave, komunat, në krahasim me treguesit

“Mesatarja e vlerësuar për këtë tregues është përmirësuar nga 24% në vitin 2016 në 31% në vitin 2018”.

53 Ligji nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit, Neni 6.

tjerë të performancës, dështojnë më së shumti në adresimin e rekomandimeve të dhëna nga ZKA-ja. Sipas ligjit, komunat kërkohet që brenda 30 ditëve nga pranimi i raportit të auditimit, të dërgojnë një përgjigje në ZKA ku tregohet se si institucioni do t'i adresojë rekomandimet e dhëna përmes raportit.⁵⁴ Viti 2018 ka të bëjë me adresimin e rekomandimeve që janë dhënë përmes raportit për vitin 2017.

Sipas raportit të ZKA-së,⁵⁵ komunat marrin zero pikë nëse rezultati i adresimit të rekomandimeve është më i vogël se 30%, një pikë nëse rezultati është në mes të 30 dhe 50%, dy pikë nëse rezultati në këtë tregues është në mes të 50 dhe 85% dhe komunat marrin pesë pikë nëse rezultati i tyre në SMPK mbi këtë tregues është i barabartë apo më i lartë se 85%. Në bazë të këtij kategorizimi dhe rezultateve të 38 komunave në SMPK, asnjë komunë nuk ka marrë maksimumin apo nuk është në përqindjen 85% apo më shumë. Vetëm tri komuna (Obiliqi – 65%, Peja – 57% dhe Laposaviqi – 66%) janë në kategorinë prej 50 deri 85.% të adresimit të rekomandimeve të ZKA-së. Në kategorinë e tretë janë 18 komuna të cilat rezultatin e kanë në mes 30 dhe 50%, ku pesë komuna janë mbi 40% (Kaçaniku, Lipjani, Shtimja, Suhareka dhe Vushtrria) derisa 12 tjera janë vetëm mbi 30%. 17 komuna tjera nuk kanë arritur as rezultatin me nga një pikë dhe janë renditur në kategorinë me rezultatin më të vogël në këtë tregues. Mesatarja e komunave për vitin 2018 në këtë tregues është 30%.

Mesatarja e rezultatit të të gjitha komunave në këtë tregues është e vogël, por mund thuhet se ka pak progres nëse krahasohet me dy vitet paraprake, kur në vitin 2016 ka qenë 24.47% kurse në vitin 2017 ka qenë 24.69%. Sa i përket trendit, mund të thuhet se është në rritje pozitive, edhe pse shumë të lehtë, në krahasim me kategoritë dhe pritjet mbi adresimin e rekomandimeve të auditorit. Sa i përket ndarjes së komunave sipas grupeve/kategorive si më lartë, të tri kategoritë kanë progres: derisa nga një komunë ka qenë në kategorinë në mes të 50 dhe 85%, në vitin 2018 në këtë kategori ishin tri komuna, derisa 10 dhe 14 komuna në vitin 2016 dhe 2017 kanë qenë në kategorinë në mes të 30 dhe 50% të rezultatit, në vitin 2018 kanë qenë 18 komuna në këtë kategori dhe derisa 27 dhe 23 komuna kanë qenë në vitin 2016 dhe 2017 në kategorinë deri në 30 (apo zero pikë), në vitin 2018 në këtë kategori kanë qenë 17 komuna. Në anën tjetër, sa u përket komunave në kategorinë më të lartë apo atë me 85% apo më shumë të rezultatit, në këtë kategori nuk është listuar asnjë komunë në vitet 2016, 2017 dhe 2018. Ndarja e komunave sipas kategorive të cekura më lartë por edhe krahasimi i tyre me 2016 dhe 2017 është dhënë në figurën në vazhdim.




Figura 21. Nr. i komunave që kanë (nuk) adresuar rekomandimet e ZKA-së

Sa u përket rekomandimeve të pa adresuara, vlen të theksohet se, pak a shumë, komunat vazhdimisht nuk arrijnë t'i adresojnë çështjet e njëjta si: raportimi i gabueshëm i shpenzimeve në pasqyrat vjetore financiare për shkak të keq klasifikimit (përfshirë edhe pagesat direkte nga Thesari) dhe shpalosja jo e mjaftueshme e informatave; dobësitë në fushat e qeverisjes që ndërlidhen me vetëvlerësimin dhe

54 Ligji nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit, Neni 23.

55 ZKA, Analizë e treguesve të performancës për nivelin lokal qeverisës për vitin 2018, f. 26.

menaxhimin e rrezikut; dobësi në procedurat e prokurimit; dobësitë në menaxhimin e të hyrave dhe shpenzimeve; mungesë të shërbimeve të auditimit të brendshëm për institucionet e vogla të pavarura dhe menaxhimin joefikas të burimeve në komunë.⁵⁶

Megjithatë, janë inkurajuese disa iniciativa që kanë për qëllim t'i ndihmojnë komunat në adresimin e rekomandimeve të auditimit. Një rast janë seritë e fundit të diskutimeve të ndërmjetësuara nga Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese (BIRN) nëpër kuvendet komunale në Kosovë sa i përket nivelit të adresimit të rekomandimeve të auditimit. Përveç këshilltarëve komunalë, stafit komunal dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile, në disa seanca kanë marrë pjesë edhe Auditori i Përgjithshëm, Ndihmës Auditori i Përgjithshëm dhe Udhëheqësi i Departamentit të Auditimit. Për shembull, në disa seanca të Komunës së Malishevës, të mbajtura në muajin nëntor të vitit 2019, Udhëheqësi i Departamentit të Auditimit ka theksuar se këto diskutime kanë për qëllim forcimin e menaxhimit të financave publike dhe rritjen e kontrolleve të brendshme në komunë. Gjithashtu, zbatimin e plotë të këtyre rekomandimeve do të ndikojë në një performancë më të mirë të komunave, por edhe në shërbime më të mira ndaj qytetarëve.⁵⁷

Adresimi i rekomandimeve të auditimit ka qenë temë e diskutimit edhe në iniciativë të tjera. Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) ka mbajtur takim me Këshillin e Kryetarëve në nëntor 2019 mbi mënyrën e adresimit të rekomandimeve dhënë nga ZKA-ja. Përfaqësuesit e ZKA-se, si sfida kryesore për komunat vlerësojnë: menaxhimin e parasë publike, shfrytëzimin e buxhetit, dhënia për shfrytëzim të tokës komonale pa procedurë joadekuate, realizimin e pagesave pa praninë të mallrave apo punëve të kryera dhe mos pasqyrimi i obligimeve të komunave në pasqyrat financiare. Projekti TEAM i USAID-it po mbështet komunat me trajnime në disa nga këto tema dhe DEMOS ka koordinuar ndërhyrjen e saj për të shmanhur dyfishimet. Në përgjithësi, në nivel të auditimeve individuale nga raporti vjetor i ZKA-se shumica e organizatave buxhetore nuk zbatojnë procesin sistematik për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve. Ndonëse, krahasuar me vitin 2016, numri i rekomandimeve ka shënuar rënie, megjithatë, një numër i vogël i rekomandimeve janë zbatuar plotësisht, ndërsa pjesa më e madhe e tyre janë në proces të zbatimit ose të pa zbatuara, përfshirë këtu edhe rekomandimet nga vitet e mëhershme. Ngecjet në zbatimin e plotë të rekomandimeve ndikojnë në përsëritjen e dobësive dhe mangësive të kontrollit dhe përsëritjen sistematike të parregullsive nga viti në vit.⁵⁸

Nga të gjeturat nga raporti i trajnimit⁵⁹ mbi zbatimin e rekomandimeve të auditorit vlerësohet se në mënyrë që niveli i implementimit të rekomandimeve të auditorit të jetë sa më i mirë, duhet të ketë mbështetje nga kryetarët dhe drejtoritë përkatëse komunale. Po ashtu, menaxhmenti i komunës duhet të njoftohet më mirë në lidhje me funksionimin dhe rolin e përmirësimit të menaxhimit financiar dhe performancës komunale.

Në kontekstin e qeverisjes lokale, kuvendet komunale kanë filluar të jenë më kërkuese në aspektin e llogaridhënies nga kryetarët e komunave, edhe pse niveli i adresimit të rekomandimeve të ZKA-së ende është i ulët. Prandaj, për përmirësimin e ardhshëm, ZKA-ja iu ka dhënë komunave rekomandim specifik, si më poshtë: *"Përsërisim rekomandimin e vitit të kaluar që Kryetarët e Komunave t'i diskutojnë në baza të rregullta raportet e menaxherëve përgjegjës për zbatimin e planeve të veprimit, dhe së paku dy herë në vit, të raportojnë në Kuvendin Komunal lidhur me progresin dhe sfidat në këtë fushë"*.⁶⁰

Përveç dhënies së rekomandimeve, ZKA-ja vlerëson se qeverisja e mirë në sektorin publik inkurajon vendimmarrje të mirë dhe afatgjatë si dhe shfrytëzim efikas dhe efektiv të burimeve si financiare, ashtu edhe atyre njerëzore. Rezultatet e auditimeve individuale nxjerrin në pah progresin e shënuar gjatë viteve, nga komunat të cilat ende nuk kanë arritur të kuptojnë rëndësinë dhe përfitimet e nevojshme në zbatimin e rekomandimeve dhe përfitimit që komunat mund të kenë nga zbatimin e kërkesave që lidhen

56 Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA). *Raporti Vjetor i Auditimit (2018)*. Gusht 2019, fq. 61.

57 Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA). Zbatimin e rekomandimeve të auditorit nënkupton qeverisje më të mirë. Komunikatë për shtyp. 29 nëntor 2019.

58 Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA). 31. Tetor 2019. Raporti Vjetor i Auditimit (2018). Gusht 2019, fq. 60.

59 Raporti i trajnimit nga projekti DEMOS. Tema e trajnimit: Implementimi i rekomandimeve të auditorit. 5 korrik 2019.

60 Zyra Kombëtare e Auditimit (NAO). *Raporti Vjetor i Auditimit (2018)*. Gusht 2019, fq. 65.

me qeverisjen e mirë”.⁶¹ Po ashtu, sipas të njëjtit burim, themelimi i Njësive të Auditimit të Brendshëm dhe Komiteteve të Auditimit në të gjitha organizatat ende mbetet sfidë si dhe ka ende mungesë të stafit/ auditorëve të mjaftueshëm në institucionet e sektorit publik.

Në aspektin e trajnimeve dhe kontributit që mund të ofrojë projekti DEMOS në këtë aspekt, edhe pse trajnime mbi zbatimin e rekomandimeve nga ZKA-ja janë mbajtur në 2019, duhet konsideruar vazhdimësinë e organizimit të trajnimeve të tilla për shkak të rëndësisë së çështjes. Kjo vlerësohet të jetë e nevojshme për të gjitha komunat (38) ku 17 prej tyre nuk kanë hyrë as në kategorinë e parë, pra performanca është nën 30% e rezultatit në SMPK.

3.3.2. Menaxhimi i kontratës

Menaxhimi i kontratës është nën-fusha e dytë në kuadër të fushës së menaxhimit komunal dhe ka dy tregues ku njëri prej tyre (treguesi 18 me ngjyrë trëndafili) është i ngrirë.

Tabela 6. Nën-fusha e menaxhimit të kontratës me dy tregues

Nën-fusha 2: Menaxhimi i kontratës	
17.	Zbatimi i planit të prokurimit
18.	Hartimi dhe publikimi i listës së pronave komunale që planifikohen të jepen në shfrytëzim dhe të shkëmbehen

Menaxhimi i kontratës peshon 7% të totalit të fushës së menaxhimit komunal, ndërkohë që treguesi si më poshtë përbën 3% të totalit të treguesve të performancës.

3.3.2.1. Zbatimi i planit të prokurimit

Ky tregues mat shkallën e përmbushjes së planit të prokurimit i matur në vlerë financiare. Treguesi mat shumën e shpenzimeve përmes procedurave të prokurimit kundrejt shumës së shpenzimeve të planifikuara përmes prokurimit. Siç tregon analiza e të dhënave GPK-së, vërehet se ka përmirësim nga ana e komunave në zbatimin e aktiviteteve të parapara në planin e prokurimit. Komunat me rezultat deri në 60% të shpenzimeve në prokurim krahasuar me planifikimin e shpenzimeve në prokurim, marrin zero pikë, komunat me shpenzime në mes të 60 dhe 90% në prokurim publik krahasuar me planifikimin e shpenzimeve marrin nga një pikë dhe kategoria e tretë përfshin komunat që kanë shpenzuar 90% ose më shumë në prokurim krahasuar me planifikimet për shpenzime në prokurim. Sipas të dhënave të analizës së ZKA-së, komunat janë renditur në këtë mënyrë: 15 komuna kanë shpenzuar 100% të buxhetit të planifikuar në prokurim, tetë komuna kanë shpenzuar barabartë ose më shumë se 90%, 12 komuna kanë shpenzuar në mes të 60 dhe 90% dhe vetëm dy komuna janë renditur me zero pikë sepse rezultati i tyre i shpenzimeve në prokurim publik, krahasuar me planifikimin, ka qenë 25% komuna e Leposaviqit dhe 24% komuna e Skenderajt, duke përjashtuar komunën e Parteshit e cila nuk ka dërguar të dhëna për këtë tregues. Në bazë të kësaj, 23 komunat janë në kategorinë më të lartë (90% e më lartë), 12 janë në kategorinë e dytë (60-90%) dhe tri komuna janë në kategorinë e fundit. Mesatarja e këtij treguesi për vitin 2018 është po ashtu e lartë, 84%.

Sa i përket krahasimit me vitin 2017, numër më i madh i komunave janë në kategorinë e tretë (më të lartë) në vitin 2018 se sa 2017 (23 në 2018 me 17 në 2017), rrjedhimisht numër më i vogël në 2018 krahasuar me 2017 në kategorinë në mes të 60 dhe 90%, dhe për një komunë më pak në kategorinë më të vogël, 60%. Njëjtë me 2018, një komunë nuk ka raportuar të dhëna mbi zbatimin e planit të prokurimit as në 2017.

⁶¹ Zyra Kombëtare e Auditimit (NAO). Raporti Vjetor i Auditimit (2018). Gusht 2019, fq. 69.

Treguesi 17




Figura 22. Nr. i komunave që kanë (nuk) zbatuar planin e prokurimit

Arsyet për këtë rritje të zbatimit të planit të prokurimit në vitin 2018, kanë të bëjnë me dy gjëra: njëra ka të bëjë me hapjen publike të kontratave dhe e dyta me zbatimin e plotë të sistemit elektronik të prokurimit. Këto dy hapa konsiderohen si hapa të suksesshëm për prokurimin publik në Kosovë sepse me këtë lejohet që publiku t'i analizojë procedurat e prokurimit dhe zbatimin e tyre. Në anën tjetër, sistemi elektronik i prokurimit publik parandalon shkeljet në të gjitha fazat deri te nënshkrimi i kontratës.

Planifikimi i duhur i prokurimit është një element kyç në të gjithë ciklin e prokurimit. Raporti për vendin, i Komisionit Evropian (2018), thekson se vendi duhet të forcojë mbikëqyrjen dhe monitorimin e ciklit të plotë të tenderimit.⁶² Raporti i financuar nga USAID-i dhe i zbatuar nga BIRN sugjeron që publiku duhet të ketë qasje në dokumente publike, kryesisht në dokumente të prokurimit, pastaj se si të publikohen faturat, pagesat, raporti i komisionit, dorëzimi në formën elektronike duhet të jetë i obligueshëm, buxheti i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP) dhe i Institutit të Kosovës për Administratë Publike (IKAP) të rritet dhe të ofrohen trajnime për zyrtarët e prokurimit me qëllim të ngritjes së nivelit të profesionalizmit, etj.⁶³ Edhe pse ky studim mbulon vetëm një numër të komunave, megjithatë shpjegon shkallën e problemit, se si institucionet dështojnë të investojnë në ngritjen e kapaciteteve për planifikimin dhe zbatimin më të mirë të aktiviteteve të prokurimit. Një shkak i shpeshtë i identifikuar nga komunat për ekzekutimin e buxhetit të ulët për shpenzimet kapitale janë vonesat dhe sfidat me cilat përballen me procedurat e prokurimit.

Sipas raportit vjetor të ZKA-së “auditimi i vitit 2018 ka identifikuar se aktivitetet e prokurimit vazhdojnë të përcillen me mangësi duke filluar nga planifikimi i prokurimit, zhvillimi i procedurave të prokurimit, deri te menaxhimi i kontratave. Prej tyre, pjesën më të madhe e përbëjnë komunat me afro 72%, institucionet qendrore me mbi 15%, ndërsa institucionet e pavarura me afro 13%”.⁶⁴ Edhe këtu, arsyet kryesore lidhen me procedurat e stërzgjatura të prokurimit, ankesave të operatorëve në Organin e Shqyrtimit Publik (OSHP), çështjeve të pazgjidhura pronësore, etj.

Përveç sfidave me procedurat e prokurimit, vëmendje më e madhe duhet t'u kushtohet menaxhimit dhe zbatimit të kontratës. Edhe pse formalisht për çdo kontratë ka një menaxher të caktuar të kontratës, menaxherët duhet të jenë të përgjegjshëm duke siguruar zbatimin kualitativ dhe në kohë të kontratave. Në të ardhmen, treguesit specifikë që matin zbatimin e projekteve nga investimet kapitale, sipas afateve të propozuara dhe të dakorduara, mund të jenë të dobishëm për të përmirësuar performancën komunale në këtë drejtim. Duke pasur parasysh problemet që janë shfaqur me kornizën ligjore, Ministria e Financave dhe KRPP-ja kanë filluar në vitin 2019 hartimin e draft-koncept-dokumentit për fushën e prokurimit publik. Në këtë koncept-dokument adresohen rekomandimet e Komisionit Evropian në raportin e Vendi për Kosovën 2019, konkretisht harmonizimin e mëtejshëm të legjislacionit vendor me EU acquis për

62 Komisioni Evropian (KE), Kosovo Progress Report, prill 2018, f. 57.

63 USAID Kosovo. BIRN. “Public Procurement Monitoring Report in Kosovo”. Prishtinë. Dhjetor 2019, fq.30.

64 Zyra Kombëtare e Auditimit. *Raporti Vjetor i Auditimit (2018)*. Gusht, 2018, fq.73.

prokurimin publik, duke përfshirë partneritetet dhe koncesionet publiko-private si dhe sigurimin e zbatimit të duhur të Ligjit për prokurimin publik.⁶⁵ Sipas raportit mbi aktivitetet e prokurimit publik për vitin 2018, korniza ligjore e prokurimit publik në masë të madhe është e përshtatur me sistemin e prokurimit tradicional - kanë dalë probleme në aspektin e përdorimit elektronik të këtij sistemi. Po ashtu, legjislacioni aktual është paraparë që të ndryshohet edhe për shkak të harmonizimit të tij me direktivat e BE-së.⁶⁶

Gjithashtu, në kuadër të draft-koncept-dokumentit theksohet se “përmirësimi dhe avancimi i sistemit të prokurimit publik, duke përfshirë një përmirësim dhe avancim të mëtutjeshëm të kornizës ligjore në prokurimin publik, si në aspektin e harmonizimit me direktivat e BE-së, ashtu edhe në eliminimin e disa vështirësive që janë hasur gjatë zbatimit të tij në praktikë, janë kërkesa që dalin nga dokumentet relevante si: Strategjia Kombëtare për Prokurim Publik; Plani kombëtar për Zbatimin e MSA-së (2019-2023)⁶⁷ dhe Raporti “GAP Assessment” i kapitullit të 5-të të Acquis.⁶⁸

Megjithatë, sa u përket trajnimeve në këtë fushë, është e nevojshme që të organizohen trajnime në ngritje të kapaciteteve të zyrtarëve komunalë në planifikimin dhe zbatimin më të mirë të aktiviteteve të prokurimit publik me theks të veçantë në planifikimin, menaxhimin dhe zbatimin e kontratës, mirëpo projekti nuk ka ofruar trajnime në këtë fushë gjatë 2019 për shkak se ato janë ofruar nga projekti US-AID-TEAM dhe se e njëjta gjë vlen edhe për vitin 2020.

3.3.3. Menaxhimi i burimeve njerëzore

Menaxhimi i burimeve njerëzore është nën-fusha e tretë e menaxhimit komunal dhe vlerësohet në bazë të të dhënave për tre tregues sikurse janë paraqitur më poshtë. Megjithatë, treguesi 20 me ngjyrë trëndafili është i ngrirë, prandaj vlerësimi dhe analizimi i të dhënave bëhen për dy treguesit tjerë. Kjo nën-fushë peshon 10% të totalit të fushës së menaxhimit komunal.

Tabela 7. Nën-fusha e menaxhimit të burimeve njerëzore me tre tregues

Nën-fusha 3: Menaxhimi i burimeve njerëzore	
19.	Vende të hapura pune të proceduara përmes SIMBNJ-së
20.	Gratë në pozita udhëheqëse në institucionet e arsimit, shëndetësisë, kulturës
21.	Gratë e emëruara në pozita politike në komunë

3.3.3.1. Vende të hapura pune të proceduara përmes SIMBNJ-së

Ky tregues mat performancën e autoriteteve komunale për të siguruar pajtueshmërinë me menaxhimin e burimeve njerëzore në komunë, duke siguruar që të gjitha vendet e lira të punës përpunohen përmes sistemit elektronik SIMBNJ. Performanca e treguesit vlerësohet duke u bazuar në informatat e dhëna për: (i) numrin e përgjithshëm të punësimeve të reja të nëpunësve civilë gjatë vitit, në komunë dhe në institucionet vartëse të saj në raport me; (ii) numrin e përgjithshëm të punësimeve të reja të nëpunësve civilë gjatë vitit në komunë dhe në institucionet vartëse të saj, të përpunuara përmes SIMBNJ-së. Divizioni për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore dhe Zhvillimin e Kapaciteteve në kuadër të Departamentit për Administrimin e Shërbimit Civil (DASHC) i Ministrisë së Administratës Publike administron sistemin

65 Komisioni Evropian, Raporti për vendin 2019.

66 Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, Raport mbi aktivitetet e prokurimit publik në Kosovë për vitin 2018, Mars 2019, f. 70 dhe 71.

67 Qeveria e Republikës së Kosovës, Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit 2019-2023, (Prishtinë, Mars 2019).

68 Ministria e Financave. Draft-koncept-dokumenti i prokurimit publik. Raporti “GAP Assessment” kapitullit të 5-të të Acquis, Twinning Project KS IPA OT 02 16 (Prishtinë, Janar 2018)

në fjalë (SIMBNJ) dhe është përgjegjës për të siguruar që sistemi korrespondon me strukturat organizative, pagat, përkufizon rregullat dhe procedurat për menaxhimin dhe operimin e SIMBNJ-së për të gjitha institucionet, mbikëqyr futjen e të dhënave dhe verifikimin dhe organizon trajnime për përdorimin e SIMBNJ-së. Me regjistrimin e procesit të rekrutimit në sistem, ministria përkatëse siguron llogaridhënie dhe transparencë në proces.

Në këtë aspekt, në fillim të 2019 janë miratuar tri ligje bazë për reformën e administratës publike apo siç njihet ndryshe pakoligjore e reformës së administratës publike. Në këtë pako janë përfshirë: Ligji për zyrtarët publikë i cili shfuqizon Ligjin për shërbimin civil, Ligji për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura i cili shfuqizon Ligjin për administratën shtetërore dhe Ligji për pagat në sektorin publik i cili është hartuar dhe miratuar për herë të parë (përfshirë Ligjin për pagat për nëpunësit civilë të vitit 2010 i cili nuk është zbatuar asnjëherë). Megjithatë, me përjashtim të Ligjit për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura, të dy ligjet tjera janë pezulluar nga Gjykata Kushtetuese pas kërkesës për vlerësim të disa neneve të të dy ligjeve nga ana e Institucionit të Avokatit të Popullit. Ligji për pagat është i pezulluar deri në fund të marsit 2020 kurse Ligji për zyrtarët publikë pas pezullimit të parë deri në fund të shkurtit 2020, pezullimi është shtyrë deri në fund të prillit 2020. Ajo që vlen të ceket në këtë kuadër është që zbatimi i tri ligjeve bëhet krahas njëri-tjetrit, d.m.th. Ligji për paga nuk mund të zbatohet pa Ligjin për zyrtarët publikë, por edhe Ligji për organizimin nuk mund të zbatohet pa këto dy të parat për shkak se nuk mund të flitet për organizim pa ditur sistematizimin e vendeve të punës (i rregulluar me Ligjin për zyrtarët publikë dhe legjisllacionin sekondar i cili ende nuk është miratuar në Qeveri pa pasur një vendim të Gjykatës Kushtetuese mbi këtë ligj) dhe po ashtu pa caktimin e pagave për këta zyrtarë publikë. Sa i përket ndikimit në nivel lokal, Ligji për zyrtarët publikë përfshin edhe nivelin lokal e po ashtu edhe Ligji për pagat në sektorin publik. Në anën tjetër, Ligji për organizimin nuk përfshin komunat në fushë veprimtarinë e vet me përjashtim të administratës shtetërore (Qeverisë) dhe agjencive të pavarura nën Kuvendin e Kosovës. Megjithatë, nëse Ligji për zyrtarët publikë kthehet në fuqi pas një vendimi të Gjykatës Kushtetuese dhe shfuqizon Ligjin për shërbimin civil, do të ketë ndryshime në sistematizimin e vendeve të punës në komuna dhe ndryshime për personelin në komuna. Në këtë rast, projekti DEMOS do të duhej të konsiderojë organizimin e një serie të trajnimeve në veçanti për menaxherët e personelit në komuna për t'u përshtatur me rregullat e Ligjit për zyrtarët publikë dhe rregulloret të cilat janë hartuar dhe miratimi i tyre është në pritje të vendimit të Gjykatës Kushtetuese për këtë ligj.

Sa i përket situatës së vitit 2018, siç tregon analiza e të dhënave, shumica e komunave i kanë proceduar konkurset e hapura përmes SIMBNJ-së. Ndarja e komunave sipas rezultateve është bërë sipas kësaj formule: komunat marrin zero pikë nëse rezultati në SMPK mbi procedimin e rekrutimeve të nëpunësve civilë përmes SIMBNJ-së është më i vogël se 50%, komunat marrin një pikë nëse në këtë tregues kanë pasur rezultatin në mes të 50 dhe 90% dhe komunat marrin dy pikë nëse rezultati i tyre në SMPK është i barabartë ose më lartë se 90%. Në bazë të kësaj, 22 komuna kanë proceduar më tepër se 90% të konkurseve të hapura përmes SIMBNJ-së (dhe atë 100%), dy komuna kanë proceduar ndërmjet 50 – 90% të konkurseve të hapura përmes SIMBNJ-së (Rahoveci me 71% dhe Prizreni me 53%) dhe 12 komuna kanë proceduar deri në 50% të konkurseve të hapura përmes SIMBNJ-së. Në këtë aspekt, dy komuna nuk kanë raportuar fare të dhëna (Leposaviqi dhe Zubin Potoku). Sa u përket 12 komunave, vlen të ceket që gjashtë nga to kanë rezultatin 0% (Parteshi, Obiliqi, Zveçani, Shtërpca, Mamusha, Ranillugu) kurse gjashtë komuna tjera kanë një rezultat të ulët në këtë drejtim (Prishtina me 6%, Podujeva me 16%, Kllokoti 16%, Ferizaj 37%, Dragashi 22% dhe Klina me 20%. Mesatarja e të gjitha komunave në këtë tregues për vitin 2018 është 64%.

Sa i përket krahasimit me 2016 dhe 2017 në aspektin e mesatares, mund të thuhet që mesatarja për këtë tregues të performancës ka pasur ngritje, nga 60% në vitin 2016 në 61% në vitin 2017, si dhe në 64% në vitin 2018. Sa i përket kategorizimit të komunave në këto vite, në vitin 2016 ka pasur 23 komuna me rezultatin e barabartë ose më lartë se 90% (një komunë më shumë se në 2018), mirëpo numri i komunave që nuk kanë deklaruar të dhëna ka qenë mjaft i lartë (10 komuna) dhe ka bërë që mesatarja në krahasim me 2017 dhe 2018 të jetë më e ulët. Për të parë në mënyrë vizuale ndarjen e komunave sipas kategorive për vitin 2018 por edhe krahasimin e tyre me 2016 dhe 2017, shih figurën në vazhdim.

Treguesi 19




Figura 23. Nr. i komunave që kanë (nuk) hapur vende të punës sipas SIMBNJ-së

Menaxhimi i duhur i aplikacioneve përmes SIMBNJ-së do të zvogëlonte rekrutimin e kontestuar, përkatësisht do të garantonte hapa të gjurmshëm të procesit të rekrutimit në rast të kontestit.

Shkaku se pse 12 komunitat janë renditur në kategorinë e “më pak se 50% të punësimeve të hapura janë proceduar përmes SIMBNJ-së në vitin 2018”, lidhet me faktin se grupi i kandidatëve që kanë aplikuar nga jashtë nuk ka përdorur SIMBNJ-në, grup i cili duhet të përfshihet në mënyrë manuale në sistem nga stafi i Burime Njerëzore (BNj). Shqetësimi kryesor është numri i lartë i aplikacioneve dhe numri i ulët i stafit të BNj-ve për të administruar të dhënat dhe për t'i përfshirë ato në sistem.⁶⁹

Në veçanti, zbatimi i SIMBNJ-së është duke u përballur me sfida të mëdha për shkak të jo familjarizimit të duhur me procedurat e menaxhimit të burimeve njerëzore, mungesë e kapaciteteve të stafit (stafi politik, drejtorët dhe kryetari) nëpër komuna.⁷⁰ Gjithashtu, konsiderohet i nevojshëm zbatimi i rregullave dhe legjislacionit për shërbimin në nivelin komunal sidomos nëse legjislacioni për shërbimin civil ndryshon me kthimin në fuqi të Ligjit për zyrtarët publikë dhe legjislacionit sekondar. Ashtu siç është thënë edhe më lartë, me gjithë performancën mesatare të komunave në këtë tregues projekti do të duhej që këtë tregues ta adresojë përmes kanaleve të komunikimit në zbatimin e legjislacionit (primar dhe sekondar) sa i përket menaxhimit të burimeve njerëzore, si dhe një prej pikave mund të jetë përdorimi i SIMBNJ-së.

“Mesatarja e këtij treguesi në vitin 2016 ka qenë 59%, në vitin 2017 61% dhe në vitin 2018 rezultati ka pasur një ngritje të lehtë me 64%”

3.3.3.2. Gratë e emëruara në pozita politike në komunë

Ky tregues synon të matë përbushjen e detyrimit komunal për të siguruar barazinë gjinore në pozitat politike të strukturës komunale në vitin e vlerësuar. Për të bërë vlerësimin, bëhet një krahasim në mes të numrit të pozitave të emëruara politikisht dhe numrit real të grave në këto pozita. Këto janë pozita e nënkryetarit të komunës, drejtorët komunalë, këshilltarët politikë si dhe pozitat me mandat politik pa përfshirë këtu anëtarët e Kuvendit Komunal të cilët janë të zgjedhur dhe kanë një rregullim tjetër në bazë të Ligjit për zgjedhjet lokale.⁷¹ Ky ligj përcakton kuotën 30% të përfaqësimit të gjinisë tjetër në numrin total të anëtarëve të Kuvendit Komunal përcaktuar me Ligjin për vetëqeverisjen lokale, kurse Ligji për barazi

69 Fokus Grupi/Punëtori. Tema: Burimet njerëzore. Prishtinë, Kosovë. Shkurt, 2019.

70 Raporti i trajnimit të DEMOS-it. Tema e trajnimit: Menaxhimi i Burimeve Njerëzore. Dhjetor, 2019.

71 Ligji nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, Nenet 7 dhe 8.

gjinore⁷² përcakton kuotën në masën 50% në të gjitha organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore të Republikës së Kosovës. Edhe pse këtu ekziston një konflikt në mes dy ligjeve sepse përcaktojnë kuota të ndryshme, vlerësimi në këtë raport merr për bazë Ligjin për barazi gjinore duke përfshirë anëtarët e Kuvendit Komunal. Sipas rezultateve në SMPK, mesatarja për të gjitha komunat në këtë tregues është 20% dhe vlerësohet e ulët dhe nuk ka rritje në krahasim me vitin 2017. Megjithatë, mund të thuhet se ka progres në krahasim të mesatareve në 2017 dhe 2018 krahasuar me 2016 e cila ka qenë 14%. Në këtë aspekt, duhet rritje e vetëdijes në komuna (kryesisht në menaxhmentin e lartë) që të punohet më shumë në rritjen e pjesëmarrjes gjinore në pozitat që janë të emëruara politikisht në komunë.

Meqenëse për vlerësim në këtë raport është marrë kuota prej 50% e përcaktuar me Ligjin për barazi gjinore, vlerësimi i komunave bëhet kundrejt këtij caku (targeti) dhe është ndarë në komunat që rezultatin në SMPK e kanë deri në 29.99% dhe marrin zero pikë, komunat që kanë rezultatin në këtë tregues në mes të 30 dhe 50% dhe komunat që rezultatin e kanë të barabartë apo më të lartë se 50%. Në bazë të këtyre kategorive, komunat janë ndarë në këto kategori. Në kategorinë prej 50% ose më lartë është vetëm një komunë, ajo e Glllogocit derisa pesë komuna tjera janë në kategorinë në mes të 30 dhe 49% (Gjakova me 34%, Kamenica me 47%, Kllokoti me 42%, Mitrovica e Veriut me 40% dhe Suhareka me 30%). Nga ky numër, 32 komuna tjera janë në kategorinë më të vogël se 30% dhe kanë nivele të ndryshme të përqindjes mirëpo në kuadër të kësaj kategorie vlerësohen me zero pikë. Përfshirë, komunës së Zubin Potokut dhe asaj të Leposaviqit të cilat nuk kanë deklaruar të dhëna, komunat me rezultatin më të ulët janë këto: Parteshi, Shtërpca dhe Zveçani me 0%, Mitrovica e Jugut me 8%, Klina me 9%, Malisheva dhe Prizreni me 14%, Obiliqi me 15%, Lipjani me 15% dhe Mamusha me 18%.

Sa i përket krahasimit në mes të 2018 dhe viteve 2016 dhe 2017, në dy vjetët e fundit nuk është vërejtur ndonjë ndryshim derisa ka pasur progres në kategorinë e komunave me rezultatin në mes të 30 dhe 49% në mes viteve 2016 dhe 2017-2018. Në kategorinë me rezultatin e barabartë ose më të lartë se 50%, në vitin 2017 dhe 2018 ka qenë nga një komunë kurse në 2016 asnjë komunë. Dallim i theksuar në mes të 2016 dhe 2017-2018 vërehet te numri i komunave që nuk kanë raportuar të dhëna, pra në vitin 2016 nuk kanë raportuar 11 komuna kurse vetëm nga dy komuna nuk kanë raportuar në 2017 dhe 2018.




Figura 24. Nr. i komunave që (nuk) kanë emëruar gra në pozita politike

Sipas raportit të organizatës Demokraci për Zhvillim (ang. D4D) mbi përfshirjen e gruas në vendimmarrje në qeverisjen lokale në Kosovë, pjesëmarrja dhe përfaqësimi i gruas në komuna kanë mbetur të ulëta edhe në vitin 2018. Sipas të njëjtit burim, nga 38 pozita si kryesues të komunës, kjo pozitë është mbajtur nga gratë vetëm në gjashtë komuna, pastaj nga 10 raste të emërimeve të zëvendës kryesuesve të kuvendeve komunale, asnjë prej tyre nuk është ushtruar nga gratë. Po ashtu, në rastin e nënkryetarëve të komunave, vetëm në dy raste kjo pozitë është ushtruar nga gratë derisa në rastin e zëvendës kryesuesit për komunitete, vetëm një nga tetë pozita (raste) është ushtruar nga gratë.⁷³

⁷² Ligji nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, Neni 6, pika 8.

⁷³ Demokraci për Zhvillim (ang. D4D), Inclusion of women in decision-making and local governance in Kosovo, Prishtina,

Sipas raportit të Komisionit Evropian (KE) të vitit 2018, “Gratë mbeten të nën-përfaqësuar në pozitat lokale të vendimmarrjes.” Megjithatë, përpjekjet nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MPL) kanë rezultuar me disa përmirësime. Përqindja e pozitave të drejtorëve në organet ekzekutive komunale të mbajtura nga gratë është rritur nga 11% në 19%. Në 31 nga 38 komunat, pozitat e paguara të komisioneve të kuvendeve të komunës përfshijnë një numër të barabartë të grave dhe burrave, siç kërkohet me Ligjin për Barazi Gjinore. Nga 38 komunat, sot asnjë grua nuk mban pozitën e kryetarit të komunës.

Projekti DEMOS ka mbajtur trajnime në këtë tregues dhe përgjigja e komunave ka qenë se ky tregues është shumë i politizuar, dhe se progresi në këtë tregues është vështirë i arritshëm. Aspektet e mospërputhjes janë kryesisht politike, veçanërisht në raste të koalicioneve qeverisëse, ku emrat për drejtorë të drejtorive komunale janë propozuar nga partitë politike. Angazhimi në ngritjen e ndërgjegjësimit të akterëve politikë lidhur me rëndësinë e emërimit të grave në pozita politike mund të japë rezultate të favorshme. Prandaj, ky tregues do të adresohet përmes formave të komunikimit.

3.4. Ofrimi i shërbimeve

Ofrimi i shërbimeve në nivel lokal është fusha e tretë e grantit të performancës komunale e cila ka katër nën-fusha dhe nëntë tregues gjithsej. Nën-fusha e parë ka dy tregues, nën-fusha e dytë ka tre tregues kurse nën-fushat tre dhe katër kanë nga dy tregues. Megjithatë, nën-fusha e parë ka një tregues të ngrirë derisa nën-fushat tre dhe katër kanë të dy treguesit e ngrirë, gjë që bën që vlerësimi dhe analiza të jepen në vazhdim për katër nga nëntë tregues gjithsej. Treguesit e ngrirë paraqiten me ngjyrë trëndafil për të qenë e qartë se cilët tregues janë të ngrirë dhe si rrjedhojë nuk janë pjesë e vlerësimit dhe analizës në këtë fushë. Tabela në vazhdim paraqet katër nën-fushat dhe treguesit për secilën nën-fushë.

Tabela 8. Fusha e ofrimit të shërbimeve, nën-fushat dhe treguesit

Fusha: Ofrimi i shërbimeve	
Nën-fusha 1: Shërbimet administrative	
22.	Rastet e kërkesave administrative të shqyrtuara brenda afateve ligjore
23.	Kërkesat e shqyrtuara për leje të ndërtimit
Nën-fusha 2: Planifikimi hapësinor, transporti publik dhe mjedisi	
24.	Shtirja e territorit komunal të përfshirë në planet (e hollësishme) rregullative
25.	Vendbanimet e mbuluara me transport publik lokal
26.	Niveli i zbatimit të planit lokal të veprimit për mjedisin
Nën-fusha 3: Arsimi parauniversitar	
27.	% e fëmijëve që frekuentojnë kopshtin
28.	Rezultatet në test të maturës
Nën-fusha 4: Kujdesi parësor shëndetësor	
29.	Hapësira të KPSH në m ² për 10,000 banorë
30.	Niveli i përmbushjes së raportit 1 mjek familjar dhe 2 infermiere për 2,000 banorë

Duke e marrë parasysh numrin e madh të treguesve të ngrirë, performanca e përgjithshme e kësaj fushe nuk mund të matet me saktësi për vitin 2018. Përveç kësaj, krahasimi i performancës ndër vite në këtë fushë është i pamundur pasi që kjo është fushë e re e grantit dhe vlerësimi i performancës komunale për vitin 2018 në këtë fushë bëhet për herë të parë. Megjithatë, në bazë të vlerësimit të katër treguesve (që do të jepet më poshtë për secilin), mesatarja e arritur në këtë fushë është 70%. Sa u përket nën-fushave, në fushën e shërbimeve administrative është vlerësuar vetëm një tregues dhe mesatarja për këtë tregues ka arritur 87%, kurse nën-fusha e planifikimit hapësinor, transportit publik dhe mjedisit ka arritur mesataren prej 53%. Në anën tjetër, të tre treguesit e nën-fushës së dytë kanë këtë mesatare:

shtrirja e territorit komunal të përfshirë në planet rregullative me mesatare 20%; vendbanimet e mbuluara me transport publik lokal me mesatare prej 67% dhe niveli i zbatimit të planit lokal të veprimit për mjedisit me mesataren prej 74%.

Në pjesët në vijim, vlerësimi dhe analiza e treguesve bëhen nga të dhënat e grantit të performancës komunale për vitin 2018 duke marrë parasysh edhe burimet sekondare në këtë fushë. Në bazë të sistemit të kriterëve të dizajnuara për përcaktimin e prioritetëve për trajnim, problemet e identifikuara është vështirë të trajtohen nëpërmjet trajnimeve të ofruara nga DEMOS për shkaqet e mëposhtme:

- DEMOS aktualisht nuk ka ekspertizë për t'i adresuar problemet e identifikuara në fushën e ofrimit të shërbimeve, prandaj asnjë nga treguesit në fushën e ofrimit të shërbimeve nuk do të adresohet me ndonjë aktivitet nga projekti;
- Projekte të tjera që përkrahin komunat në Kosovë janë duke ofruar asistencë teknike për komunat në këtë fushë. Për shembull, GIZ-i është duke i përkrahur komunat, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) për t'i hartuar hartat zonale;
- Një numër i problemeve ndërlidhen me mungesën e investimeve kapitale në atë fushë ose probleme të tjera të cilat nuk mund të adresohen përmes trajnimeve.

Megjithatë, disa prej problemeve të identifikuara mund të adresohen nëpërmjet fushatave të targetuara të komunikimit.

Për të kuptuar më nga afër performancën komunale në fushën e “ofrimit të shërbimeve”, është krijuar sistemi i “semaforëve”. Rëndësia e ngjyrave vlerësohet në bazë të numrit të komunave që kanë treguar performancë të dobët, mesatare apo të mirë.




Figura 25. Sistemit i “semaforit” për ofrimin e shërbimeve

Siç shihet në figurën më lartë, shumica e komunave kanë treguar performancë të dobët në treguesin 24 ose ‘shtrirja e territorit komunal të përfshirë në planet rregullative’ për shkak se 28 komuna kanë më pak se 30% të territorit komunal të përfshirë në planet rregullative për vitin 2018. Treguesit tjerë lidhur me ofrimin e shërbimeve tregojnë performancë më të mirë. Së paku 80% e vendbanimeve në 22 komuna janë të mbuluara me transport publik lokal kurse së paku 90% e kërkesave publike për qasje në informata publike në 32 komuna kanë marrë përgjigje. Po ashtu, së paku 90% e aktiviteteve të parapara në kuadër të planit lokal për veprim në mjedis janë zbatuar në 32 komuna gjatë vitit 2018.

3.4.1. Shërbimet administrative

Nën-fusha e shërbimeve administrative paraqet të dhënat e mbledhura dhe analizën sa i përket nivelit të shqyrtimit të kërkesave të qytetarëve brenda afateve ligjore. Ky tregues është i vetmi tregues i analizuar në këtë nën-fushë. Treguesi i analizuar në kuadër të nën-fushës së shërbimeve administrative përbën 33.3% të pikëve në kuadër të treguesve të analizuar të fushës së ofrimit të shërbimeve. Ky tregues përbën 6.9% të pikëve të përgjithshme të performancës në GPK për vitin 2018.

3.4.2. Rastet e kërkesave administrative të shqyrtuara brenda afateve ligjore

Treguesi mat efektivitetin e autoriteteve komunale në shqyrtimin e kërkesave të paraqitura nga qytetarët dhe organizatat përgjatë vitit të vlerësuar. Vetëm rastet e regjistruara (dorëzuara) përmes Qendrës për Shërbim me Qytetarët (QSHQ) merren parasysh dhe llogariten për këtë qëllim.

Baza ligjore për treguesin është në Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative⁷⁴ dhe një grup i gjerë ligjesh dhe aktesh nënligjore që rregullojnë kohëzgjatjet specifike të procedurave. Performanca e treguesit vlerësohet duke siguruar informata në lidhje me: (i) numrin e rasteve të shqyrtuara nga komuna gjatë vitit; (ii) numrin e rasteve të shqyrtuara nga komuna brenda afateve ligjore. Kalkulimi i rezultatit të komunave prodhon katër kategori: a) komunat që kanë shqyrtuar deri në 50% të kërkesave brenda afateve ligjore, b) komunat që kanë shqyrtuar në mes të 50 dhe 70% të kërkesave brenda afateve ligjore, c) komunat që kanë shqyrtuar në mes të 70 dhe 90% të kërkesave brenda afateve ligjore dhe d) komunat që kanë shqyrtuar në masën 90% ose më shumë të kërkesave brenda afateve ligjore.

Në bazë të kësaj dhe analizës së të dhënave, një numër i madh i komunave janë treguar efektive në shqyrtimin e kërkesave të pranuar përmes QSHQ-ve brenda afateve ligjore. Në këtë mënyrë, 32 komuna kanë shqyrtuar apo u janë përgjigjur mbi 90% të lëndëve apo kërkesave brenda afateve ligjore, një komunë ka shqyrtuar 70-90% të lëndëve (Prizreni me 70%), një komunë tjetër ka shqyrtuar 50-70% të lëndëve brenda afateve ligjore (Shtërpca me 65%) derisa dy komuna kanë shqyrtuar më pak se 50% të lëndëve (Graçanica dhe Zveçani me 0%). Të dhëna nuk janë dërguar për këtë tregues nga dy komuna (Leposaviqi dhe Zubin Potoku). Sa i përket numrit prej 32 komunave, vlen të ceket se 25 prej tyre kanë arritur rezultatin në 100% në kuadër të kategorisë mbi 90%. Siç është cekur edhe më lartë, mesatarja e komunave në këtë tregues për vitin 2018 është rreth 92 %. Ndarja e komunave sipas kategorive është dhënë në figurën më poshtë.




Figura 26. Nr. i komunave që kanë (nuk) shqyrtuar kërkesat administrative brenda afateve ligjore

Sipas një raporti të Institutit GAP mbi ofrimin e shërbimeve administrative në komunën e Novobërdës dhe atë të Mitrovicës së Jugut, po ashtu nuk theksohen probleme sa i përket qasjes (fizike) të qytetarëve në administratën komunale dhe marrjen e përgjigjeve në kohë nga komuna. Në anën tjetër, digitalizimi i shërbimeve apo mundësia e ofrimit të shërbimeve pa pasur nevojë qytetarët të jenë prezent në komunë është fare pak e mundshme në komunën e Mitrovicës së Jugut derisa kjo nuk ekziston fare në

74 Ligji nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

komunën e Novobërdës.⁷⁵ Për më shumë, sa u përket kiosqeve elektronike për shërbime të qytetarëve që të pajisen me dokumente të gjendjes civile, një raport tjetër po ashtu i Institutit GAP ka vlerësuar që 20 komuna kanë të instaluar 42 kiosqe elektronike mirëpo 22 prej tyre nuk janë funksionale.⁷⁶ Diversifikimi i mundësive për marrjen e shërbimeve nga administrata komunale do të duhej të mendohej nga të gjitha komunat dhe përveç nevojës për funksionalizimin e plotë të 42 kiosqeve elektronike ekzistuese, komunat tjera do të duhej të instalonin mënyra të njëjta të ofrimit të shërbimeve por edhe mundësinë e ofrimit online përmes ueb-faqes së komunës ashtu siç është e mundur sot gjenerimi i faturës së mbeturinave në komunën e Prishtinës dhe gjenerimi i tatimit në pronë në të gjithë vendin. Komunat do të duhej të zgjeronin mundësinë për qytetarët në marrjen e një numri të shërbimeve online pa pasur nevojë të jenë prezent në komunë.

3.4.3. Planifikimi hapësinor, transporti publik dhe mjedisi

Nën-fusha e planifikimit hapësinor, transportit publik dhe mjedisit paraqet të dhënat e mbledhura dhe analizën lidhur me nivelin e ofrimit të këtyre shërbimeve nga ana e komunave. Siç është thënë dhe paraqitur në tabelën sipër, nën-fusha përkatëse ka tre tregues të cilët do të analizohen dhe vlerësohen në vijim. Treguesit e analizuar në kuadër të kësaj nën-fushe përbëjnë 66% të pikëve në kuadër të treguesve të analizuar të temës së ofrimit të shërbimeve. Këta tregues përbëjnë 13% të pikëve të përgjithshme të performancës në GPK për vitin 2018.

3.4.3.1. Shtrirja e territorit komunal të përfshirë në planet (e hollësishme) rregullative

Treguesi mat performancën e autoriteteve komunale në përmbushjen e mandatit të tyre për të krijuar dhe zbatuar instrumente ligjore që rregullojnë përdorimin e tokës, siç janë planet e detajuara rregullative. Në mënyrë të veçantë, treguesi mat përqindjen e territorit komunal që është i përfshirë në planet e detajuara rregullative ose hartat zonale si instrumente ligjore që rregullojnë përdorimin e tokës. Baza ligjore për këtë tregues është Ligji për Planifikimin Hapësinor.⁷⁷ Niveli i performancës së treguesit bazohet në dëshmitë e siguruara për kriteret vijuese: (i) sipërfaqen e përgjithshme të komunës në ha; (ii) sipërfaqen e përgjithshme të komunës që është e përfshirë në instrumente planifikimi siç është Plani i Detajuar Rregullativ ose Harta Zonale në ha.

Sipas analizës së të dhënave, mesatarja e komunave në këtë tregues është 20% dhe se shumica e komunave nuk e kanë të përfshirë një pjesë të madhe të territorit të tyre në planet e hollësishme rregullative. Komunat renditen në tri kategori sipas rezultatit që marrin në SMPK: komunat që kanë të përfshirë në planin rregullativ ose hartën zonale deri në 30% të sipërfaqes, komunat që kanë të përfshirë në mes të 30 dhe 70% të sipërfaqes së përgjithshme të komunës dhe komunat që kanë të përfshirë mbi 70% të sipërfaqes komunale në planin rregullativ ose hartën zonale. Në bazë të kësaj dhe rezultateve në SMPK mund të thuhet që 28 komuna e kanë më pak se 30% të territorit të tyre të përfshirë në planet rregullative, dy komuna kanë në mes të 30-70% të territorit të përfshirë në planet rregullative (Novobërda dhe Mamusha), gjashtë komuna e kanë 100% të territorit të përfshirë (Dragashi, Lipjani, Peja, Mitrovica e Veriut, Shtërpca dhe Zveçani) derisa dy komuna nuk kanë dërguar të dhëna (Leposaviqi dhe Zubin Potoku). Ndarja e komunave sipas këtyre kategorive është dhënë në figurën më poshtë.

75 Instituti GAP, Ofrimi i shërbimeve publike administrative në nivel lokal: shembull Mitrovica Jugore dhe Novobërda.

76 Instituti GAP, Ngecjet e komunave në funksionimin e kiosqeve elektronike për ofrimin e shërbimeve administrative.

77 Ligji nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor.




Figura 27. Nr. i komunave që kanë (nuk) përfshirë territorin komunal në planet rregullative

Siç bëhet e ditur nga burimet sekondare, Qeveria e Kosovës, në vitin 2019, e ka hartuar Draft Hartën Zonale të Kosovës 2020-2028+, e cila duket se ende nuk është miratuar.⁷⁸ Komunitat po ashtu kanë filluar zhvillimin e hartave zonale komunale. Zhvillimi i hartave zonale dhe planeve përcjellëse është një risi dhe do të duhet kohë që të gjitha komunitet t'i miratojnë dhe që kjo të reflektojë në performancën e tyre. Kjo mund të shpjegojë shkakun se pse shumica e komunave nuk kanë performuar mirë në këtë tregues.

3.4.3.2. Vendbanimet e mbuluara me transport publik lokal

Ky tregues mat performancën e komunës në lidhje me organizimin e shërbimeve të transportit publik për secilin vendbanim në komunë, në të mirë të qytetarëve të saj. Performanca matet si përqindja e vendbanimeve që përfshihen në sistemin e transportit publik në lidhje me numrin e përgjithshëm të vendbanimeve në komunë. Baza ligjore për këtë tregues është dhënë në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjin për Transport Rrugor.⁷⁹ Performanca e treguesit vlerësohet duke u bazuar në dëshmitë në lidhje me kriteret vijuese: (i) numrin e vendbanimeve në komunë; (ii) numrin e vendbanimeve të cilave u është siguruar transporti publik.

Sipas analizave të të dhënave për vitin 2018, mesatarja e komunave për vitin 2018 është 67% dhe mund të thuhet se komunitet kanë treguar performancë relativisht të mirë në këtë tregues. Sa i përket rezultatit që kanë arritur komunitet, ato ndahen në tri kategori: komunitet që mbulojnë deri në 50% të vendbanimeve me transport publik lokal, komunitet që mbulojnë në mes të 50 dhe 79.99% dhe komunitet që mbulojnë mbi 80% të vendbanimeve të tyre me transport publik lokal. Në bazë të kësaj dhe rezultateve në SMPK mbi këtë tregues, 21 komuna i kanë mbi 80% të vendbanimeve të mbuluara me transport publik lokal, shtatë komuna i kanë ndërmjet 50-80% të vendbanimeve (Vushtrri, Viti, Prishtinë, Hani i Elezit, Gjakovë, Kamenicë dhe Kaçanik), tetë komuna i kanë më pak se 50% të vendbanimeve të mbuluara me transport publik lokal (Kilokot, Novobërdë, Partesh, Ranillug, Zveçan, Mitrovica e Veriut, Mamushë dhe Graçanicë) kurse dy komuna nuk kanë raportuar të dhëna (Leposaviqi dhe Zubin Potoku). Ndarja e komunave sipas këtyre kategorive është paraqitur në figurën më poshtë.

⁷⁸ Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Draft Harta Zonale e Kosovës 2020-2028+, qershor 2019.

⁷⁹ Ligji nr. 04/L-179 për Transportin Rrugor.

Treguesi 25




Figura 28. Nr. i komunave që kanë (nuk) mbuluar vendbanimet me transport publik lokal

3.4.3.3. Niveli i zbatimit të planit lokal të veprimit në mjedis

Treguesi mat performancën e komunës në përgatitjen dhe zbatimin e planeve lokale të veprimit për mbrojtjen e mjedisit. Performanca matet me zbatimin e aktiviteteve vjetore të përcaktuara në plan dhe baza ligjore për këtë tregues është dhënë në Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit.⁸⁰ Performanca e treguesit vlerësohet duke u bazuar në informatat në dispozicion në lidhje me kriteret vijuese: (i) numrin e aktiviteteve të planifikuara në planin lokal të veprimit për mjedis për vitin 2018; (ii) numrin e aktiviteteve të zbatuara nga lista e planifikuara për planin lokal të veprimit për mjedis në vitin përkatës.

Sipas analizës së të dhënave për vitin 2018, mesatarja e komunave është 74% që do të thotë se komunat kanë treguar performancë relativisht të mirë në këtë tregues. Rezultati në SMPK në këtë tregues i ndan komunat në tri kategori: komunat që kanë zbatuar deri në 50% të aktiviteteve nga lista e planifikuara e aktiviteteve, komunat që kanë zbatuar në mes të 50 dhe 90% të aktiviteteve dhe komunat që kanë zbatuar mbi 90% të aktiviteteve kundrejt numrit të aktiviteteve të planifikuara me plan të veprimit për mbrojtjen e mjedisit. Në bazë të kësaj dhe rezultateve në SMPK, 21 komuna i kanë realizuar mbi 90% të aktiviteteve vjetore të parapara me këtë plan, shtatë komuna i kanë realizuar ndërmjet 50-90% të aktiviteteve (Viti, Obiliq, Klinë, Kaçanik, Hani i Elezit, Gjakovë dhe Suharekë), po ashtu shtatë komuna i kanë realizuar më pak se 50% të aktiviteteve të parapara me plan vjetor (Glllogoc, Klllokot, Mamushë, Pejë, Podujevë, Prishtinë dhe Mitrovicë e Veriut) kurse dy komunat nuk kanë dërguar të dhëna (Leposaviq dhe Zubin Potok). Ndarja e komunave sipas këtyre rezultateve për vitin 2018 është dhënë në figurën më poshtë.

⁸⁰ Ligji nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit.




Figura 29. Nr. i komunave që kanë (nuk) zbatuar planin lokal të veprimit për mjedisin

4. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Në tekstin e mëposhtëm jepen rekomandime lidhur me gjetjet në këtë raport për nevojat e zyrtarëve komunalë për ngritje kapacitetesh. Gjithashtu, edhe në shtojcën 1, tabela numër 11, paraqitet qasja që projekti do të ketë për secilin tregues, pra a do të mbahen trajnime, apo do të tentohet përmirësimi i performancës komunale përmes komunikimit për secilin tregues. Sa i përket zhvillimit të politikave gjatë vitit 2020 projekti nuk do të adresojë asnjë nga treguesit përmes zhvillimit të politikave për shkak të situatës COVID-19, si dhe për shkak të shumë çështjeve politike të paqartësuara në nivel kombëtar.

Në aspektin e dhënies së rekomandimeve për trajnime, merren parasysh disa elemente si: nëse (i) problemet e identifikuara për tregues janë teknike, e jo politike, (ii) nëse një mjet tjetër ose ndryshim sistematik do të ishte më efektiv, (iii) nëse trajnimet mbahen nga projekte tjera, (iv) pesha e treguesve të performancës, dhe në fund (v) performanca komunale bazuar në numrin e komunave (d.m.th. performuesit më të mirë kundrejt atyre më të dobët)

Siç është theksuar edhe në pjesën e metodologjisë, ky raport është hartuar duke përdorur të dhëna primare nga SMPK-ja dhe ZKA-ja, e që janë të dhëna nga dokumente publike zyrtare, gjithashtu edhe ligje, strategji, politika dhe burime tjera sekondare që përfshijnë kryesisht raporte dhe analiza mbi temat përkatëse nga organizata dhe institucione tjera.

Për shkak të pandemisë dhe situatës së krijuar me COVID-19 në Kosovë, të dhënat që përmban ky raport nuk kanë mundur të diskutohen, në fokus grupe, me zyrtarët komunalë. Megjithatë, rekomandimet për intervenime (kryesisht përmes kanaleve të komunikimit) janë të bazuara në të dhëna të dërguara nga vetë komunat me të cilat janë shërbyer SMPK-ja dhe ZKA-ja me të cilat kryesisht është hartuar ky raport, si dhe në informatat nga vlerësimi i trajnimeve të ofruara gjatë vitit 2019.

Pjesa në vazhdim shkurtimisht qartëson qasjen dhe formën e intervenimeve me qëllim të përmirësimit të performancës së komunave në treguesit ku nuk kanë treguar performancë të mirë në vitin 2018. Rekomandimet marrin parasysh edhe veprimet e institucioneve në nivel qendror, komunave dhe të donatorëve tjerë në mënyrë që intervenimet mos të jenë qoftë të kaluara ngase janë adresuar gjatë 2019 apo janë paraparë të mbulohen nga donatorë tjerë.

Megjithatë, situata e krijuar nga COVID -19 do të ndikojë në zbatimin e planit të trajnimeve për vitin 2020.

4.1. Kushtet minimale

Në numrin prej pesë kushteve minimale, tre prej tyre ishin pjesë e vlerësimit ngase dy të tjerë janë të ngrirë. Tri kushtet e vlerësuara janë: a) Opinioni i auditimit për vitin përkatës duhet të jetë të paktën i pamodifikuar me theksim të çështjes; b) Komunat duhet të kenë shpenzuar mbi 75% të buxhetit për investime kapitale, dhe c) Komunat duhet të kenë nënshkruar marrëveshjen tripalëshe të pjesëmarrjes (komuna, MPL-ja dhe HELVETAS Swiss Intercooperation). Plotësimi i këtyre tri kushteve minimale është kërkesë për kualifikimin e komunave për grant edhe për vitin 2018, ndërsa numri i komunave që janë kualifikuar për grant është 23 nga 38. Ky numër është më i madh krahasuar me 2017 kur ishin kualifikuar vetëm 19 komuna, por më i vogël se sa në 2016 kur ishin kualifikuar 25 komuna.

Sa u përket tri kushteve individualisht, kushti i tretë, apo ai i nënshkrimit të marrëveshjes tripalëshe është plotësuar nga të gjitha komunat. Kushti i opinionit të auditorit (të paktën opinion të pamodifikuar me theksim të çështjes) është plotësuar nga 36 komuna (përfshirë Ferizaj dhe Novobërda) derisa kushti i 75% të buxhetit në shpenzime kapitale është plotësuar nga 24 komuna.

Në bazë të analizave, mund të jepen një numër i rekomandimeve për intervenime përmes trajnimeve me qëllim përmirësimin e performancës së komunave në kushtet minimale:

- Përgatitja dhe shpalosja e Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) dhe klasifikimi i shpenzimeve për të gjitha komunat e sidomos për komunat Novobërdë, Ferizaj dhe Prishtinë;
- Planifikimi dhe realizimi i buxhetit (me theks në investimet kapitale) dhe menaxhimi i pasurisë për të gjitha komunat.
- Definimi i projekteve kapitale dhe klasifikimi i shpenzimeve të projekteve kapitale sipas UA nr. 04/2019 të Ministrisë së Financave;
- Procedurat e transferit dhe rialokimit të ndarjeve buxhetore sipas UA nr. 05/2019 të Ministrisë së Financave;
- Kriteret përzgjedhëse dhe prioritizimin e projekteve kapitale sipas UA nr. 06/2019 të Ministrisë së Financave;
- Përpunimi i raporteve financiare (përdorimi i programit për këtë qëllim) të nxjerra nga SIMFK Free Balance;
- Ndarja e subvencioneve – ndjekja e rregullave për ndarjen e subvencioneve – sidomos për komunën e Novobërdës;
- Menaxhimi i personelit, sidomos për komunën e Ferizajt, por duhet konsideruar përfshirjen e të gjitha komunave sidomos nëse ndryshon legjislacioni për zyrtarët publikë (ku përfshihen edhe shërbyesit civilë) në Kosovë;
- Rregullat e prokurimit publik me theks të veçantë në menaxhimin e kontratave (i tërë cikli i menaxhimit të kontratave që nga planifikimi i prokurimit, fondet, pagesat, aneks kontrata, libri i ndërtimit, mungesa e dëshmive/evidencave për të dëshmuar pagesat) sidomos për komunat Novobërdë, Ferizaj, Partesh, Dragash, Istog, Kamenicë, Obiliq, Prizren, Mitrovica e Veriut, Zubin Potok dhe Zveçan⁸¹.
- Menaxhimi i pasurive dhe menaxhimi i rrezikut.

4.2. Qeverisja demokratike lokale

Në numrin prej 13 treguesve sipas tri nën-fushave të ndara në fushën e qeverisjes demokratike lokale, vlerësimi dhe performanca e komunave janë bërë mbi tetë tregues gjithsej. Mesatarja e përgjithshme në këtë fushë është 57%. Sa u përket tri nën-fushave, ajo e rolit të Kuvendit Komunal si organ mbikëqyrës ka pasur mesataren prej 58%, nën-fusha e dytë mbi pjesëmarrjen, konsultimin dhe përfshirjen e qytetarëve ka pasur mesataren prej 49% dhe nën-fusha e tretë apo transparenca, qasja në informata dhe integriteti ka arritur mesataren prej 65%. Sa u përket treguesve individualisht, tre treguesit me mesataren më të mirë kanë qenë: treguesi 10 ose përditësimi i rregullt i ueb-faqes komunale sipas kërkesave (specifike) ligjore me mesatare prej 81%, treguesi dy ose diskutimi i raporteve buxhetore tremujore nga KK me mesatare prej 79% dhe treguesi i pestë ose raportimi i kryetarit të komunës para Kuvendit Komunal me mesatare prej 75%.

Në anën tjetër, treguesit me mesataren më të ulët janë: treguesi gjashtë apo pjesëmarrja e qytetarëve në konsultimet publike të ndara sipas gjinisë me mesatare prej 35%, treguesi katër apo diskutimi i raportit të auditorit të jashtëm dhe planit të veprimit për adresimin e rekomandimeve si dhe diskutimi i gjetjeve dhe rekomandimeve nga auditimi i brendshëm në Kuvendin Komunal me mesatare 36%, treguesi tre apo diskutimi i raportit të performancës komunale nga KK me mesatare 42% dhe treguesi trembëdhjetë apo raportimi i planit vjetor të planit të integritetit të paraqitur para Kuvendit Komunal me mesatare prej 50%.

⁸¹ Për këtë duhet një koordinim i ngushtë me TEAM/USAID;

Në bazë të këtyre, mund të jepet një numër i rekomandimeve për intervenime përmes trajnimeve dhe kanaleve të komunikimit me qëllim përmirësimin e performancës së komunave në qeverisjen demokratike:

- Ngritja e kapaciteteve të anëtarëve të kuvendeve komunale sa u përket rolit dhe përgjegjësisë si autoriteti më i lartë i procesit të vendimmarrjes mbetet thelbësor në trajtimin si dhe leximin e duhur dhe të saktë të raporteve financiare të gjeneruara nga ekzekutivi komunal. Trajnimi për leximin e drejtë të buxhetit nga të gjithë anëtarët e kuvendeve komunale është gjithashtu edhe kërkesë nga anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF). Trajnimi në këtë fushë për anëtarë të KPF-së është mbajtur në vitin 2019 me të gjitha komunat.⁸²
- Sa i përket diskutimit të raportit të performancës përveç përmbushjes së kriterit si numër, komunat do të duhej të fokusoheshin në leximin kritik të raportit përkatës dhe varësisht nga të gjeturat e raportit, komunat do të duhej të nxjerrin plane konkrete veprimi për përmirësime në atë fushë dhe KK do të duhej vazhdimisht të kërkonte llogari nga ekzekutivi mbi zbatimin e aktiviteteve që dalin nga plani përkatës. Përveç trajnimit, ky tregues do të duhej të adresohet edhe përmes komunikimit.
- Raporti i ZKA-së dhe raporti i auditimit të brendshëm, planet e komunës për zbatimin e rekomandimeve të dy raporteve (raporti i auditorit të jashtëm dhe të brendshëm) për të gjitha komunat rekomandohet që të mbahet si trajnim me prioritet dhe shumë i nevojshëm për të rritur transparencën si dhe fuqizuar rolin e anëtarëve të KK;
- Rritja e numrit të pjesëmarrësve në konsultime publike por edhe në takime publike që organizon komuna duhet të adresohet përmes formave të komunikimit, sepse projekti ka organizuar trajnim me këtë temë gjatë viteve të kaluara.
- Aktet komunale dhe dokumentet e politikave lokale të konsultuara me publikun me fokus në rritjen e pjesëmarrjes në konsultime për të gjitha komunat e sidomos për ato që nuk kanë pasur performancë të mirë në këtë tregues, do të duhej të adresoheshin përmes formave të komunikimit.

4.3. Menaxhimi komunal

Në numrin prej tetë treguesve sipas tri nën-fushave të ndara në fushën e menaxhimit komunal, vlerësimi dhe performanca e komunave është bërë mbi gjashtë tregues gjithsej. Mesatarja e përgjithshme në këtë fushë është 53%. Sa u përket tri nën-fushave, ajo e menaxhimit financiar ka pasur mesataren prej 32%, nën-fusha e dytë apo ajo mbi menaxhimin e kontratave ka pasur mesataren prej 84% (kjo është edhe mesatarja në treguesin e vetëm të vlerësuar në këtë nën-fushë) dhe nën-fusha e tretë apo menaxhimi i burimeve njerëzore ka arritur mesataren prej 42%. Sa u përket treguesve individualisht, treguesi 21 apo gratë e emëruara në pozita politike në komunë ka arritur mesataren prej 20%, treguesi 14 apo regjistri i tatimit në pronë i përditësuar çdo vit sipas kërkesave ligjore ka arritur mesataren prej 26%, treguesi 16 apo adresimi i rekomandimeve të auditimit (ZKA) ka arritur mesataren prej 30% dhe treguesi 15 apo niveli i mbledhjes së tatimit në pronë (pa borxhe, kamata, gjoba) ka arritur mesataren prej 39%. Në anën tjetër, treguesit me mesataren më të lartë në këtë fushë janë treguesi 17 apo zbatimi i planit të prokurimit me mesatare prej 84% dhe treguesi 19 apo vende të hapura pune të proceduara përmes SIMBNj-së me mesatare prej 64%.

Në bazë të këtyre, mund të jepet një numër i rekomandimeve për intervenime përmes trajnimeve me qëllim përmirësimin e performancës së komunave në fushën e menaxhimit komunal:

- Mbledhja e tatimit në pronë sidomos duke pasur parasysh hyrjen në fuqi të Ligjit të ri për tatimin në pronën e paluajtshme i cili përfshin tatimin në tokë. Duke u bazuar edhe në sugjerimet nga trajnimet paraprake, për të pasur rritje të performancës në tatimin në pronë dhe regjistrimit përkatës, rekomandohet të ketë mbështetje nga menaxhmenti i komunës me qëllim të të kuptuarit sa më të mirë rreth mbledhjes së tatimit në pronë dhe regjistrimit të pronave si dhe inkasimit dhe kjo të adresohet përmes kanaleve të komunikimit.

⁸² Raportet e vlerësimit nga trajnimi dhe raportet e identifikimit të nevojave, 2019.

- Vlerësohet e domosdoshme nisja e procesit të komunikimit me publikun për të rritur gatishmërinë e qytetarëve për të paguar tatimin në pronë, prandaj si përfundim rekomandohet që kjo temë të adresohet përmes komunikimit sidomos në fushën e inkasimit, mirëpo duhet paraprakisht të shihet se çka kanë bërë organizatat tjera që të mos dyfishohen aktivitetet.
- Adresimi i rekomandimeve të ZKA-së – rëndësia e adresimit, problemet, sfidat – për të gjitha komunat e sidomos për ato që kanë performancë të ulët në këtë tregues. Fokus mund të jenë elementet si: hartimi i planit të veprimit për adresimin e rekomandimeve të ZKA-së, përcaktimi i treguesve të matshëm për monitorim dhe vlerësim dhe si të bëhet monitorimi i zbatimit të planit të veprimit përkatës. Po ashtu, meqenëse zbatimi i planit të veprimit komunal për adresimin e çështjeve sipas rekomandimeve të ZKA-së është jo i kënaqshëm, rekomandohet që të mbahet trajnim me pjesëmarrjen e menaxhmentit komunal dhe anëtarëve të Kuvendit Komunal ku këta të fundit luajnë rol të rëndësishëm në mbajtjen përgjegjëse të ekzekutivit mbi të gjeturat dhe zbatimin e rekomandimeve të ZKA-së;
- Përdorimi i Sistemit Informativ mbi Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ) me fokus në procedimin e punësimeve përmes këtij sistemi, shkaqet pse nuk ndiqet në disa raste, kufizimet, problemet – për të gjitha komunat mirëpo me fokus në komunat që nuk kanë treguar performancë të mirë në këtë tregues; Gjithashtu, konsiderohet e nevojshme zbatimi i rregullave dhe legjislacionit për shërbimin në nivelin komunal sidomos nëse legjislacioni për shërbimin civil ndryshon me kthimin në fuqi të Ligjit për zyrtarët publikë dhe legjislacionit sekondar. Me gjithë performancën mesatare të komunave në këtë tregues projekti do të duhej që këtë tregues ta adresojë përmes kanaleve të komunikimit në zbatimin e legjislacionit (primar dhe sekondar) sa i përket menaxhimit të burimeve njerëzore, si dhe një prej pikave mund të jetë përdorimi i SIMBNJ-së.
- Sa i përket emërimit të grave në pozita udhëheqëse, projekti DEMOS ka mbajtur trajnime në këtë tregues dhe përgjigja e komunave ka qenë se ky tregues është shumë i politizuar, dhe se progresi në këtë tregues është vështirë i arritshëm. Aspektet e mospërputhjes janë kryesisht politike, veçanërisht në raste të koalicioneve qeverisëse, ku emrat për drejtorë të drejtorive komunale propozohen nga partitë politike. Angazhimi në ngritjen e ndërgjegjësimit të akterëve politikë lidhur me rëndësinë e emërimit të grave në pozita politike mund të japë rezultate të favorshme. Prandaj, ky tregues do të duhej të adresohet përmes formave të komunikimit.

4.4. Ofrimi i shërbimeve

Në numrin prej nëntë treguesve sipas katër nën-fushave të ndara të ofrimit të shërbimeve, vlerësimi dhe performanca e komunave janë bërë mbi katër tregues gjithsej. Nën-fusha e arsimit parauniversitar dhe nën-fusha e kujdesit parësor shëndetësor me nga dy tregues kanë qenë të ngrirë në vitin 2018. Mesatarja e përgjithshme në këtë fushë është 70%. Sa u përket dy nën-fushave, ajo e shërbimeve administrative ka pasur mesataren prej 87% (kjo është edhe mesatarja në treguesin e vetëm të vlerësuar në këtë nën-fushë), derisa ajo mbi planifikimin hapësinor, transportin publik dhe mjedisin ka pasur mesataren prej 53%. Sa u përket treguesve individualisht, treguesi me mesataren më të lartë ka qenë treguesi 22 ose rastet e kërkesave administrative të shqyrtuara brenda afateve ligjore me mesatare prej 87%, kurse treguesi 24 ose shtrirja e territorit komunal të përfshirë në planet e hollësishme rregullative ka qenë me mesataren më të ulët prej 20%. Dy treguesit tjerë kanë pasur një mesatare relativisht të mirë, përkatësisht treguesi 26 ose niveli i zbatimit të planit lokal të veprimit për mjedisin me mesatare prej 74 % dhe treguesi 25 ose vendbanimet e mbuluara me transport publik lokal me mesatare prej 67%.

Është e rëndësishme të theksohet se projekti nuk do të trajtojë zyrtarët komunalë për treguesit në fushën e ofrimit të shërbimeve, sepse mungon kapaciteti human në kuadër të projektit. Arsye tjetër është se projekte të tjera që përkrahin komunat në Kosovë janë duke ofruar asistencë teknike në këtë fushë. Për shembull, GIZ-i është duke i përkrahur komunat, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) për t'i hartuar hartat zonale.

SHTOJCA 1: TABELA 9, 10, 11 DHE 12

Tabela 9. Treguesit në tre fusha dhe nën-fusha dhe performanca mesatare e komunave

Nr.	Treguesit sipas fushave dhe nën-fushave përkatëse	Mesatarja 2018
Fusha: Qeverisja demokratike lokale		57.92%
Nën-fusha 1: Roli i Kuvendit Komunal si organ mbikëqyrës		58.42%
1.	Dorëzimi me kohë dhe miratimi i buxhetit komunal në Kuvendin Komunal	0.00%
2.	Diskutimi i raporteve buxhetore tre-mujore nga Kuvendi Komunal	79.61%
3.	Diskutimi i raportit të performancës komunale nga Kuvendi Komunal	42.11%
4.	Diskutimi i raportit të auditorit të jashtëm dhe planit të veprimit për adresimin e rekomandimeve si dhe diskutimi i gjetjeve dhe rekomandimeve nga auditimi i brendshëm në Kuvendin Komunal	36.18%
5.	Raportimi i Kryetarit të Komunës para Kuvendit Komunal	75.79%
Nën-fusha 2: Pjesëmarrja, konsultimi dhe gjithëpërfshirja e qytetarëve		49.35%
6.	Pjesëmarrja e qytetarëve në konsultimet publike të ndara sipas gjinisë	35.97%
7.	Aktet komunale dhe dokumentet e politikave lokale të konsultuara me publikun	62.72%
8.	Seancat dëgjimore publike për KAB dhe buxhetin komunal (proporcionalisht ndaj numrit të banorëve)	0.00%
Nën-fusha 3: Transparenca, qasja në informata dhe integriteti		65.99%
9.	Takimet e Kuvendit Komunal të bëra publike dhe të transmetuara drejtpërdrejt	0.00%
10.	Përditësimi i rregullt i ueb-faqes komunale sipas kërkesave (specifike) ligjore	81.97%
11.	Publikimi i dokumenteve dhe kontratave të prokurimit publik	0.00%
12.	Publikimi i procesverbaleve për proceset e konsultimeve publike	0.00%
13.	Raportimi i planit vjetor të planit të integritetit të paraqitur para Kuvendit Komunal	50.00%
Fusha: Menaxhimi komunal		53.22%
Nën-fusha 1: Menaxhimi financiar		32.41%
14.	Regjistri i tatimit në pronë i përditësuar çdo vit sipas kërkesave ligjore	26.54%
15.	Niveli i mbledhjes së tatimit në pronë (pa borxhe, kamata, gjoba)	39.99%
16.	Adresimi i rekomandimeve të auditimit (ZKA)	30.68%
Nën-fusha 2: Menaxhimi i kontratës		84.65%
17.	Zbatimi i planit të prokurimit	84.65%
18.	Hartimi dhe publikimi i listës së pronave komunale që planifikohen të jepen në shfrytëzim dhe të shkëmbehen	0.00%

Nën-fusha 3: Menaxhimi i burimeve njerëzore		42.59%
19.	Vende të hapura pune të proceduara përmes SIMBNj-së	64.37%
20.	Gratë në pozita udhëheqëse në institucionet e arsimit, shëndetësisë, kulturës	0.00%
21.	Gratë e emëruara në pozita politike në komunë	20.80%
Fusha: Ofrimi i shërbimeve		70.64%
Nën-fusha 1: Shërbimet administrative		87.35%
22.	Rastet e kërkesave administrative të shqyrtuara brenda afateve ligjore	87.35%
23.	Kërkesat e shqyrtuara për leje të ndërtimit	0.00%
Nën-fusha 2: Planifikimi hapësinor, transporti publik dhe mjedisi		53.93%
24.	Shtirja e territorit komunal të përfshirë në planet (e hollësishme) rregullative	20.25%
25.	Vendbanimet e mbuluara me transport publik lokal	67.46%
26.	Niveli i zbatimit të planit lokal të veprimit për mjedisin	74.08%
Nën-fusha 3: Arsimi parauniversitar		0.00%
27.	% e fëmijëve që frekuentojnë kopshtin	0.00%
28.	Rezultatet në test të maturës	0.00%
Nën-fusha 4: Kujdesi parësor shëndetësor		0.00%
29.	Hapësira të KPSH në m ² për 10,000 banorë	0.00%
30.	Niveli i përmbushjes së raportit 1 mjek familjar dhe 2 infermiere për 2,000 banorë	0.00%

Tabela 10. Prioritetet për trajnime

#	Tema / Fusha e treguesit	2018
I. QEVERISJA KOMUNALE - Roli i Kuvendit Komunal, Pjesëmarrja dhe Përfshirja e qytetarëve, Transparenca dhe Llogaridhënia		
I	Roli i Kuvendit Komunal si organ mbikëqyrës	
1	Dorëzimi me kohë dhe miratimi i Buxhetit Komunal në Kuvendin Komunal	/
2	Diskutimi për raportet tremujore buxhetore nga Kuvendi Komunal	●
3	Diskutimi për raportin e performancës komunale nga Kuvendi Komunal për vitin e kaluar	●
4	Diskutimi i raportit të auditorit të jashtëm dhe planit të veprimit për adresimin e rekomandimeve si dhe diskutimi i gjetjeve dhe rekomandimeve nga auditimi i brendshëm në Kuvendin Komunal	●
5	Raportimi i Kryetarit të Komunës para Kuvendit Komunal	●

II	Pjesëmarrja, konsultimi dhe gjithëpërfshirja e qytetarëve	
6	Pjesëmarrja e qytetarëve në takime publike, i disagreguar sipas gjinisë	●
7	Aktet komunale dhe dokumentet e politikave lokale të konsultuara me publikun	●
8	Seanca dëgjimore publike për KAB dhe buxhetin komunal (proporcionalisht ndaj # banorëve)	/
III	Transparenca, qasja në informata dhe integriteti	
9	Takimet e kuvendit të bëra publike dhe të transmetuara drejtpërdrejt	/
10	Përditësimi i rregullt i ueb-faqes komunale sipas kërkesave (specifike) ligjore	●
11	Publikimi i dokumenteve dhe kontratave të prokurimit publik	/
12	Publikimi i procesverbaleve për proceset e konsultimeve publike	/
13	Raportimi i planit vjetor të planit të integritetit të paraqitur para Kuvendit Komunal	●
II. MENAXHIMI KOMUNAL - Menaxhimi financiar, Menaxhimi i kontratës dhe Menaxhimi i BNj-së		
IV	Menaxhimi financiar	
14	Regjistri i tatimit në pronë i përditësuar çdo vit, sipas kërkesave ligjore	●
15	Niveli i mbledhjes së tatimit në pronë (pa borxhe, kamata, gjoba)	●
16	Adresimi i rekomandimeve të auditimit (sipas ZKA-së)	●
V	Menaxhimi i kontratës	
17	Zbatimi i planit të prokurimit	●
18	Hartimi dhe publikimi i listës së pronave komunale që planifikohen të jepen në shfrytëzim dhe të shkëmbehen	
VI	Menaxhimi i burimeve njerëzore	
19	Vende të hapura pune të proceduara përmes SIMBNj-së	●
20	Gratë në pozita udhëheqëse në institucionet e arsimit, shëndetësisë, kulturës	/
21	Gratë e emëruara në pozita politike në komunë	●
III. OFRIMI I SHËRBIMEVE - Qasja dhe cilësia e ofrimit të shërbimeve - Sipas sektorit		
VII	Shërbimet administrative	
22	Rastet e kërkesave administrative të shqyrtuara brenda afateve ligjore	●
23	Kërkesat e shqyrtuara për leje të ndërtimit	
VIII	Planifikimi hapësinor, transporti publik dhe mjedisi	
24	Shtrirja e territorit komunal të përfshirë në planet (e hollësishme) rregullative	●
25	Vendbanimet e mbuluara me transport publik lokal	●
26	Niveli i zbatimit të veprimit për planin lokal të veprimit për mjedisin	●

IX	Arsimi para-universitar	
27	% e fëmijëve që frekuentojnë kopshtin	/
28	Rezultatet në test të maturës	/
X	Kujdesi parësor shëndetësor (KPSH)	
29	Hapësira të KPSH në m2 për 10,000 banorë	/
30	Niveli i përmbushjes së raportit 1 mjek familjar dhe 2 infermiere për 2,000 banorë	/

Ngjyrat në formë të topave kanë kuptimin si në vijim

ngjyra e kuqe - prioritet i lartë;

ngjyra e verdhë - prioritet mesatar;

ngjyra e gjelbër - prioritet i ulët.

Tabela 11. Treguesit dhe nevojat për trajnime ose komunikim

Nr. i treguesit	Tema / Fusha e treguesit	Ngritja e kapaciteteve	Ngritja e vetëdijes (përmes formave të komunikimit)
I. QEVERISJA KOMUNALE - Roli i Kuvendit Komunal, Pjesëmarrja dhe Përfshirja e qytetarëve, Transparenca dhe Llogaridhënia			
I	Roli i Kuvendit Komunal si organ mbikëqyrës		
1	Dorëzimi me kohë dhe miratimi i Buxhetit Komunal në Kuvendin Komunal		
2	Diskutimi për raportet tremujore buxhetore nga Kuvendi Komunal	PO	PO
3	Diskutimi për raportin e performancës komunale nga Kuvendi Komunal për vitin e kaluar	PO	PO
4	Diskutimi i raportit të auditorit të jashtëm dhe planit të veprimit për adresimin e rekomandimeve si dhe diskutimi i gjetjeve dhe rekomandimeve nga auditimi i brendshëm në Kuvendin Komunal	PO	
5	Raportimi i Kryetarit të Komunës para Kuvendit Komunal		
II Pjesëmarrja, konsultimi dhe gjithëpërfshirja e qytetarëve			
6	Pjesëmarrja e qytetarëve në takime publike, i disagreguar sipas gjinisë		PO
7	Aktet komunale dhe dokumentet e politikave lokale të konsultuara me publikun		PO
8	Seanca dëgjimore publike për KAB dhe buxhetin komunal (proporcionalisht ndaj # banorëve)		

III	Transparenca, qasja në informata dhe integriteti		
9	Takimet e kuvendit të bëra publike dhe të transmetuara drejt-përdrejt		
10	Përditësimi i rregullt i ueb-faqes komunale sipas kërkesave (specifike) ligjore		PO
11	Publikimi i dokumenteve dhe kontratave të prokurimit publik		PO
12	Publikimi i procesverbaleve për proceset e konsultimeve publike		PO
13	Raportimi i planit vjetor të planit të integritetit të paraqitur para Kuvendit Komunal		PO
II. MENAXHIMI KOMUNAL - Menaxhimi financiar, Menaxhimi i kontratës dhe Menaxhimi i BNj-së			
IV	Menaxhimi financiar		
14	Regjistri i tatimit në pronë i përditësuar çdo vit, sipas kërkesave ligjore		PO
15	Niveli i mbledhjes së tatimit në pronë (pa borxhe, kamata, gjoba)		PO
16	Adresimi i rekomandimeve të auditimit (sipas ZKA-së)	PO	
V	Menaxhimi i kontratës		
17	Zbatimi i planit të prokurimit		
18	Hartimi dhe publikimi i listës së pronave komunale që planifikohen të jepen në shfrytëzim dhe të shkëmbehen		PO
VI	Menaxhimi i burimeve njerëzore		
19	Vende të hapura pune të proceduara përmes SIMBNj-së		PO
20	Gratë në pozita udhëheqëse në institucionet e arsimit, shëndetësisë, kulturës		
21	Gratë e emëruara në pozita politike në komunë		PO
III. OFRIMI I SHËRBIMEVE - Qasja dhe cilësia e ofrimit të shërbimeve - Sipas sektorit			
VII	Shërbimet administrative		
22	Rastet e kërkesave administrative të shqyrtuara brenda afatëve ligjore		
23	Kërkesat e shqyrtuara për leje të ndërtimit		
VIII	Planifikimi hapësinor, transporti publik dhe mjedisi		
24	Shtrirja e territorit komunal të përfshirë në planet (e hollësishme) rregullative		
25	Vendbanimet e mbuluara me transport publik lokal		
26	Niveli i zbatimit të veprimit për planin lokal të veprimit për mjedisin		

IX	Arsimi para-universitar		
27	% e fëmijëve që frekuentojnë kopshtin		
28	Rezultatet në test të maturës		
X	Kujdesi parësor shëndetësor (KPSH)		
29	Hapësira të KPSH në m2 për 10,000 banorë		
30	Niveli i përmbushjes së raportit 1 mjek familjar dhe 2 infermiere për 2,000 banorë		


Tabela 12. Treguesit dhe prioritetet për trajnime

Nr. i treguesit	Emërtimi i treguesit	Prioriteti 1-5 (1prioritet i lartë)	Periudha kohore	Komunat	Nr. i grupeve	Pjesëmarrësit/ pozitat (të saktësohen më vonë)
4	Diskutimi i raportit të auditorit të jashtëm dhe planit të veprimit për adresimin e rekomandimeve si dhe diskutimi i gjetjeve dhe rekomandimeve nga auditimi i brendshëm në Kuvendin Komunal	1	Janar - Mars	38 komuna	14	Të gjithë anëtarët e Kuvendit Komunal
6	Pjesëmarrja e qytetarëve në takime publike, i disagreguar sipas gjinisë	1				Nuk do të ketë trajnim
14	Regjistri i tatimit në pronë i përditësuar çdo vit, sipas kërkesave ligjore	1				Nuk do të ketë trajnim
15	Niveli i mbledhjes së tatimit në pronë (pa borxhe, kamata, gjoba)	1				Nuk do të ketë trajnim
16	Adresimi i rekomandimeve të auditimit (sipas ZKA-së)	1	Maj - Dhjetor	38 komuna Të gjitha komunat	6	Zyrtarët nga zyra e financave
21	Gratë e emëruara në pozita politike në komunë	1				Nuk do të ketë trajnim
24	Shtirirja e territorit komunal të përfshirë në planet (e hollësishme) rregullative	1				Nuk do të ketë trajnim

3	Diskutimi për raportin e performancës komunale nga Kuvendi Komunal për vitin e kaluar	2.5	Shtator - dhjetor	20 komuna	5	Anëtarët e KPF, Zyrtarët për informim, PMS, drejtori i administratës, ZBGJ
13	Raportimi i planit vjetor të planit të integritetit të paraqitur para Kuvendit Komunal	2.5				Nuk do të ketë trajnim
7	Aktet komunale dhe dokumentet e politikave lokale të konsultuara me publikun	3				Nuk do të ketë trajnim
19	Vende të hapura pune të proceduara përmes SIMBNj-së	3				Nuk do të ketë trajnim
2	Diskutimi i raporteve tremujore buxhetore nga Kuvendi Komunal	4.5	Janar - Mars	38 komuna	14	Të gjithë anëtarët e Kuvendit Komunal
5	Mbledhje të Kuvendit me pjesëmarrje të kryetarit të komunës	5				Nuk do të ketë trajnim
10	Përditësimi i rregullt i ueb-faqes komunale sipas kërkesave (specifike) ligjore	5				Nuk do të ketë trajnim
17	Zbatimi i planit të prokurimit	5				Nuk do të ketë trajnim
25	Vendbanimet e mbuluara me transport publik lokal	4				Nuk do të ketë trajnim
26	Niveli i zbatimit të veprimit për planin lokal të veprimit për mjedisin	5				Nuk do të ketë trajnim
22	Rastet e kërkesave administrative të shqyrtuara brenda afateve ligjore	5				Nuk do të ketë trajnim
TREGUESIT E NGRIRË						
1	Dorëzimi me kohë dhe miratimi i Buxhetit Komunal në Kuvendin Komunal					Nuk do të ketë trajnim
8	Seanca dëgjimore publike për KAB dhe buxhetin komunal (proporcionalisht ndaj # banorëve)					Nuk do të ketë trajnim
9	Takimet e kuvendit të bëra publike dhe të transmetuara drejtpërdrejt					Nuk do të ketë trajnim
11	Publikimi i dokumenteve dhe kontratave të prokurimit publik					Nuk do të ketë trajnim

12	Publikimi i procesverbaleve për proceset e konsultimeve publike					Nuk do të ketë trajnim
18	Hartimi dhe publikimi i listës së pronave komunale që planifikohen të jepen në shfrytëzim dhe të shkëmbehen					Nuk do të ketë trajnim
20	Gratë në pozita udhëheqëse në institucionet e arsimit, shëndetësisë, kulturës					Nuk do të ketë trajnim
23	Kërkesat e shqyrtuara për leje të ndërtimit					Nuk do të ketë trajnim
27	% e fëmijëve që frekuentojnë kopshtin					Nuk do të ketë trajnim
28	Rezultatet në test të maturës					Nuk do të ketë trajnim
29	Hapësira të KPSH në m ² për 10,000 banorë					Nuk do të ketë trajnim
30	Niveli i përmbushjes së raportit 1 mjek familjar dhe 2 infermiere për 2,000 banorë					Nuk do të ketë trajnim

RAPORTI MBI VLERËSIMIN
E NEVOJAVE (RVN)
PËR NGRITJEN E
KAPACITETEVE
KOMUNALE



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Sweden
Sverige



Norwegian Embassy
Prishtina